

NJË VIT PA KADARENË

Kadareja qe korifeu i
përkatësisë europiane
të popullit shqiptar

Nga Skënder Gjinushi

(fq. 2)

Dhembja do të kalojë,
por arti i tij do të
mbetet një mrekulli e
përjetshme

Nga Bujar Hudhri

(fq. 5)

Numri special “STUDIA
ALBANICA” 2024, 2
i kushtohet Kadaresë

Nga Akademik Gëzim Hoxha

(fq. 3)

SHËNIME MBI LIBRAT

Libri me tregime “Thika pa gjak”
ZIJA ÇELA MODERN
DHË UNIVERSAL

Nga Mexhid Mehmeti

(fq. 10)

Romani “Lindur së prapthi” i Rita Petros

Kur të qenët së prapthi
në një botë si kjo jona nuk
është mallkim, por urim

Nga Anxhela Pashaj

(fq. 7)

Romani “Lindur në Provincë” i Arian Lekës

Nga provinca
e jashtme në provincën
e brendshme

Nga Pol Milo

(fq. 13)

Romani “Pas dyerve të Parisit”, Sindi Tona, “Living”
Një roman dashurie me tension
psikologjik dhe ironi urbane

Nga Xhoina Salaj

(fq. 17)

Ekspozita e Gani Bytyçit, kujtesë
e përflakur në ngjyrë dhe shpirt

Nga Emin Azemi

Arti në epokën digjitale

Ese nga Fatlum Mehulli

Kadare është ai guri
i qemerit që mban
traun e shtëpisë së
përbashkët

Nga Mehmet Kraja

(fq. 2)

Fatlumë që ishim
bashkëkohës të tij

Nga Piro Misha

(fq. 3)



Poezia “Mbi poezinë moderne”
e Wallace Stevens
Analiza e një poezie
emblematiske moderne...

Nga Rudolf Marku

(fq. 8)

Përherë e më tepër në shtypin tonë dëgjojmë të artikulohej më me guxim
termat Poezi/Letërsi Moderne, Postmoderne/ Metafizike/... Deri në vitin
1991 terma të tillë ishin një arsenal për të goditur në shënjestër autorët që
guxonin të devijonin rrugën e shenjtë të socrealizmit. Këta terma zakonisht
përdorehin prej kritikëve dhe studiuesve të letërsisë, të cilët kishin marrë
përsipër rolin e gardianëve të pastërtisë së letërsisë dhe arteve, për ta ruajtur
me fanatizëm virgjritetin e shenjtë të ideologjik të krijesve.

BIBLIOTEKË

Odise Kote

(fq. 14)

Perënditë ikën

Shpresa Kapisyzi

(fq. 15)

Gardalina

Arbër Selmani

(fq. 16)

Çika jeme

Xheni Shehaj

(fq. 12)

Rojtarja e varrezave

Ruzhdi Gole

(fq. 18)

Dola t'i flas detit në vesh

Roland Gjoza

(fq. 19)

Lamborghini

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Një letër e panjohur e poetit
Gaspër Pali drejtuar kolegut
të universitetit dhe të letrave,
Filip Ndocaj, si dhe dy foto të
papunikuara të asaj kohe

(fq. 11)

Një vepër e re e Umberto Eco-s
në shqip nga “Dituria”

RRËFIMET E NJË
ROMANCIERI TË RI

Nga Zija Vukaj

(fq. 21)

GEORGE ORWELL

Pse shkruaj

Përktheu Granit Zela



(fq. 22)

Në Shkodër u organizua konferenca shkencore
“Poetika e veprës letrare të Ridvan Dibrës”

VEPRA E DIBRËS, NJË
UNIVERS MË VETË

Përgatiti Ismet Kallaba

(fq. 6)

“Studimi i veprës letrare të këtij autori i shërben edhe vetë
studimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare, e cila, për
shkak të afërsisë kohore të studiuesve me të, ka mbetur
relativisht e pastudiuar, ka thënë në fjalën e hapjes Prof.
as. dr. Arben Prendi, drejtor i Departamentit të Letërsisë
në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Kadare është ai guri i qemerit që mban traun e shtëpisë së përbashkët

Nga Mehmet Kraja

Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Para një viti, lajmi për ikjen në amshim të Ismajl Kadesë na tronditi, na bëri të ndiheshim disi të braktisur, të përfshirë në një ndjenjë humbjeje dhe zbrazësie që nuk do ta plotësonim aq lehtë. Kjo ndodhte ngase për të gjithë ne Kadare kishte marrë atributet jo të një miti, siç mund të thonë disa, por të një argumenti që na i bën të ditura, na i kujton dhe na i rikujton të vërtetat e amshueshme për qenësi të mëdha identitare dhe tej identitare. Kadare ishte personifikim, ishte simbol, i tillë do të mbetet deri skajet më të largëta të memories sonë kolektive. Është e pamundur të ndryshohet ky imazh, sado kohë që të kalojë:

Kadare është ai guri i qemerit që mban traun e shtëpisë së përbashkët.

Për ne në Kosovë ikja e Kadesë kishte një kuptim më specifik, sepse ai ka qenë mbështetja këmbëngulëse, e fortë dhe pa rezervë për Kosovën në më shumë se 50 vitet e shkuara.

Pavarësisht nëse kjo mbështetje ka qenë letrare ose politike, ajo përbën një ngjarje në këtë histori, sepse pësimet dhe synimet e Kosovës, përfshirë edhe arritjet e saj të viteve më të vona, përmes zërit të Kadesë, janë kthyer dhe shndërruar në zë të ndërgjegjes kombëtare, në një zë që bashkëndjen dhe flet për brengën më të madhe shqiptare.

Zëri i Kadesë në mbështetje të Kosovës ka krijuar kontekst politik ndërkombëtar, ka arritur të depërtojë nëpër kancelaritë e ftohta diplomatike dhe, që është po kaq me rëndësi, ka qenë frymëzim për shumë gjenerata intelektualësh, mësuesish, studentësh, nxënësish, pra për një masë të gjerë njerëzish në Kosovë, përfshirë edhe ata që, në aktin final të kësaj historie, u vunë në radhët e para të luftës për çlirimin e Kosovës. Në një kohë të ndjeshme të strukturimit të vetëdijes së kosovarëve, ai u hapi rrugë lidhjeve të tyre mbi-ideologjike dhe tej-ideologjike me shtetin amë, duke anashkaluar dhe minimizuar rolin e kufizimeve dhe ndasive botëkuptimore (madje edhe rajonale dhe krahinore), për krijimin e një tërësie kompakte nacionale. Zëri i tij, pavarësisht nëse vinte nga vokacioni letrar ose nga diskursi politik, për kosovarët ka qenë zë integruar.

Në këtë angazhim të gjerë dhe gjithëpërfshirës për Kosovën, Kadare është shfaqur i tërësishëm dhe i përplotsueshëm. Bashkësisë ndërkombëtare dhe opinionit botëror i ka folur me një gjuhë të qartë politike dhe kulturore, ndërkohë që me kosovarët herë pas here ka ditur të jetë kritik, madje i ashpër, duke kërkuar prej tyre që të përballen me sfidat dhe të jenë në nivel të çastit historik të Kosovës. Sheshtimet e Kadesë për modelet e shoqërisë shqiptare, përkundër faktit se mund të mos lidhen drejtpërdrejt me Kosovën, kanë pasur jehonë të madhe në opinion kosovar dhe janë kontribut i vyer për profilizimin botëkuptimor të shoqërisë kosovare, si shoqëri me vlera perëndimore.

Vepra letrare e Kadesë, shkrimet dhe analizat publicistike, intervistat dhe deklaratat, pse jo edhe mesazhet gojore, kanë luajtur rol emancipues për Kosovën dhe kosovarët. Dashuria e tij për Kosovën, angazhimi i singertë intelektual, qëndrimi i paluhatshëm parimor kanë bërë që Kadare të bëhet pjesë e identitetit shqiptar në Kosovë. Idetë dhe mendimtaria e Kadesë, përfshirë edhe vlerat e veprës së tij, tashmë qëndrojnë në themelet e shtetit të ri të Kosovës, si identitet i tij i qëndrueshëm, shpirtëror dhe botëkuptimor.



Kadareja që korifeu i përkatësisë europiane të popullit shqiptar

Nga Skënder Gjinushi

Kryetar i Akademisë së Shkencave

Si sot, një vit më parë, i dhamë lamtumirën në emër të Asamblesë së Akademisë së Shkencave, të tërë botës akademike shqiptare, anëtarit të saj të nderuar për 35 vjet me radhë, gjeniut të letrave shqipe, Ismail Kadare; kryeakademikut, për nga vlera e jehona e veprës së tij, e mirënjohur e vlerësuar ndërkombëtarisht.

Humbja fizike e Kadesë është pa dyshim humbja më e madhe e letërsisë sonë; është një humbje shumë e madhe e kulturës dhe letërsisë europiane e botërore, e akademizmit shqiptar e atij europian.

Vepra e Kadesë i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë e të botës shqiptare, dhe bën pjesë në patrimonin e letërsisë botërore.

Kadareja do të lexohet e vlerësohet në vazhdimësi, pasi mesazhet e veprës së tij, stili e forca e fjalës dhe mendimet e bëjnë veprën e tij aktuale, tërheqëse dhe emancipuese për të gjitha kohërat.

Kadareja shkroi nën diktaturë, por vepra e tij përkthehet, lexohet e vlerësohet njëllë nga lexuesit në të gjithë botën, pavarësisht cilës kulturë apo cilit sistem politik i përkasin. Ajo vazhdon të vlerësohet me çmimet më të larta, duke fituar garën edhe me homologët e tij, me letërsinë dhe veprat e shkruara në demokraci; duke treguar se vlera e krijimtarisë letrare çmohet me sa ajo nxit emancipimin e shoqërisë, lirinë e lexuesit, e jo nga sa ka kushtëzuar lirinë fizike të shkrimtarit; çmohet kur ajo e bën mendjen e lirë të shkrimtarit pjesë të zgjimit të madh të popujve që rrëzuan "perden e hekurt", si do ta çmonte Presidenti i Francës kontributin e Kadesë.

Fjalën e fundit e thotë lexuesi, dhe lexuesit e Kadesë, të shtrirë tashmë në tërë botën e në të gjitha gjuhët, vijnë vetëm duke u shtuar; dhe e tillë do të jetë vepra e Kadesë për dhjetëvjeçarë me radhë, krahas veprave të pavdekshme të letërsisë botërore, që nuk njohin epokë, por bëjnë epokë.

Ne do t'i jemi gjithnjë mirënjohës për gjithçka i la trashëgim popullit shqiptar me krijimtarinë e tij, por veçanërisht edhe për kontributin e dimensionin e tij si akademik.

Kadareja është hulumtuesi, zhvilluesi e mbrojtësi më i zjarrtë e më me influencë i gjuhës shqipe, i origjinës e lashtësisë së saj, i vlerave e pasurisë së saj. Gjuha shqipe, si një gjuhë që arriti të shfaqë talentin e gjenialitetin e Kadesë në tërë larmishmërinë e thellësinë e tyre, renditet tashmë në gjuhët e mëdha të një populli të vogël.

Kontributi i tij si lëvruar i gjuhës është po aq i çmuar sa ai i Çabejt e i plejadës së tij, si studiues të saj.

Kadareja që korifeu i përkatësisë europiane të popullit shqiptar, të vlerave e karakteristikave të kulturës së tij ndër shekuj, të origjinës e lashtësisë së tij ilire e parailire, të zgjedhjes së tij perëndimore që në periudhën e mesjetës.

Kadareja ishte një busull e përcaktimit europian të Shqipërisë, avokati më me influencë i pranimi të Shqipërisë në familjen europiane, i mbështetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës e pavarësimi të saj.

Kadareja është tashmë një figurë identitare e popullit shqiptar, krahas figurave të tilla si Skënderbeu, Ismail Qemali, Nënë Tereza, e si i tillë do të zërë vend në enciklopedinë shqiptare e kujtesën e popullit shqiptar, kudo që ndodhet.

Akademia e Shkencave ka pasur privilegjin ta kishte anëtar të saj për 35 vjet me radhë, çka çdo anëtar i saj e quan një nder të veçantë dhe i është mirënjohës për mbështetjen e peshën që i ka dhënë Akademisë e botës akademike shqiptare në tërësi. Emri i Kadesë i jep një shkëlqim të veçantë Librit të Artë të Albanologjisë të Akademisë së Shkencave, të cilin ai vetë e cilësonte si: "amza e më të shquarve në studimet shqiptare, që prej themelimit të saj deri më sot... kodiku i nderit i atyre që e kthyen shkencën për shqiptarët nga ekzotike në paradigmatisht, pa të cilën nuk bëjnë dot studimet ballkanistike, europiane dhe indoeuropiane". Cilësime, të cilave vepra e emri i Kadesë u jep edhe më kuptim.

Ne sot kujtojmë me hidhërim këtë humbje të madhe, për largimin nga jeta të anëtarit e kolegut tonë, për humbjen e ikonës së inteligjencës e kulturës shqiptare, por dhe me krenari e mirënjohje për veprën e Kadesë, vepër e cila do të ruhet si një nga thesaret e kulturës sonë e të shkencave albanologjike, do t'u përcillet brezave si një testament qytetërimi e identiteti, si një pasuri e vyer kombëtare.

Që nga themelimi i saj në vitin 1964, “**Studia Albanica**” 2024, 2 që po prezantojmë, bëhet numri i dytë special. Herën e parë ajo i është përkushtuar 550 vjetorit të vdekjes të Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit- Skënderbeut (Nr. 2018, 2019).

Numri special “STUDIA ALBANICA” 2024, 2 i kushtohet Ismail Kadaresë

Nga Akademik Gëzim Hoxha

Që nga themelimi i saj në vitin 1964, pra saktësisht pas 60 vitesh, numri i revistës “**Studia Albanica**” 2024, 2 që po prezantojmë, bëhet numri i dytë special. Herën e parë ajo i është përkushtuar 550 vjetorit të vdekjes të Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit- Skënderbeut (Nr. 2018, 2019). Në këtë herë të dytë i kushtohet jo thjesht një figure, por një monumenti të gjallë të kulturës shqiptare: shkrimtarit dhe akademikut Ismail Kadare. Me këtë numër special, Redaksia ka synuar të shpalosë nderimin solemn për këtë personalitet të madh, që për dekada të tëra frymëzoi një komb të tërë me fjalën, mitin dhe mendimin e tij.

Revista është strukturuar në dy pjesë: **Pjesa e parë “Lamtumira e një kolosi”** është një kronikë e dhimbjes dhe e nderimit, ku janë përmbledhur çastet solemne të ndarjes nga jeta të Ismail Kadaresë. Ajo nis me njoftimin mortor dhe nekrologjinë për shkrimtarin e madh dhe vijon me ceremoninë përkujtimore të organizuar në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave — një skenë e nderit, ku morën pjesë figura të spikatura të jetës akademike e kulturore shqiptare.

Janë përfshirë këtu fjalët e lamtumirës të Kryetarit të Akademisë, akademik Skënder Gjinushi; të znj. Evis Kushi, Zëvendëskryetare e Komisionit Parlamentar për Arsimit dhe Mjetet e Informimit Publik; si dhe të Ambasadores së Francës në Shqipëri, znj. Catherine Suard.

Këto fjalë lamtumire janë pasuar nga një mesazh ngushëllimi i Akademisë së Arteve

dhe Shkencave të Malit të Zi, si dhe nga një **eulogji** plot dritë e respekt prej akademikut Shaban Sinani. Në këtë ditë të shenjtë të nderimit, u bashkuan me fjalët e tyre edhe dy akademikët arbëreshë Francesco Altimari dhe Matteo Mandalà. Në mbylljen e kësaj ceremonie nderi ndodhet fjala akademik Vasil Tole, i cili përmbledhtazi vlerësoi se: “*Vepra e Kadaresë ka zgjeruar dhe riformatuar përmasat e munguara të lirisë individuale të çdo shqiptari.*”

Pjesa e dytë, të cilën mund ta titullojmë si: “**Lexime në gjurmë të pavdekisës**”, sjell tetë artikuj përzgjedhur me kujdes, nga penat më të formuara, që kanë ndjekur, lexuar dhe interpretuar veprën e Kadaresë, edhe përtej kufijve të letërsisë. Çdo artikull është një dritare që ndriçon një cep tjetër të universit kadarean:

1. Prof. **Bashkim Kuçuku**, në punimin sintetik “**Letërsia shqipe në një emër**”, e sheh veprën si një univers të bashkuar e të ndërlidhur, ku fijen e mendimit dhe stilit e ndjekin të dukshmet dhe të padukshmet, të lashtat dhe bashkëkohoret.

2. Akademik **Francesco Altimari**, me “**Arbërlandi brenda Ismajlandit**”, thotë se Kadareja edukoi lexuesit shqiptarë më mirë se Orwell, duke i mësuar të shohin përtej kafazit dhe të shikojnë drejt mitit si pjesë të kujtesës kolektive.

3. Akademik **Shaban Sinani**, në interpretimin e veprës “**Kur sunduesit grinden**”, pohon se: kjo është një vepër për të

zbuluar fatin e shkrimtarit me mision, i cili duhet t’i thotë vetes: Mbaje kryqin! Ndryshe mos hyr në këtë urdhër të lartë”. Sipas tij “*Kadareja krijoi një Shqipëri paralele, fisnike, të denjë për familjen europiane që i kishte takuar që nga epoka e Rilindjes.*”


4. Akademik **Matteo Mandalà**, në një ese të mprehtë, vëren se “*Kronikë në gur*” është një roman në ndërtim të përhershëm – një kujtesë në punë – ku fëmijëria dhe historia bashkohen në një përpjekje për të gdhendur të ardhmen.

5. Prof. **Klodeta Dibra** dhe Dr. **Ermira Ymeraj** analizojnë gjuhën e Kadaresë si një instrument të thellë për të zbërthyer psikologjinë e shqiptarit, përmes një sintakse të ndërlikuar dhe një leksiku të pasur.

6. Akademike **Floresha Dado**, përmes reflektimit mbi eseistikën e Kadaresë, thotë: “*Ajo është një sferë shumëplanëshe marrëdhënies me historinë, një magji më vete brenda krijimtarisë së tij*”

7. Prof. **Ymer Çiraku**, në studimin mbi “*Pasyra e një gruaje*”, e sheh këtë vepër si pjesë e një triptiku që mishëron frymën antidhunë dhe antitotalitariste.

8. Akademik **Vasil Tole**, në punimin e tij “**Kadareja për origjinën e tragjedisë nga vajtimet**” konkludon se burimi i tragjedisë kadareane nuk është dhuna, por **çlirimi nga dhimbja**, Autori e aktualizon gjykimin, duke përdorur si leitmotiv të punimit figuracionin kuptimplotë të Kadaresë për



realitetin aktual, ku “...*agjensitë e lajmeve, përleshjen e shkullen për flokësh si gratë*”, një gjendje që ngjan me vajtimin e një bote, që *përpiqet të kuptojë vetveten.*

Kështu përfundon ky numër special i revistës *Studia Albanica* 2024, 2. Këtë botim ne nuk e shohim vetëm si një akt akademik. Ai është një nderim i botës sonë shkencore ndaj një krijuesi, që me fjalën e tij, na mësoi se letërsia mund të jetë më e fortë se heshtja dhe më e përzetshme se çdo kufi politik apo ideologjik.

Në emër të Redaksisë dhe të gjithë atyre që punuan për këtë botim, dua të shpreh mirënjohje të thellë për kontributet e vyera dhe për bashkëpunimin akademik, që e bëri të mundur këtë numër. Ky është një nder i vogël për një figurë të madhe – por është një nder që do të mbetet, si gur kujtese dhe frymëzimi, në faqet e shkencës sonë shqiptare.

FATLUMË QË ISHIM BASHKËKOHËS TË TIJ

Ismail Kadare ishte vetëm 16 vjeç kur lbotoi krijimet e para. Me një karrierë letrare mbi 70-vjeçare, nga më të gjatat jo vetëm në letërsinë shqiptare, pjesa më e madhe e së cilës nën regjimin komunist, ai krijoi një vepër që mund të konsiderohet monumentale. I përkthyer në mbi 40 gjuhë, fitues i pjesës më të madhe të çmimeve letrare më prestigjioze, i konsideruar një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të kohës, mund të thuhet se më shumë çdokush tjetër ai kontribuoi që qindra mijëra njerëz në mbarë botën të zbulonin një vend të vogël si Shqipëria, madje edhe atëherë kur ajo e mbyllur tërësisht në vetëvete, bënte çmos të harrohej.

Sidoqoftë, unë s’kam ndërmend e as pretendimin që në këtë fjalë të shkurtër të analizoj universin aq kompleks të veprës së tij. Më poshtë do të ndalem vetëm në disa momente të jetës dhe të veprës së tij, që shpresoj se do të shërbejnë për ta vendosur figurën e Kadaresë në një perspektivë historike:

Siç dihet, para shfaqjes së Ismail Kadaresë në letërsinë shqipe, ajo ishte fare pak e njohur në botë, përtej cakut të një grushti studiuesish. Madje dhe ata shkrimtarë që fati i bëri të largohen prej vendit e që kaluan një pjesë të mirë të jetës së tyre në Perëndim (Koliqi, Camaj etj.) s’është se kjo i ndihmoi për t’u bërë të njohur jashtë qarqeve të specialistëve. Dhe ja, papritur, në vitet ’70-të të shekullit të shkuar shfaqet ky shkrimtar shqiptar, vepra e të cilit jo vetëm nis të përkthehet në mbarë botën, por që gjithnjë e më shumë dëgjon të shpallet fillimisht një ndër shkrimtarët më të shquar të letërsisë ballkanike, duke

Nga Piro Misha

Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë

e vendosur në krahë të nobelistëve të tillë si Ivo Andriç, Seferis apo Elitis. Dhe siç e dimë, pa kaluar shumë vite, dora dorës që shtoheshin veprat e tij të botuara nëpër botë, ky përfaqësues i një prej popujve më të izoluar nga bota, por dhe më të varfër e të prapambetur të Europës, që po ashtu kishte disavantazhin të shkruante në një prej gjuhëve të ashtuquajtura të vogla, shkrimtarët e të cilave e kanë gjithnjë objektivisht më të veshtirë të çajnë në botën e madhe, u bënë një ndër shkrimtarët më të përkthyer e të lexuar në nivel global.

Sipas një prej paradigmave të pranura gjerësisht, letërsia, arti i madh ka lindur gjatë historisë në vendet më të zhvilluara, si kurorëzim i një procesi, në një terren të përgatitur prej brezash të tërë paraardhësish të shquar. Gjë që përgjithësisht qëndron, po pate parasysh historinë e artit botëror, së paku deri në shfaqjen e globalizmit, kur kufijtë fizikë mes vendeve e kulturave relativizohen. Po gjatë historisë së letërsisë botërore kanë ekzistuar gjithnjë edhe përjashtime, raste kur individë të caktuar gjenialë arrinin që, pavarësisht pengesave të pakapërcyeshme për gjithë të tjerët, të kryejnë kapërcime të hatshme në raport me traditën e mëparshme letrare të ambientit në të cilin jetojnë. A s’është ky rasti me Kadarenë: një shkrimtar që duke jetuar në kushtet e një prej diktaturave me tiranike dhe më të pamëshirshme (së paku në Europë), e cila prej shkrimtarëve e

artistëve kërkonte një nënshtrim pa kushte, pra në një terren që supozohet të ishte krejt i papërshtatshëm për një krijues, ia del të krijojë një vepër e cila arrin të kapërcejë pengesa në dukje të pakapërcyeshme, duke ia dalë të pushtojë lexuesin e botës së madhe me mesazhin e vet universal.

Për të kuptuar atë kapërcim gjigand që ndodhi në prozën shqipe me Ismail Kadarenë, mjafton të kujtojmë nivelin në të cilin gjendej zhanri i romanit shqiptar para daljes së tij në skenë. Mund të duket ky një parashtrim disi provokativ, por unë mendoj se fenomeni Kadare duhet parë më shumë sesa produkt i natyrshëm i evoluimit të një letërsie të kultivuar, si produkt i asaj sinteze gjeniale që ai arriti mes asaj që ai vetë e quante ‘Shqipëria e përjetshme’, rrënjët e thella të së cilës ushqejnë gjithë veprën e tij, me trashëgiminë e letërsisë më të mirë botërore.

Themelet e veprës kadareane ushqehen nga rrënjët e hedhura thellë në humusin e popullit të vet, por po ashtu nga gurra e letërsisë më të mirë botërore të shkruar ndër shekuj. Modelet prej të cilave ai u frymëzua, siç e pohon ai vetë, janë emrat e mëdhenj të letërsisë botërore, nga Homeri e Eskili, Shekspiri, Dante, Servantesi, e deri te shkrimtarët e mëdhenj rusë, Gogoli, Dostojevski, apo dhe Majakovski.

Duke kaluar në një temë tjetër dëshiroj të shtoj diçka lidhur me debatin idiot që herë pas here nxjerr krye në median shqiptare



lidhur me faktin nëse Ismaili na paskesh qenë apo jo një disident ndaj regjimit, siç mund të ishte një Havel në Çekoslovaki, apo një Miçnik në Poloni. Them se është një debat idiot, sepse kushdo që e ka jetuar atë kohë e kupton fare lehtë se kushtet e Shqipërisë së periudhës enveriste e bënë këtë krejt të pamundur, sepse Shqipëria komuniste s’pati asgjë që do mund të krahasohej me gjendjen e Çekoslovakisë apo të Polonisë së pas vitit 1956, e cila bënte të mundur atë lloj disidence ku dramat e shkruara prej Havelit të burgosur, viheshin në skenë në teatrot e Pragës.

Kadareja s’ishte e s’mund të ishte një disident në atë kuptim që mori ky term për vendet komuniste kryesisht të Europës qëndrore, por vepra e tij përmbante qartazi elementë disidence ndaj vizionit që kishte regjimi lidhur me realitetin, botën, për të shkuarën e të ardhmen. Vepra e Kadaresë përbënte një lloj kundërkulture, duke sfiduar

(Vijon në faqen 5)

PËRSHËNDETJA E ZONJËS HELENA KADARE

Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Të respektuar dhe të dashur miq,

Iniciativa e Kuvendit të Shqipërisë dhe e Akademisë së Shkencave për të përkujtuar sot këtu Ismailin, më obligon t'ju shpreh të gjithëve një mirënjohje të thellë shpirtërore dhe një vlerësim po kaq të thellë familjar.

Natyrisht, kur bëhet fjalë për figurën e Ismail Kadaresë, unë jam e ndjeshme ndaj tonit elitar të folësve, në vlerësimin që i bënë veprës së tij letrare.

Ismail Kadare është një shkrimtar shqiptar që e ngriti metaforën e tij letrare në nivelin e frymëmarrjes kombëtare, që do të thotë se ai përshkoi me veprën e tij fatin e shqiptarit dhe të Shqipërisë, në tërë rrjedhën e historisë së saj.

Të gjithë e dimë se historia jonë ka qenë lufta për të mbijetuar, për të ekzistuar në tallazet tragjike dhe dramatike të shovinizmave dhe egoizmave çmendurakë, si pjesë e marrëzisë së botës ku jetojmë.

Ashtu si mbijetoi shqiptari dhe Shqipëria, mbijetoi edhe vetë Ismaili. Jeta e të cilit, në thelb, ishte jeta e Shqipërisë që kërkonte liri, barazi dhe progres, për të qenë në një radhë me përparimin botëror, në themelet e të cilit qëndron edhe historia jonë.

Edhe një herë faleminderit dhe respekt për të gjithë ju.

Ndërsa jemi bërë gati të dalin në shëtitjen e
mbrëmjes Kadare përshëndetet me Helenën

(Vijon nga faqja 3)

jo pak prej normave të konformizmit të letërsisë së regjimit, por mbi të gjitha vizionin e tij për botën, duke i dhënë një frymëmarrje krejt të re letërsisë shqipe.

Dëshiroj ta mbyll duke kujtuar një ndër ato elemente pa të cilët vështirësisht mund të kuptohet universi kadarean.

Po e filloj këtë me një konferencë të organizuar (s'e mbaj mend në ç'vit) në Lidhjen e Shkrimtareve për të diskutuar përmbledhjen e sapo botuar të Kadaresë, e cila përfshinte dhe novelën "Natë me hënë", për të cilën ishin hapur ndërkohë fjalë se qe kritikuar nga lart. Më kujtohet sesi te dera e Lidhjes priste sekretari i Lidhjes së Shkrimtarëve për letërsinë, i cili ishte aty për të porositur çdonjërin prej atyre që ishin në listën e folësve që të bënin kujdes me lëvdatat për Kadarenë. Po ajo që bëri më shumë përshtypje në atë konferencë, ishte fjala kryesore, e mbajtur prej Razi Brahimit, të konsideruar atë kohë si zëdhënës i kryesor ideologjik i regjimit në fushën e kritikës letrare. Në fakt ajo që bëri mjaft përshtypje në fjalën e tij s'ishin kritikë e tij në adresë të Kadaresë, nga që të gjithë në sallë e dinin se Raziu ishte një armik i kahershëm i Kadaresë. Ajo që bëri përshtypje ishte fakti që në vargun e tij të kritikave kësaj here qe shtuar diçka e re, e padëgjuar ndonjëherë më parë, gjë që të gjithë e dinin se s'mund të ndodhte pa patur pëlqimin e dikujt më lart. Në fjalën e tij Razi Brahimi u përqëndrua tek ajo që ai e quajti "europianizmi i Kadaresë". Term ky që se paku zyrtarisht s'qe përdorur më parë, por qe në fakt, kapte thelbin e vizionit të Kadaresë për atë që ai e quante 'Shqipëria e përjetshme'.

Ismail Kadareja mund të konsiderohet një ndër shkrimtarët më europianist që ka njohur letërsia shqiptare, vazhdues i denjë i asaj tradite që e kishte zanafillën te Rilindja Kombëtare. Ai mendonte se shqiptarët do duhej ta përkufizonin pa asnjë ekuivok vendin e tyre në histori si pjesë të qytetërimit europian, duke iu larguar një herë e mirë ndikimit të Orientit. Në një pjesë të mirë të veprës së tij gjen madje një kundërvënie gati skematike të nocioneve Europë e Azi, të ngjashëm në fakt me atë Erodorit në Greqinë e kohës së Salaminës dhe të Termopileve. Sipas Kadaresë rreziku për shqiptarët është shfaqur përherë nga Lindja, ndaj dhe e shihte si pjesë të misionit të tij si shkrimtar të bënte gjithçka që shqiptarët të shkëputeshin një herë e mirë nga joshja aziatike. Dhe për Kadarenë Azia ishte jo thjeshtë ajo e osmanllinjëve, por dhe ajo e Kinës dhe e hapësirës së pafund të stepave ruse. Kjo prirje e tij bëhet më e dukshme sidomos te cikli i romaneve që përbëjnë atë që mund të quhet 'cikli perandorak', ku si vend emigrimi letrar ai zgjodhi jo rastësisht Perandorinë Osmane, në të cilën ai shihte shtetin e parë që kishte ndërtuar një sistem të aftë dhe modern të nënshtrimit të njeriut, që për të qe njëherësh dhe pararendës i Bashkimit Sovjetik Stalinist, apo i Kinës maoiste. Apo dhe i Shqipërisë enveriste.

Ky merak i tij vazhdoi madje dhe atëherë kur Shqipëria u duk se më në fund e kishte zgjedhur njëherë e përgjithmonë fatin e vet historik. Atëherë kur dukej sikur era e Perëndimit kishte fituar tashmë përfundimisht mbi atë të Lindjes, kur megjithatë ai vazhdonte t'u kujtonte shqiptarëve se duhet të bënin gjithnjë kujdes për të mos ua lejuar vetes asnjë lloj joshje që mund t'i rrezikonte për t'u larguar sado pak nga rrugëtimi i nisur.

Për ta përfunduar, mendoj se shqiptarët duhet ta quajnë veten me fat që kemi një shkrimtar të përmasave të tilla si Ismail Kadareja. Ne të gjithë duhet ta konsiderojmë veten fatlumë që ishim bashkëkohës të tij.

DHEMBJA DO TË KALOJË, POR ARTI TUJ DO TË MBETET NJË MREKULLI E PËRJETSHME

Nga Bujar Hudhri

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Është privilegj dhe nder të flas para jush në përvjetorin e parë të ikjes së Kadaresë. Ndërkohë, e ndiej se sa e vështirë, e trishtueshme qenka për mua, si botuesi i tij, pikërisht në këtë orë të paradites kur niseshim për në kafenenë e tij të preferuar. Një ritual që vazhdoi me vite.

Por, përpara se të flas për marrëdhënien time me Kadarenë, e ndiej një detyrim moral të përmend dy emra shumë të rëndësishëm që kanë ndikuar në jetën dhe veprën e tij.

E para është Helena Kadare, dashuria dhe gruaja e jetës së tij. Helena është njeriu im më i afërt, që më ka dhënë gjithë gëzimet e kësaj bote dhe ndaj të cilës ndihem i detyruar për gjithçka. Janë fjalët e tij, thënë në fund të jetës si një kurorë për këtë marrëdhënie të gjatë mes tyre, që nisi nga dashuria e të dyve për letërsinë. Kultura shqiptare do t'i jetë mirënjohëse zonjës Kadare, përjetë.

Emri i dytë është i Klod Dyranit, legjenda e botimit francez, i cili nuk ishte thjesht botuesi, por miku i tij besnik, mbrojtësi i tij dhe përfaqësuesi i perëndimit, që diti t'i japë në kohë mesazhin e qartë udhëheqjes komuniste shqiptare se ishin mjaft të vëmendshëm ndaj asaj ç'mund t'i ndodhte Kadaresë.

Shtëpia botuese është shtëpia e dytë e shkrimtarit, në rastin më të mirë, është shtëpia e vërtetë e shkrimtarit. Do ta dëgjoja për herë të parë nga Kadare këtë fjali e cila ishte përcaktuese në këtë bashkëpunim jo të zakonshëm midis një autori botëror dhe një botuesi të ri, në moshë dhe profesion, këtu e tridhjetë vjet të shkuara.

Sikundër shtëpia e shqiptarit (e botuesit, do të saktësoja) është e zotit dhe mikut. Zoti, apo Hyu për këtë shtëpi ka qenë dhe mbetet vetëm një: gjeniu Kadare. Mysafirët apo miqtë, kanë qenë dhe janë të gjithë shkrimtarët e tjerë të letërsisë shqipe.

Në këtë rrugëtim të gjatë, pata fatin e lumtur të shihja nga afër mbretërinë e krijimit pranë një gjeniu si Kadare. Dhe për t'ia sjellë lexuesit magjinë e tij në formën e librit, në këto vite të vështira të tranzicionit e kam parë botimin thjesht si art.

Kam qenë i përfshirë kryekreje në një botë që sfidonte grinë e përditshmërisë, dhe më ka mbajtur në këmbë besimi te letërsia e Kadaresë. Një besim i ngjashëm si besimi tek hyjnia, po të perifrazoja një shprehje të tij.

Korriku i këtij viti erdhi po aq i nxehtë sa ditën që iku Kadare. Nëse ka diçka që nuk mund t'i përfytyroj pranë njera tjetrës, është pikërisht moti i nxehtë dhe emri i tij. Shkrimtarit që në veprën e tij përshkruan shiun, dëborën dhe acarin, pikërisht, kjo vapë i kujtonte një kontinent tjetër. Ia kam ulur disa gradë temperaturën Shqipërisë në veprën time, më thoshte shpesh.

Nga ajo ditë e një korrikut të kaluar, më kanë mbetur të pashlyera në kujtesë pamja e valixheve në sallonin e apartamentit, gati për udhëtim e radhës. Kështu e përfytyroj përherë, në fluturim drejt planetit letërsi, por, tashmë pa kthim. Dhimbja për ikjen e tij do të kalojë, por thesari që ka lënë për ne dhe brezat që do të vijnë, në çdo vend dhe gjuhë të botës, do të mbesë përjetësisht.

Sikundër ka thënë një poet i madh, një vepër e bukur arti është një gëzim i përjetshëm.



Një takim me botuesin francez në rezidencën e Kadaresë në Qerret

Nga e majta në të djathtë: Klod Dyrani, Bujar Hudhri,
Ismail dhe Helena Kadare, Suzana Hudhri

Departamenti i Letërsisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka organizuar të hënën, më 30 qershor 2025, në Bibliotekën Universitare Shkodër, konferencën shkencore kushtuar krijimtarisë së shkrimtarit Ridvan Dibra, e cila kishte në fokus poetikën e veprës së tij letrare.

Konferenca shkencore u organizua në kuadër të projektit shkencor “*Vepra letrare e Ridvan Dibrës në avangardë të letërsisë shqipe*” mbështetur nga Universiteti i Shkodrës. Ajo tuboi pesëmbëdhjetë studiues – profesorë universitarë, shkrimtarë dhe ish-studentë të shkrimtarit dhe pedagogut Dibra – nga Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi, të cilët nxorën në pah vlerat artistike të veprës letrare të këtij autori në kontekstin e letërsisë shqipe.

Në fjalën e hapjes, drejtori i Departamentit të Letërsisë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, prof. as. dr. Arben Prendi, ka vënë në dukje se studimi i veprës letrare të shkrimtarit Ridvan Dibra i shërben edhe vetë studimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare, e cila, për shkak të afërsisë kohore të studiuesve me të, ka mbetur relativisht e pastudiuar. “Konferenca është edhe një shenjë e vlerësimit për autorin, i cili këtë vit doli në pension si pedagog në Departamentin e Letërsisë, por vijon krijimtarinë letrare, e cila nuk e njeh pensionimin”, ka thënë ai.

Ndërsa zëvendësrektorja e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, prof. dr. Blerta Dragusha, e ka cilësuar shkrimtarin Ridvan Dibra si një prej zërave më të veçantë dhe më të fuqishëm të letërsisë bashkëkohore shqiptare. “Sot jemi mbledhur këtu jo thjesht për të folur për një emër të njohur të letrave shqipe, por për të nderuar një krijues që ka sfiduar vazhdimisht kufijtë e gjuhës, formës dhe mendimit letrar. Vepra e Ridvan Dibrës është një univers më vete, ku absurdi dhe realiteti ndërthuren, ku ironia bëhet një mjet i thellë filozofik dhe ku fjala merr një peshë të jashtëzakonshme në zbërthimin e njeriut dhe shoqërisë”, është shprehur ajo në fjalën përshëndetëse.

Fjalë miradije për shkrimtarin Ridvan Dibra ka shprehur edhe prof. dr. Alfred Çapaliku, duke e vlerësuar lart krijimtarinë e tij letrare ndërsa u ndal në një vështrim mbi veprën “Franc Kafka I shkruan të birit”.

Në vijim të konferencës, studiuesit kanë trajtuar aspekte të ndryshme të krijimtarisë së frytshme letrare të shkrimtarit Dibra, e cila përbëhet prej 18 romaneve, 8 përmbledhjesh me tregime dhe novela, disa dramash, një poeme etj.

Në kumtesën e tij “*Kujtesa krijuese e R. Dibrës: Ekspresionizëm dhe hiper-realizëm*”, dr. Virion Graçi nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë – Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka thënë se ekspresionizmi dhe hiper-realizmi tek Dibra nuk mund të bëjnë pa njëri-tjetrin. “Kur e fokuson optikën narrative në kufijtë e përvetshëm të egos – e kjo ndodh shpesh, duke na dhënë një sërë ‘portretesh’/romanesh autobiografikë – i vjen e nevojshme tharja e ndodhisë, ndërprerja e rrjedhës së ngjarjeve ose diskursit dekorativ, bëhet kalimi në përkufizime kuazi-teorike, në degëzime informative të përimtësuar, jo të natyrës fikzionale”, ka pohuar ai.

Shkrimtari dhe profesori universitar Ag Apolloni nga Kosova, duke folur për “*Dy anët e krijimtarisë së Ridvan Dibrës*”, ka thënë se proza është ana e ndritshme, kurse drama, ana e errët e këtij autori. “Prandaj, kur flasim për profilin e Ridvan Dibrës, krahas profilin të ndritshëm prej prozatori, duhet të flasim edhe për profilin e pandriçuar të tij. Pra, krahas Dibrës së zbuluar (të botuar dhe të studiuar), kemi edhe Dibrën e pazbuluar (të painskenuar, të pabotuar dhe të pastudiuar). Vetëm studimi

Në Shkodër u organizua konferenca shkencore
“Poetika e veprës letrare të Ridvan Dibrës”

VEPRA E DIBRËS, NJË UNIVERS MË VETE

Përgatiti Ismet Kallaba

“Studimi i veprës letrare të këtij autori i shërben edhe vetë studimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare, e cila, për shkak të afërsisë kohore të studiuesve me të, ka mbetur relativisht e pastudiuar. Konferenca është edhe një shenjë e vlerësimit për autorin, i cili këtë vit doli në pension si pedagog në Departamentin e Letërsisë në Universitetin e Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, por vijon krijimtarinë letrare, e cila nuk e njeh pensionimin”, ka thënë në fjalën e hapjes Prof. as. dr. Arben Prendi, drejtor i Departamentit të Letërsisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.



i të dy anëve do të na e jepte portretin e plotë të tij”, ka thënë ai.

Në kumtesën *Përtej postmodernizmit: Paralelizmi figurativ dhe poetika e ironisë në romanin Gjumi mbi borë të Ridvan Dibrës*, prof. as. dr. Gëzim Puka vëren se krijimtaria e Ridvan Dibrës në dekadat e fundit dëshmon një lëvizje të matur dhe të vetëdijshme përtej estetikës së njohur postmoderne. Sipas tij, “kontributi më i madh i Ridvan Dibrës në prozën shqipe është se e bën atë më lirike, përmes zhytjes në intimitete shpirtërore. Ironia postmoderne, që ia vënë shpesh në dukje, është thjesht një mbulesë e zgjuar që fsheh frikën e zbulimit të dobësive të njeriut botëkrijues. Lexuesi i mirë i letërsisë i ka qejf dobësitë e njeriut, prandaj Ridvan Dibra është ndër shkrimtarët më emancipues që njoh”.

“Një lexim jolinear dhe tematik i romanit *Gruaja që deshe* i Ridvan Dibrës: një qasje përmes mjeteve digjitale” ka sjellë në kumtesën e saj dr. Sabina Osmanovic nga Universiteti i Malit të Zi.

“Për korpusin e Ridvan Dibrës, vëzhguam variacione të rëndësishme stilistike dhe zgjedhje narrative në veprat e tij”, ka thënë ajo, duke nënvizuar se mjetet digjitale ofrojnë mënyra të reja dhe të fuqishme për të analizuar tekstet letrare, duke zbuluar modele jo lehtësisht të dallueshme përmes leximit tradicional linear.

Duke folur për “Autobiografizmin në romanet e Ridvan Dibrës”, prof. as. dr. Arben Prendi konstaton se ai është i pranishëm në disa prej romaneve të këtij autori, si: *Gjumi mbi borë, Në kërkim të fëmijërisë së humbur, Franz Kafka i shkruan të birit, Dashuritë e virgjërshës Madalenë, Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë* etj. “Në romanet me temë autobiografike, autori kërkon dhe bën estetizimin e jetës së tij të përditshme

me ngjarjet e vogla që bëhen të mëdha apo anasjelltas. Kuptohet, siç ndodh edhe me shkrimtarë të tjerë, nga e veçanta kalohet tek e përgjithshmja. Ndoshta e veçanta e trajtimit të temës autobiografike qëndron në faktin se, ndërsa zakonisht tek shkrimtarët e tjerë autori fshihet pas narratorit dhe personazheve, këtu autori del hapur dhe e zbulon veten me emër dhe mbiemër, madje edhe me profesion etj. Në këto romane shkrihen “autori biografik me personazhin artistik dhe me narratorin”, por edhe me lexuesin hipotetik”, ka cilësuar ai.

Prof. as. dr. Rrezarta Draçini nga Universiteti i Shkodrës, duke u mbështetur në romanin *Të lirë dhe të burgosur* të autorit Ridvan Dibra, ka trajtuar çështjen e lexuesit dhe procesimit psikolinguistik të teksteve të pandërprera. “Leximi i një romani pa asnjë shenjë pikësimi, pa asnjë element që na ndihmon në segmentimin gjuhësor, duket si i pamundur. Ndërkohë që romani *Të lirë dhe të burgosur* i prof. Ridvan Dibrës është prova që vërteton të kundërtën: kemi një roman që rrjedh dhe lexuesin e fut në botën e tij”, ka konstatuar ajo.

Dr. Merita Hysa nga Universiteti i Shkodrës është përqendruar te roli i gjuhës në krijimin e strukturës narrative te romani *Gjumi mbi borë* i shkrimtarit Ridvan Dibra. “Gjuha tek romancieri Dibra nuk është vetëm një formë apo mjet komunikimi – ajo është pasqyrë e gjithë atyre ndjesive që na shfaqen në trajtë prozaikë me qëllim krijimin e një ndjeshmërie të veçantë në receptimin e veprës. Gjuha bëhet një instrument i sofistikuar që krijon botë, që ndërton realitete të reja dhe që fton lexuesin në një dialog të vazhdueshëm me tekstin, përmes një sintheze të sofistikuar mes elementeve gjuhësore, strukturave narrative dhe efekteve estetike, duke transformuar

gjuhën në një instrument kompleks që tejkalon funksionin e saj thjesht referencial”, ka konkluduar ajo.

Dr. Ermira Alija nga Qendra e Studimeve Albanologjike të USH-së ka trajtuar metafizikën e dashurisë (dhe martesës) në romanin *Gruaja që deshe* të Dibrës. Nëpërmjet metafizikës si koncept, ajo në artikullin e saj përpiket të ndriçojë universalen e romanit dhe, nëpërmjet analizës së detajeve të stilit, përpiket të tregojë krizën e metafizikës, por jo zhdukjen e saj, si dhe interpreton disa fenomene të tematikës së romanit përmes disa koncepteve teorike të karakterit social, psikologjik apo filozofik.

Studiuesi Andreas Dushi, në kumtesën e tij “*Bala, antiheroi tipik i letërsisë shqipe*”, ka theksuar se rasti më konkret kur vetmia kthehet në identitet është ai i personazhit të Balës në *Legjenda e vetmisë*. “Për mendimin tonë, Bala është antiheroi më përfaqësues i gjithë letërsisë shqipe. Në secilin kapitull flitet për vetminë e Balës, por gjithashtu nuk lihen pa u përshkruar edhe sjellje të tjera që na pasqyrojnë karakterin e tij, të tilla si pasiguria, dështimi, frika, zhgënjimi, dorëzimi etj.”, ka nënvizuar ai.

Eronita Kqiku nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ka folur për “*Diskurset gjinore në dy romane të Dibrës (Nudo dhe Dashuritë e virgjërshës Madalenë)*”. Ajo ka vlerësuar se ky shkrimtar paraqet një rast krejt të veçantë në historinë e letërsisë shqipe, referuar perspektivave dhe diskurseve të ndryshme që vijnë nga i njëjti autor. “Në njërën vepër e gjejmë diskursin fallocentrik, në tjetrën diskursin gjinocentrik. Te këto proza, diskurset e tilla dalin si vetëdije letrare dhe si stil i shkrimtarit, që në përgjithësi dallohet për eksperimentet letrare”, ka vlerësuar studiuesja.

Në kumtesën e saj “*Poetika e romanit Dashuritë e virgjërshës Madalenë të Ridvan Dibrës*”, studiuesja e letërsisë Agnesë Shkodra nga Kosova ka pohuar se, edhe pse i botuar në vitin 2018, ky roman ende nuk e ka marrë vëmendjen e merituar nga kritika letrare shqiptare në aspektin e analizave më të thella. Duke analizuar strategjinë narrative, ajo arrin në përfundimin se “*Dashuritë e virgjërshës Madalenë*” është një roman i ndërtuar mbi një poetikë pluraliste, ku ndërthuren nivele të ndryshme kuptimore dhe stilistike, çka e bën tekstin të qasshëm si për lexuesin empirik, ashtu edhe për atë model. Kjo poetikë e shumëfishtë, tipike për letërsinë postmoderne, nxjerr në pah jo vetëm vlerat estetike të romanit, por edhe funksionin e tij si vepër që sfidon pritshmëritë tradicionale në letërsinë bashkëkohore shqiptare”.

Një “*Shtegtim në labirinthe narrative të veprës së Ridvan Dibrës*” ka paraqitur në kumtesën e saj Britni Gera, ish-studente e programit të studimit Gjuhëv- Letërsi në Universitetin e Shkodrës. “Struktura narrative në veprat e Dibrës është në mënyrë të përsëritur interaktive, ku lexuesi përfshihet si pjesë aktive e tekstit. Përdorimi i vetës së dytë përforcon këtë përfshirje, duke i atribuar lexuesit një rol bashkautorësie në zhvillimin e rrëfimit. Në romanin *Stina e ujkut*, për shembull, lexuesi qëllimisht çorientohet dhe ngel i pasigurt nëse duhet të identifikohet me njeriun, bishën, me të dy ose me asnjërin”, theksoi ajo.

Rreth qasjes përkthimore të romanit *Legjenda e vetmisë* në gjuhën frënge, më konkretisht një vështrim teorik dhe kulturor, ka paraqitur në kumtesën “Bala në kufijtë e vetmisë: Legjenda, psikologjia dhe përkthimi i një universi letrar”, prof. as. dr. Drita Brahimi, pedagoge në Departamentin e Romanistikës të Universitetit të Shkodrës. Ajo ka vlerësuar

punën e jashtëzakonshme të përkthyeses Évelyne Noygues, që sipas saj dëshmon për një njohje të thellë dhe të hollësishme të nuancave stilistikore të thjeshta, por domethënëse, të shkrimtarit Ridvan Dibra. “Si lexuese dygjuhëshe, pohoj me bindje se kam përjetuar të njëjtën kënaqësi gjatë leximit të romanit në frëngjisht, pasi përkthimi ruan rrjedhshmërinë dhe integritetin e tekstit origjinal. Përkthyesja ka respektuar me përpikëri strukturën e çdo kapitulli, duke integruar me kujdes leksemat dialektore, përdorimin e shkronjave të mëdha dhe kllapat, të cilat janë elemente të veçanta të stilit të autorit”, vërejt studiuesja Drita Brahimi.

Në kumtesën e saj, Klevisa Bardeli nga Universiteti i Shkodrës është përqendruar në analizën psikologjike të dy veprave: Stina e ujkut dhe Legjenda e vetmisë të Ridvan Dibrës, të para në dritën e psikanalizës së Frojdit dhe të teorive të tjera psikologjike, kryesisht në dimensionet e vetmisë, pavetëdijes dhe traumës. Ajo arrin në përfundimin se: “Ridvan Dibra është jo vetëm një prozator i rëndësishëm në aspektin e krijimit letrar, por edhe një eksplorues i psikikës njerëzore, që përmes gjuhës së figurshme dhe strukturave narrative introspektive, ndërton ura mes letërsisë, psikologjisë dhe filozofisë. Vepra e tij, përtej bukurisë estetike, ngre pyetje thelbësore mbi natyrën njerëzore, mbi procesin e përballjes së individit me dhimbjen, me vetminë si gjendje ekzistenciale dhe mbi mekanizmat me të cilat njeriu përpiqet të rikthejë kuptimin e jetës”.

Mbi “*Elementet letrare që përmbush vepra e Ridvan Dibrës për të qenë pjesë e programeve shkollore në AML*” ka kumtuar Laureta Bruka. Ajo argumentoi se “...letërsia e Dibrës përmbush kriteret që përcakton kurrikula: vlera artistike dhe gjuhësore, përputhshmëri me nivelin mendor dhe emocional të nxënësit, aftësia për të nxitur mendimin kritik dhe ndërgjegjësimin qytetar. Veprat e tij, përveç kompleksitetit stilistik dhe përmasës simbolike, kanë një forcë të veçantë ndërveprimi emocional me lexuesin e ri, duke i ofruar mundësinë për të njohur dhe emërtuar përvoja të brendshme që shpesh mbeten të patrajtuara në tekstet klasike”.

Aktet e kësaj konference do të botohen së shpejti në një përmbledhje të veçantë.

Studentët, lexuesit e parë të Dibrës

Shkrimtari Ridvan Dibra, i njohur për thjeshtësinë dhe modestinë e tij, është shprehur se ka pasur privilegjin të punojë si pedagog në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se lexuesit dhe vlerësuesit e parë të veprës së tij kanë qenë studentët e letërsisë, të cilët shpesh i kanë dhënë përshtypjet e para dhe e kanë nxitur e frymëzuar për të vijuar rrugën e krijimtarisë letrare.

Letra e Çapalikut

Në pamundësi për të qenë i pranishëm, shkrimtari Stefan Çapaliku në letrën e tij drejtuar shkrimtarit Ridvan Dibra, shprehet ndër të tjera: “Ti, i dashtun Ridvan, je një figurë shumë e randsishme e letrave shqipe, jo thjesht se qe krejtësisht i pranishëm atëherë kur ra ‘Muri’, porse me letrat tueja dhe një dorë që ky ‘Mur’ të rrëzohet dhe të thyejë qafën, jo veç në politikë dhe jetën shoqnore, por edhe në letërsinë tonë”.

Mbi romanin “Lindur së prapthi” të Rita Petros

Kur të qenit së prapthi në një botë si kjo jona nuk është mallkim, por urim

Nga Anxhela Pashaj

“Lindur së prapthi” është një roman autobiografik nga autorja Rita Petro, i cili vërtitet rreth jetës, përvojave, ndjenjave, mendimeve të një vajze të vogël që rritet mes dy kohëve shumë të ndryshme politike, diktaturës komuniste dhe demokracisë. Rrëfimi lëviz në dy kohë, të shkuarës për të cilën vajza rrëfen dhe të tashmes që me ngacmimet e veta e rikthen vajzën në kujtimet e së shkuarës.

“Lindur së prapthi” i komunikon qysh në titull lexuesit të tij se ky roman është për ata që janë së prapthi, që bota i gjykon si të tillë, që janë ndryshe jo si të gjithë vdekatarët e tjerë. Të qenit së prapthi, ndryshe, këtu (në roman) është e lindur e për rrjedhojë nuk mund të zhbëhet sado fortë që njeriu të përpiqet për t’u bërë si të tjerët. Nga ana tjetër ky titull të lë të mendosh se kemi të bëjmë me një përçudni, një mallkim, që do t’i paralizojë jetën personazhit të rrëfimit, mirëpo gjatë rrëfimit kjo nuancë, ky mendim nis edhe venitet, pasi të lindurit së prapthi shpërfaqet si të qenit mbarthi, jo në botën tonë dhe as asaj të vajzës, por në një botë ku liria dhe dashuria gjallojnë, në botën e ideve.

Rrëfimtari, në rastin e këtij romani është zëri i një femre, një vajze të vogël, një gruaje, e cila e nis rrëfimin duke na prezantuar me veten e saj, të lindurit anapodha, së prapthi, familjen e saj dhe lidhjet emocionale mes tyre; duke na vënë përballë patriakatit të kohës, se si dukej figura atërore në sytë e një fëmije. Një figurë e gjithëpushtetshme që vendos mbi fatin e të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes si të ishte një zot.

“Zoti jetonte dikur në shtëpinë time.”

...

“Ai ishte zoti trupmadh, me sy të kaltër, cullufe flokësh të dendur, me onde. Ai ishte aq zot, saqë, kur kalonte nga njëra dhomë te tjetra, askush nuk mund t’i dilte përpara. Ne mbështeteshim te muret ose pas perdeve.”

Kjo figurë atërore lëviz nga familja në shoqëri duke marrë formën e një personazhi tjetër, jo më vetëm patriakal, por edhe diktatorial, Udhëheqësi i Madh. Në romanin “Lindur së prapthi” është mjaft interesante se si shkruhet figura e Udhëheqësit të Madh, në fillim të rrëfimit nga syri i fëmijës, ai është një qenie e paprekshme që u jep emocione thujse pozitive të vegjëlve, të cilët mezi prisnin të kishin një takim me të. Nga ky

grup i adhuresve nuk bën përjashtim as vajza e vogël, duket se ëndrra e saj është të takohet të paktën një herë me Udhëheqësin e Madh.

Treguar me zërin e fëmijës kjo dëshirë e vajzës tingëllon e pafajshme, pasi ajo ende nuk i di pas-skenat e udhëheqjes së Udhëheqësit të Madh. Ajo nuk i njeh rreziqet e të kundërshtuarit regjimin e tij, nuk e di se të gjithë janë pjesë e një komuniteti të helmuar, vrojtues, arsyeja e rënies dhe shkatërrimit të tjetrit. Por, nuk do të vonojë për të mësuar se shtëpitë janë plot çimka, se disa njerëz janë më të pastër se të tjerët për regjimin, se kush nuk është i pastër zhduket në një cep tjetër të vendit, se disa u dënuakan për imoralitet, se po të dalësh dëshmtar për “imoralitetin” e dikujt mund të ngjitesh lart drejt Udhëheqësit të Madh, se as mendimet dhe ndjenjat nuk janë të sigurta dhe se mund të spiunohen dhe ta pësosh. Të gjitha këto e tronditin shpirtin e fëmijës dhe e venitin dëshirën për të takuar Udhëheqësin e Madh.

Një arsye tjetër pse vajzës së re i zbehet dëshira për ta takuar Udhëheqësin e Madh është fakti se të tjera dëshira nisin të gjallojnë brenda saj. Dëshira që ndërliiden me njohjen fizike dhe emocionale të vetes. Pavarsisht normave të kohës dhe shoqërisë, vajza e vogël nuk stepet për të kërkuar dhe zbuluar veten. Herë - herë gjatë rrëfimit lexuesi vëren se normat morale dhe politike të vendosura nga shoqëria duket se gjallojnë jashtë vajzës, ndërsa ajo gjallon në bazë të disa normave të tjera të përcaktuara nga vetë ajo.

Me naivitetin e saj, vajza na tregon se si rritet, si e përjeton zhvillim fizik për të cilin nuk i ka treguar kurrkush ndonjë hollësi, se si ndryshimet fizike ndryshojnë anën emocionale dhe se si bota e re e saj nis dhe merr formë.

Në roman ka një prezencë të gjerë të figurës femërore, duke nisur me gjyshen, mamën, motrën, fqinjeve, shoqeve të klasës, të cilat përshkruhen dhe rrëfihen me të gjitha ngjyrat dhe shqetësimet e tyre. Gra që dallojnë shumë nga personazhi – rrëfyes - grua, e cila nuk i trembet dëshirave të veta. Ajo është e bindur për t’i shkruar çdo zbulimi deri në fund, për të njohur veten pa patur ndonjë ndjenjë turpi. Të njohësh vetveten nuk u përket burrave, por njeriut. Njeriu duhet të njoh limitet e veta, e për t’i njohur ato duhet të provojë, të tentojë në të kundërtën mbetet në kurthin e frikës.

Intermexo, “Trotuari i mesit” është një nga kapitujt më interesant të romanit “Lindur së prapthi” ku edhe aty ndihet prania e figurave femërore, por jo vetëm; gra dhe burra të cilët janë ndryshe, ndryshe nga ç’ka e kërkon morali i shoqërisë së kohës, të papranuar, të pakuptuar, të keqkuptuar, të braktisur nga njeriu. Imazhe që ngjallin dhimbje. Imazhe që të kujtojnë se të qenit njeri duhet të qëndrojë mbi çdo besim tjetër që ne mund të kemi, që mund të ruajmë brenda vetes.

Figura si Maria, Linda, Zhaneta, Liza, Tedi, Kastrioti, Goni, Ladi janë të vështirë për t’u harruar. E si mund të harrohen kur edhe sot, në mos në trotuarin e mesit, gjenden në çdo kënd të vendit. Trotuari i mesit është trotuari i dhimbjes, i thyerjes shpirtërore, i cili vështrohet nga personazhi – rrëfyes – grua me dhimbje e keqardhje.

Njeriu i përjashtuar është një nga nyjet tematike të këtij romani. Njeriu i përjashtuar nga sistemi, nga shoqëria, nga bota qoftë ky burrë apo grua. Nëse nuk je siç të kanë parashikuar, nuk mund të jesh i pranuar, nuk mund të bëhesh pjesë e së tërës. E bukura e së tërës është se ka kuptim vetëm nga shumëllojshmëria. Diversiteti nuk është për t’u patur frikë, por për t’u përqafuar, për t’u pranuar. Të qenit së prapthi në një botë si kjo jona nuk është mallkim, por urim.



1.

Përherë e më tepër në shtypin tonë dëgjojmë të artikulohej më me guxim termat Poezi/Letersi Moderne, Post Moderne/ Metafizike/...

Deri në vitin 1991 termat e tilla ishin një arsenal për të goditur në shënjestër autorët që guxonin të devijonin rrugën e shënjtëruar të soc-realizmit. Këto terma zakonisht përdorehin prej kritikëve dhe studjuesve të letersisë, të cilët kishin marrë përsipër rolin e gardianëve të pastërtisë së letersisë dhe arteve, për ta ruajtur me fanatizëm virgjiritetin e shënjtëruar ideologjik të krijuesve. Ishin terma që preosupozoheshin se krijuesit fatkeq që ekzaminoheshin si të prekur nga simptomnat e Modernizmit, postmodernizmit, Metafizikes (shpesh herë pa qenë të vetëdijshëm vetë autorët), qenë të prekur jo më pak se nga kolera a lebroza... Të dytët që preferonin përdorimin e këtyre termave, pas kritikëve, ishin natyrisht njerëzit që ndodheshin në krye të censures, me detyren e mbrojtjes së letersisë dhe arteve prej mundësisë së molepsjeve ideologjike, për të dalluar që në embrion shenjat e para të ndikimit prej artit modern, post-modern/metafizik...Ironikisht, ishin kritikët dhe studjuesit e letersisë që jepnin të parët alarmin për ndonjë shënj sado të vogël a të ndrohur të këtyre ndikimeve, me reagimin e menjëhershëm të kalimit të këtij alarmi në zyrat e shefave të vet...

Nuk dua të zgjatem në këtë temë e cila është e njohur nga të gjithë krijuesit e shoqërisë shqiptare para viteve '90. Dhe as nuk më shkon ndërmend të marrë përsipër rolin e gjykatësit, për t'i gjykuar kritikët e censorët e kohës....Qëllimi im në këtë shkrim është fenomeni i sotëm i riciklimit me kokë poshtë i po këtyre termave në kritikën dhe studimet letrare sot. Dhe ndodh- jo krejtësisht në mënyrë të pashpjegueshme, -se janë pikërisht kritikët më vigjilent të para viteve '90, ata që flasin në mënyrën më të favorshme për modernizmin, post-post modernist...Duke i përdorur këto terma si lavdërime për autorët përkatës modern a post modern. Duke mos iu shkuar ndërmend se modernizmi a post modernizmi, ashtu si dhe realizmi, romantizmi a natyralizmi janë thjesht terma të Historisë së Letersisë, për të klasifikuar rryma të ndryshme dhe kanone të ndryshme të krijimtarisë letrare dhe artistike, që nuk i sigurojnë vetvetiu suksesin veprës së veçantë letrare, vetëm e vetëm se autori i saj ka shkruar sipas kanoneve të një rryme letrare. Modernizmi, ashtu si Realizmi a Natyralizmi, kanë veprat dhe autorët e tyre të suksesshëm, siç kanë dhe autorët dhe veprat e tyre mediokre. Madje, shkrimtarët e talentuar asnjëherë nuk e ndjejnë veten rehat brenda klasifikimit të ngushtë të një rryme të veçantë letrare dhe artistike, sepse një shkrimtar i gjërë dhe veprat e tij mund të ketë në veteve dhe elementët romantikë, dhe natyralistë, dhe realist dhe post -modernist njëherësh. Mjafton të marrim një shkrimtar të madh Rus, Nikolaj Gogol, për t'u bindur për këtë. Kjo është dhe arsyeja përse shkrimtari argjentinas Jorge Luis Borges ngulte këmbë se një shkrimtar i vertetë ndodhet gjithmonë jashtë klasifikimit të rrymave letrare.

Kurreshtja ime këtë radhe, është veçse një impuls sipërfaqësor, që ma krijoi leximi i një poezie shumë të njohur të Wallace Stevens-it, duke shprehur dëshirën time që ndonjë studjues i kalibrit të Ardian Vehbiut, a revista e tij prestigjioze ' Peisazhe të Fjalë' psh, të jepnin mendimin e tyre për fenomenin që do të shpreh më poshtë.

Pas viteve '90, si të prekur nga një *wand* magjik, shumë terma dhe koncepte ndryshuan pozicionet e veta të përdorimit : Koncepti letrar dhe artistik -realizëm, aq i stërlavdëruar më parë, u bë simboli i një arti që nënkuptonte mediokritetin, rrafshimin e fantazisë krijuese. Dhe po ashtu, falë *wand-it* çudibërës, personazhet negativë ndrruan vendet me personazhet e dikurshëm positive, dhe anasjelltas. Madje dhe elementët biografikë, aq të pëlqyeshme për soc-realizmin, u përdorën, natyrisht me kokë poshtë, dhe për letersinë post moderne a modern. Këtë rradhë një shkrimtar që kishtë bërë burg gjatë Komunizmit, a që kishte shkruar poezi në burgjet e komunizmit, provonte se mund të qe kandidati i parë i letersisë moderne dhe të sukseshme...

Sot ka shumë shkrime për letersinë moderne dhe metafizike prej studjuesve dhe kritikëve më skematikë të kohës së kaluar. Por problem është se nuk mund të gesh qoftë dhe një tekst që ata e quajnë modern/postmodern që të analizohej prej tyre, me qëllimin që lexuesit ta kenë të qartë se ç'është në të vertetë një krijim modern/post-modern...Kritikët tanë duket se pëlqejnë vetëm përdorimin e termave, dhe jo aplikimin e tyre në zbërthimin e teksteve letrarë. Siç duket ky fenomen ka qenë një shqetësim dhe për vetë letersinë amerikane të viteve '30 dhe '40, kohë kur Wallace Stevens e shkroi dhe e botoi poezinë që do analizojmë më poshtë.

Për këtë arsye, mendova ta sjellë të përkthyer poezinë

Poezia “Mbi Poezinë Moderne” e Wallace Stevens

ANALIZA E NJË POEZIE EMBLEMATIKE MODERNE...

Nga Rudolf Marku

e njërit nga poetët më autoritarë të poezisë se shekullit të XX . Si një shembull se si mund të analizohej një poezi e vetme e një autori, për të provuar përkthashmërinë estetike të tij. Poezia e Wallace Stevens është e lidhur drejtpërdrejt me temën që kam hapur ('to open a can of worms-thuhet në anglisht – të hapësh një kanaçe me krimba). Titullohet : “Për poezinë moderne”.

Pasi ta lexonit këtë Poezi, ju lutem të keni durimin që të lexoni dhe një analizë të përgjithshme rreth kësaj poezie dhe autorit të saj. Analiza është një miksazh mendimesh dhe opinionesh rreth saj nga autorë të ndryshëm. Gjithsesi, vetë poezia e mjeshtrit Wallace Stevens mendoj se na jep mundësinë që të shohim dhe një koncept tjetër për poezinë moderne, natyrisht, një koncept favorizues, por krejt i ndryshëm nga ajo që shprehin përgjithësisht- me ndonjë përjashtim të vogël- studuesit tanë dhe kritikët tanë.

Wallace Stevens

Mbi Poezinë Moderne

Poema e mendjes në aktin e kërkimit

Të asaj që do mjaftonte. Nuk ka qenë gjithmonë

Që të gjënde; skena ishte gati; përsëriste

Ato që ishin në skenar.

Pastaj teatri u ndryshua

Në diçka tjetër. E kaluara e tij mbeti si një suvenir

Duhet të jetë e gjallë, të mësojë gjuhën e vendit.

Duhet të përballlet me burrat e kohës dhe të takojë

Gratë e kohës. Duhet të mendojë për luftën

Dhe duhet të gjejë atë që mjafton. Duhet

Të ndërtojë një skenë të re. Duhet të jetë mbi atë skenë

Dhe, si një aktor i pangopur, ngadalë dhe

Me përqendrim, të flasë fjalë që në vesh,

Në veshin më të ndjeshëm të mendjes, përsërisin,

Saktësisht, atë që dëshiron të dëgjojë, në tingullin

E të cilit, një audiencë e padukshme dëgjon,

Jo dramën, por veten, të shprehur

Në një ndjenjë si e dy njerëzve, si e dy

Emocioneve që bëhen një. Aktori është

Një metafizicien në errësirë, që tingëllon

Një instrument, që prek një tel të hollë që jep

Tinguj që kalojnë në një saktësi të befasishme, plotësisht

Që e përfshin mendjen, poshtë së cilës nuk mund të

zbresë,

Përtej së cilës nuk ka dëshirë të ngjitet.

Duhet

Të jetë gjetja e një kënaqësie, dhe mund

Të jetë e një burri që patinon, e një gruaje që vallëzon, e

një gruaje

Që kreh flokët. Poema e aktit të mendjes.

2.

Një analizë e kësaj poezie, në tekstet e Shkollave të Mesme të ShBA, do të ishte pak a shumë si më poshtë:

Përshtatshmëria dhe Ndryshimi - Poezia thekson se poezia moderne duhet të jetë e përshtatshme dhe reaguese ndaj një bote që ndryshon vazhdimisht, duke u larguar nga format fikse dhe konvencionet e vendosura.

3.

Një analizë më e thellë:

'Mbi poezinë moderne' fillon dhe përfundon me rreshta që nuk janë fjali të plota: “Poema e mendjes në aktin e gjetjes / Asaj që mjafton.” Dhe “Poema e aktit të mendjes.” Ato janë



Mendja në Veprim: Stevens vë në pah rolin aktiv të mendjes në procesin poetik, duke sugjeruar që poezia moderne duhet të jetë një eksplorim i funksionimit të mendjes dhe përballjes së saj me realitetin.

Të Gjeturit e Asaj që Mjafton: Koncepti qendror i poezisë është se poezia moderne përpaket të gjejë “atë që mjafton”, që do të thotë të ofrojë kuptim, kënaqësi dhe një ndjenjë rendi në një botë kaotike.

Poeti si Aktor: Stevens përdor metaforën e poetit si një aktor në skenë për të ilustruar aspektin performues të poezisë moderne. Poeti mishëron frymën e kohës dhe ndërvepron me audiencën përmes krijimtarisë së tij.

Përtej Subjekteve Tradicionale: Sipas Stevens, poezia moderne nuk duhet të kufizohet vetëm në subjektet tradicionale, por duhet të trajtojë gjithashtu realitetet dhe përvojat e botës modern.

Forma Dynamike: Struktura e vargut të lirë në poezi, pa një skemë të caktuar rimash apo metrikë, pasqyron temën e lëvizshmërisë dhe përshtatshmërisë që përcjell poezia.

Struktura dhe Stili:

- Poezia është shkruar në varg të lirë, pa një skemë të rregullt rimash apo metrikë.

- Ajo është ndarë në dy seksione nga një rresht bosh.

- Vargjet ndryshojnë në gjatësi, duke pasqyruar temën e fleksibilitetit.

- Përdor imazhe të gjalla dhe metafora për të shprehur idetë e saj.

Lidhja me Modernizmin:

“Mbi Poezinë Moderne” është një kontribut i rëndësishëm në poezinë moderniste, që pasqyron theksin e kësaj lëvizjeje mbi eksperimentimin, subjektivitetin dhe eksplorimin e përvojës moderne.

Poetët modernistë shpesh përballeshin me tema si fragmentimi, alienimi dhe kërkimi për kuptim në një botë që ndryshon shpejt. Poezia e Stevens pasqyron këto shqetësime duke theksuar nevojën që poezia të përshtatet me botën moderne dhe të gjejë mënyra të reja për të ndërvepruar me realitetin.

Në thelb, “Mbi Poezinë Moderne” është një thirrje që poezia të përqafojë ndryshimin, të angazhohet me kompleksitetet e botës moderne dhe të gjejë forma të reja për të ofruar kuptim dhe kënaqësi për lexuesit. Ajo është një dëshmi për fuqinë e qëndrueshme të poezisë për t'u përshtatur dhe për të ofruar ngushëllim e thellësi në përballje me një botë në ndryshim të pandërprerë.

një subjekt dhe një ripërmbledhje, por jo një temë. Duke munguar folja kryesore, këto rreshta shmangin pohimin e një teme. Por, më me rëndësi, ato shmangin lidhjen e aktit të mendjes me kohën; akti i mendjes nuk është as në të kaluarën, as në të tashmen, as në të ardhmen. Ai është i vazhdueshëm. Këto jo-fjali theksojnë gjithashtu se mendja duhet të veprojë, jo të presë pasivisht për frymëzim apo intuitë. Dhe mendja duhet të kërkojë të gjejë “atë që do të mjaftojë.” Ajo çka thotë kjo për poezinë moderne do të trajtohet në mënyrë metaforike në poemë, me metaforën organizuese të një skene të re në të cilën poeti modern do të interpretojë.

Rreshtat e poemës, një varg i lirë jotradicional, nuk rimojnë dhe nuk janë metrikë. Ato variojnë nga dhjetë deri në katërmbëdhjetë rrokje. Një gjë e habitshme në tingujt e poemës është se tre nga rreshtat përfundojnë dobët; domethënë, fjalët e fundit të këtyre rreshtave kanë rrokje të pambështetura. Rreshti hapës, i cituar më sipër, ka një përfundim të dobët—“Poema e mendjes në aktin e gjetjes...” Kjo shpërndarje e forcës retorike thellohet më tej nga fakti që poeti nuk i vendos frazat e përsëritura paralele në fillim të rreshtave, një teknikë që quhet “anafora,” ku do të kishin qenë më të fuqishme. Për shembull, menjëherë pas ndarjes së parë, tipografia tradicionale mund t’i kishte renditur fjalët kështu:

Duhet të jetë e gjallë, të mësojë gjuhën e vendit.
Duhet të përballet me burrat e kohës
Dhe të takojë gratë e kohës.
Duhet të mendojë për luftën
Dhe duhet të gjejë atë që mjafton.
Duhet të ndërtojë një skenë të re.
Duhet të jetë në atë skenë...
 (“Ajo” - i referohet “poemës së mendjes.”)

Riorganizimi i fjalëve si më sipër e bën më të qartë dobësinë retorike të rreshtave origjinalë. “Të mendojë për luftën” dhe “të gjejë atë që mjafton,” si dhe fjalët e tepërta në dy rreshtat e fundit—të gjitha dobësojnë çdo energji që idetë mund të kishin pasur në duart e një poeti shumë retorik dhe jo-modernist si Rudyard Kipling. Por idetë në këto rreshta origjinalë duhet të shqiptohen nga folësi për të çuar poemën përpara. Edhe pse mund të duken të zakonshme, ato kryejnë funksionin e tyre; për më tepër, ato prezantojnë metaforën formuese të poemës. Poema moderne duhet jo vetëm të “ndërtojë një skenë të re,” por edhe të gjejë fjalë që “do të mjaftojnë” pa përsëritur thjesht skenare dhe peizazhe të vjetra, forma dhe ide të përdorura më parë. Poema moderne duhet të gjejë atë që mjafton dhe ta “bëjë të re.”

Më pas, fjalët ngrihen nga retorika e pa-theksuar në nivelin e poezisë. Ky fragment zgjat nga “Si një aktor i pangopur, ngadalë dhe...” (rreshti 11) deri te “Përtej së cilës nuk ka vullnet të ngrihet” (rreshti 23). Çfarë bën ky “aktor i pangopur,” kjo poemë moderne? Ajo duhet të gjejë atë që do të kënaqë nevojat shpirtërore njerëzore pasi të zëvendësojë format e mëparshme të shprehjes dhe idetë, të cilat për modernistët janë bërë vetëm “suvенire.” Lexuesi ka mundësinë të zgjedhë se për cilin “të kaluar” po mendon poeti. Mund të jetë për format më të hershme të poezisë, për didaktizmin e saj, për rënien e vlerave komunitare, veçanërisht besimin në fetë judeo-kristiane, apo diçka tjetër. Ndoshta leximi më i kënaqshëm është të pranosh të gjitha këto mundësi. Ky fragment qendror që përshkruan poezinë moderne dhe folësin e saj përfundon me këto rreshta:

Aktori është
Një metafizikant në errësirë, duke prekur
Një instrument, duke prekur një tel të hollë që jep
Tinguj që kalojnë përmes saktësive të menjëhershme,
plotësisht
Duke përfshirë mendjen...
(rreshtat 18–22)

Në epokat e mëparshme të besimit, folësit, qofshin priftërinj apo poetë, shpjegonin metafizikën e tyre sikur vinte nga një frymëzim hyjnor, një zbulesë, një dritë shpirtërore. Poema moderne e Stevens nuk duhet të gjejë një “mesazh” të zbuluar, por poema që plotësojnë një nevojë që më parë ishte përmbushur nga poezitë tradicionale.

Për Stevens-in, poezia moderne e ngrinte poetin dhe lexuesin nga monotonia e jetës së përditshme në një moment të ndritshëm, edhe nëse të përkohshëm, të jetës së thellë. Që lexuesi të marrë pjesë në këtë përvojë estetike, ai ose ajo duhej të angazhohej aktivisht në kuptimin e poezisë. Me një poet të vështirë dhe serioz si Stevens, një mënyrë për ta bërë këtë është të gjeshe poezi në të njëjtin libër që “gjallërojnë ndërsjelltas fjalët” e poezisë në fjalë. Në këtë rast, Seksioni IV i “Variacione mbi një ditë vere,” botuar në Parts of a World (1942), ofron ndihmë për “Of Modern Poetry”:



Fjalët i shtohen shqisave. Fjalët për ndriçimin
E mikës, lëkundjen e barit,
Mbulesën e Arahnes mbi pemët e vdekura,
Janë syri që bëhet më i madh, më intensiv.

Kur folësi thotë, “mika (mineral) ndriçon,” fjalja kërkon pak imagjinatë verbale nga poeti ose lexuesi. Metafora personifikuese, “lëkundja e barit,” kërkon më shumë përfshirje aktive nga lexuesi në interpretimin e fjalëve. Dhe, më në fund, shprehja e papritur “mbulesa e Arahnes mbi pemët e vdekura” sfidon dhe shpërblen lexuesin aktiv. Imazhi është i Arahnes që thur rrjetat e saj përreth pemëve të vdekura. Zgjedhjet e çuditshme të fjalëve dhe imazhet metaforike “i shtohen shqisave” dhe syri i lexuesit, mendja, bëhet “më e madhe, më intensive.” Ofrimi i një rritjeje dhe intensiteti të tillë për mendjen është një mënyrë thelbësore përmes së cilës poema moderne gjen atë që mjafton.

Përveç zgjedhjeve të fuqishme të fjalëve dhe imazheve metaforike, poezia moderne ofron tinguj të papritur në vend të rimave dhe metrikave tradicionale. Poeti modern, ai “aktor i pangopur,” qëndron në skenën e re “duke prekur një tel të hollë që jep / Tinguj që kalojnë përmes saktësive të menjëhershme.” Ai apo ajo mund të luajë një instrument modest, por, në nivelin e prozodisë, çka ka rëndësi janë “saktësitë e menjëhershme” të tingullit të fjalëve. Muzika e re ka “thekse fisnike / Dhe ritme të qarta, të paikshme,” që nuk janë dëgjuar kurrë më parë, siç thotë Stevens në “Trembëdhjetë mënyra për të parë një zog të zi.”

Poema moderne “e përfshin plotësisht mendjen,” jo vetëm e mbush atë si kuptim i hedhur në një enë të zbrazët, por e përfshin. Format e reja të gjetjes së asaj që mjafton krijohen nga metafizika e errët e aktorit; ritmet e qarta dhe të pashmangshme; dhe imazhet që lindin nga gjërat e zakonshme si “një burrë që rrëshqet mbi akull, një grua që vallëzon, [apo] një grua / Që krihet.” Imagjinata që krijon një poemë moderne i jep lexuesve të saj atë që mjafton përmes kënaqësisë së menjëhershme dhe intensive të të parit të risisë së imagjinuar në realitet.

4.

Rreth autorit:

Në vitin 1950, Stevens botoi përmbledhjen e tij të fundit me poezi të reja, *The Auroras of Autumn*. Poemat në këtë vëllim tregojnë një Stevens që vazhdon të përpunojë dhe sistemojë idetë e tij rreth imagjinatës dhe poezisë. Ndër veprat më të shquara të këtij vëllimi është “Një Mbrëmje e Zakonshme në New Haven”, e cila përbën një tjetër grup shënimesh drejt një fikcioni suprem. Këtu, Stevens gjen sublimen në atë që duket i zakonshëm, duke regjistruar meditime mbi një mbrëmje të caktuar. Stili këtu është i kursyer dhe abstrakt, duke rezultuar në një poezi që kënaqet me dykuptimësinë dhe paqartësinë e përkufizimeve: “Nuk është premisa që realiteti / Është i ngurtë. Mund të jetë një hije që përshkon / Një pluhur,

një forcë që përshkon një hije.” Në këtë poezi, Stevens një herë tjetër e shpjegon fiksinin suprem si sintezën përfundimtare të perceptimit dhe imagjinatës, dhe prodhon një poezi për poezinë: “Kjo poezi që zhvillohet pafundësisht / Shfaq teorinë e poezisë, / Si jeta e poezisë.” Poezi të tjera në *The Auroras of Autumn* janë po ashtu vetë-reflektuese, por përfundimisht më pak ambicioze dhe provokuese, të fokusuara më shumë në shfaqjen e të zakonshmes përmes abstraksionit, duke nxitur kështu një ndjenjë misteri dhe, njëkohësisht, rregulli. Siç vuri në dukje poetja Louise Bogan në një recension për *The New Yorker*, vetëm Stevens “mund të përshkruajë thjeshtësitë e botës natyrore me më shumë mjeshtëri të drejtpërdrejtë,” edhe pse ajo shtoi se bota e tij natyrore “është çuditërisht bosh nga qenie njerëzore.”

Stevens pasoi *The Auroras of Autumn* me një vëllim në prozë për poetikën e tij, *The Necessary Angel*. Në esenë “Kalorësi fisnik dhe tingulli i fjalëve” ai trajtoi përgjigjen e imagjinatës ndaj vështirësive, dhe në “Figura e të Riut si Poet Burrëror” ai një herë tjetër mbrojti imagjinatën si mjetin drejt një realiteti që tejkalon veprimin e thjeshtë dhe arsyetimin. Ajo që qëndron konsistente në këtë vëllim është gatishmëria e Stevens për të paraqitur idetë e tij në një mënyrë të saktë dhe të kuptueshme. Kështu, *The Necessary Angel* ndriçon ndjeshëm poezinë e tij.

Nga fillimi i viteve 1950, Stevens u konsiderua si një nga poetët më të mëdhenj bashkëkohorë amerikanë, një artist abstraksionet precize të të cilit ushtruan ndikim të rëndësishëm mbi shkrimtarë të tjerë. Megjithë këtë njohje të gjerë, Stevens ruajti pozicionin e tij në kompaninë Hartford, ndoshta nga frika se do të mbetej i izoluar nëse do të largohej nga posti i tij fitimprurës. Në vitet e fundit të punës së tij atje, Stevens fitoi shumë çmime letrare, përfshirë Çmimin Bollingen për Poezi, Çmimin Kombëtar të Librit më 1951 për *The Auroras of Autumn*, si dhe disa doktoratura nderi. Megjithatë, lavdërimet më të mëdha i mori me botimin më 1955 të *The Collected Poems of Wallace Stevens*, i cili i solli Çmimin Pulitzer për poezi dhe një tjetër Çmim Kombëtar të Librit. Në këtë vëllim, Stevens përmbledhi pothuajse gjithë poezinë e tij të mëparshme të botuar, përveç *Owl's Clover*, dhe shtoi edhe 25 poezi të tjera nën titullin “Shkëmbi” (*The Rock*). Përfshirë në këtë seksion janë disa nga poezitë më të mira dhe më tipikisht abstrakte të Stevens-it. Në mënyrë të përshtatshme, poezia e fundit në “Shkëmbi” titullohet “Jo Idetë për Gjënë, por Vetë Gjëja,” në të cilën realiteti dhe imagjinata përshkruhen si duke u bashkuar në çastin e perceptimit: “Ajo britmë e hollë — ishte / Një Korist, c-ja e të cilit i parapriu korit. / Ishte pjesë e diellit kolosal, / I rrethuar nga rrethat e tij korale, / Ende larg. Ishte si / Një njohuri e re e realitetit.”

Pas botimit të poezisë së mbledhur, Stevens vuajti gjithnjë e më shumë nga kanceri dhe u shtrua disa herë në spital. Ai vdiq në gusht të vitit 1955. Në vitet që pasuan vdekjen e tij, reputacioni i Stevens mbeti i fuqishëm. Errësira dhe abstraksioni i poezisë së tij rezultuan veçanërisht tërheqës për studentët dhe akademikët, duke gjeneruar kështu kritikë të gjerë. Ndër interpretuesit më të respektuar të veprës së Stevens janë Helen Vendler, e cila ka demonstruar ekspertizë të veçantë mbi poezitë më të gjata, dhe Harold Bloom, libri i të cilit *Wallace Stevens: The Poems of Our Climate* është ndoshta më provokuesi dhe më substanciali, megjithëse i dendur dhe fjalëshumë, nga shumë vëllime që i kushtohen gjithë kanonit të Stevens-it. Për Bloom, Stevens është “një pjesë jetike e mitologjisë amerikane.”

1

Zija Çela është një nga emrat më të konsoliduar të prozës shqiptare bashkëkohore, me një stil që shpesh përshkohet nga reflektimi metafizik, absurdi ekzistencial dhe ironia e hollë, të ndërthurura me një përkushtim të rrallë ndaj fjalës artistike. Ai e ka ndërtuar individualitetin krijues mes një poezie të brendshme të prozës dhe një shqetësimi të përhershëm etik, shpirtëror dhe shoqëror. “Thika pa gjak”, botuar nga Onufri, është një nga librat që përmbledh më mirë thelbin e kësaj përvoje krijuese.

Ky libër përmbledh tregime që sillen rreth tensioneve të brendshme të njeriut shqiptar, sidomos në epokën e paskomunizmit, të shoqëruar me dramën e përditshme, brishtësinë shpirtërore, absurdin dhe një realitet shpesh të deformuar. Tregimet janë të ngjeshura, të përshkuara nga një filozofi e heshtur që lind nga detajet më të zakonshme të jetës. “Thika pa gjak” është metafora e dhimbjes që nuk shihet, e vuajtjes që nuk gjakos, por gërryen brenda.

Përgjatë leximit herë pas here ndjehet dhuna e padukshme dhe heshtja e njeriut modern.

Në shumë tregime, dhuna nuk paraqitet në mënyrë fizike, por si mungesë kuptimi, si zbrazëti, si thikë që nuk lë gjak, por plagë të padukshme (psikologjike, shpirtërore).

Zija Çela sjell një galeri personazhesh të përballur me një botë që ka humbur busullën etike, ku raportet mes njerëzve janë thyer e deformuar, ku degradimi moral dhe zbrazëti shpirtërore janë bërë kërcënuese.

Në mjaft tregime ndjehet pakuptimësia që mbizotëron në jetën shqiptare të tranzicionit. Personazhet jetojnë midis absurdit e nostalgjisë për kuptimin e humbur.

Libri me tregime “Thika pa gjak”

ZIJA ÇELA MODERN DHE UNIVERSAL

Nga Mexhid Mehmeti

Në libër spikasin marrëdhëniet njeri – njeri dhe figura e gruas. Gruaja është shpesh figurë e mungesës, e humbjes, e misterit. Edhe raportet intime përshkohen nga një pamundësi për të komunikuar plotësisht.

2

Zija Çela nuk shkruan thjesht për të rrëfyer, por për të zbuluar. Fjala është e zgjedhur me kujdes, e mbu-shura me domethënie dhe emocione të nënkuptuara. Au-tori përdor shpeshmetafora të fuqishme dhe figura reto-rike, që i japin tregimit thellësi dhe ambiguitet.

Tregimet kanë frazë të ngjeshura dhe të kursyer, me një ritëm të brendshëm që pasqyron tensionin emo-cional të personazheve. Dialogjet mes tyre vijnë si mjet zbulesash të brendshme. Dialogjet nuk janë të shpeshta, por aty ku shfaqen, janë të ngarkuar gjithashtu me heshtje, nënkuptime dhe tension të mbledhur.

Narratori është zakonisht një zë që e ndjek nga afër personazhin, por pa e vlerësuar. Ai është vëzhgues i heshtur i një bote në shkatërrim.

Koha është shpesh e përthyer dhe jo

lineare – duke pasqyruar gjendjen e turbullt të vetë personazheve.

Ndërsa hapësira shpesh e zyrtë, simbolike – kafene, banesa të errëta, zyra, mjedise të ndërkallura, rrugë pa krye – pasqyrë e një universi të brishtë.

“Thika pa gjak” është një libër që duhet lexuar jo vetëm për vlerat e tij estetike, por edhe për mënyrën si artikulon një krizë të thellë shpirtërore e shoqërore. Zija Çela arrin të prekë me finesë dhe thellësi plagët e heshtura të shoqërisë, përmes një gjuhe që nuk bërtet, por godet.

Kemi të bëjmë me një vepër që tejkalon kufijtë e tregimit të zakonshëm. “Thika pa gjak” i shkrimtarit të mirënjohur Zija Çela përfaqëson kulmin e artit të prozës së shkurtër në letërsinë shqiptare bashkëkohore. Ai vjen si një përmbledhje rrëfimesh që, edhe pse të shkurtra në formë, janë thellësisht komplekse në përmbajtje, duke ndërtuar një univers të pasur stilistik, tematik, gjuhësor e filozofik. Vepra nuk mund të kuptohet si thjesht një koleksion tregimesh, por si një organizëm i gjallë artistik që eksploron ankthet, brengat, iluzionet dhe shpresat e njeriut modern, ndërmjet absurdit dhe poezisë.

Por edhe midis ekzistencializmit dhe realitetit social. Çdo tregim është një “thikë pa gjak”, që depërton në shtresat më të thella të përvojës njerëzore. Motivet përshkojnë një gamë të gjerë tematike, duke përfshirë:

Vetminë dhe përjashtimin (“Ëndrra me pulëbar-dha”, “Burgu i peshqve”),

Tradhtinë dhe hakmarrjen (“Thika pa gjak”),

Marrëdhëniet familjare të tensionuara (“Shuplaka e motrës”, “Unaza me ngjyra”),

Dashurinë e vonuar apo të pamundur (“Basti final”, “Trofeu”), Shkallëzimet morale në tranzicionin e njeriut shqiptar (“Banka e Ankesave”, “Përgjigjet e munguara”, “Tregtarë të tymit”), etj.

Ky univers është i ngarkuar me simbolika të thella e universale, që e kapërcejnë përditshmërinë shqiptare dhe e bëjnë veprën një akt komunikimi me njeriun kudo në botë.

3

Jemi përballë një mjeshtërie narrative të pakra-hasueshme. Stili i Zija Çelës është lakonik, por emo-cionalisht i ngarkuar.

Rrëfim poetik i ndërthurur me absurditet e humor të zi. Gjuhë e pasur figurative, me metafora që të kujtojnë poetikën e Borgesit, por edhe të Ivo Andrićit.

Zija Çela arrin të ruajë një ekuilibër mes rrëfimit racional dhe emocional, duke u dhënë zë edhe heshtjeve, duke i bërë ato të flasin në mënyrë tronditëse. Dhe si? Përmes një gjuhe të zgjedhur, ku ka elegancë dhe ngjyrimet poetike.

Gjuha e autorit është një nga shtyllat më të fuqishme të librit. Ajo bart elemente të pasura leksikore, dialektore, aforistike dhe poetike, që shpesh marrin trajtë të një gjuhe “biblike” të jetës së zakonshme. Ritmi gjuhësor, ndërtimi sintaksor dhe muzikaliteti i frazës janë të rafinuara dhe poetike.



Zija Çela, siç thonë kritikë të shumtë, është një prej themeltarëve të letërsisë moderne shqipe. Ai kra-hasohet me Kafkën për absurditetin njerëzor, me Dos-tojevskin për hulumtimin e thellë shpirtëror, me Kadarenë për fuqinë simbolike dhe gjuhësore, me Raymond Carver për ndërtimin e mikroromanit në formën e tregimit të shkurtër, me Albert Camus sidomos për mënyrën si Zija Çela përshkruan indiferencën dhe absurditetin ekzistencial të realitetit shqiptar.

4



“Thika pa gjak” është më shumë se një libër tregimesh. Është një testament letrar për kohën tonë, një manifest shpirtëror dhe letrar që flet me zërin e njeriut të thjeshtë dhe të përgjeshëm njëkohësisht. Zija Çela, përmes këtij libri, dëshmon jo vetëm fuqinë e rrëfimit, por edhe domosdoshmërinë e letërsisë si mjet për të kuptuar botën.

Letërsia e Zija Çelës në “Thika pa gjak” ka një cilësi të rrallë: ajo është njëkohësisht shumë personale dhe universale, e heshtur dhe tronditëse, moderne dhe biblike. Secili tregim është një gjetje e re strukturore dhe përjetuese, ku lexuesi jo vetëm që ndjek rrëfimin, por edhe ndalet, reflektron, dhe shpesh përthyp me ngadalë heshtjen midis fjalëve.

Fushë Kosovë, 2025



Një letër e panjohur e poetit Gaspër Pali drejtuar kolegut të universitetit dhe të letrave, Filip Ndocaj, si dhe dy foto të panjohura të asaj kohe.



Letra e poetit Gaspër Pali mban datën 27 prill 1940 dhe është nisur nga Firenze për në Shkodër, ku jetonte shoku i tij i kursit, prozatori Filip Ndocaj. Siç mund ta lexoni në të Gaspër Pali shfrytëzon rastin “t’i pikojë” mikut të vet dy përshtypje nga leximi i novelës “Jetë të vetmuemish”, botuar në gazetën “Tomori”, më 7 prill 1940.

Paraqitur nga Stefan Çapaliku

I dashtuni Filip.
Novela jote m'erdh pa pritun; prandej kam dashtë me e kndue me një herë, ma teper se një herë e me shijue jeten e dikurshme. E mbahet si me të pas tye ngjet. Kujtoj ditën qi shetitshim bashkë në pjazën e DUOMIT. Ftytyrat t'ona ishin të zbata porsì qiella mbi krye t'onë; a e din se novela jote me njalli njatë gjendje shpirtnore? Bekue kjoqshin kohet kur na u sjedhshim; e kur androjshim per jolen e Klejden; e kur u endshim udhësh të pazhurmë, nsa hana nga snalti na shiqote!
Të bjen ndër mend? Kur ndonji dritore u ndritte n'errsinë e kur ndonji endacak na soditte me çudi ne shetitsat e natës.
E tanë kjo botë m'u ngjall e thirrur nga penda magji-plote e jotja. E Klejde m'u paraftyrue vasha që në zemër m'kishte ndez një flakada dashnijet. Ti më fryene në hinin e shpirtit tim, më preke një varrë.
Der ktu foli shoku, tash due të flasë kritikë. Motivi i novelës m'a pëlqye tejte. Ashti andjes, që s'mund të arrihet, që përban karakteristike. E prandej ai ves

pesimizmi e trishtimi.
Por due të pves një gja: n'at ambjent tepër të ngushtë, a thue s'ishte me kenë mirë..... për një ditë tjetër?
Mandej për stil. Unë bindem që ti Filip, që je një ndjekës i rrymës moderne përdorë aq shumë pika. Leni shejat konvencionale e që i shërbejshin dikur romanticizmit dekadent, për me shprehë, ata shka s'ndiheshin...
Mandej, novelës nuk i ke dhanë një unitet si duhet. Un e di nga të ka rrjedhë.
Ti novelën e ke shkurtue shumë në “Tomorri”, e kjo gja e ka zbe. Kuptoj arsytet, por un kostatoj faktin. Mandej, për me u kuptue nga marë bota shqiptare duhet të disa forma dialektore kosovare.
Provo dialektin e Elbasanit e novela jote ka me pasë lexues të shumë.vKaq kritika jeme...
Për mue si Gaspër, qi i kam kalue disa skena, e kam kuptue novelën e për këtë arsye të jam edhe ma tepër mirnjohës.
Ti rreshtova kto oroe se e die se je tue përgatitë mbledhjen për botim. E mue më don zemra që të dalë për bukuri.
Filip, pse kësaj here nuk të shkruiej ma gjatë: jam shumë melankolik, gati i dëshpruem. S'die se pse.

Të përqafoj,
Gaspri

p.s.
.....Gati kjeq tue harrue emnin t'and.
T'uroj ditën emnit. E gzozh e përshumë mot. Mot, ishalla, ishalla me një nuse të vogël (në kje se në shtrat jo) i fejuem.
Al professore di latino
Ad multos anos
Gaspri



Fotot janë të datës 22 shkurt 1939 në Firenze. (Foto 1) Duke nisur nga e majta: 1. Gasper Pali, 3. Ndrek Dema, 5. Filip Ndocaj. (Foto 2) Gaspri i gjashti nga e majta. (Arkivi personal Stefan Çapaliku)

Ora është gjashtë e një minutë. Është ende errësirë por unë jam ngritur që menatë pasi në orën gjashtë duhet të hap portën e madhe të varrezave. Jam rojtarja. E di, është pak e çuditshme, zakonisht rojet e varrezave janë burra. Por kjo që ruaj unë nuk është varrezë e thjeshtë, kjo është paksa ndryshe dhe ka nevojë për duart e një gruaje. Tani kuptohet, kur lind nevoja për punë të rënda, bashkia sjell disa burra dhe i kryejnë ata fët e fët. Por pjesën tjetër e bëj unë.

Unë jam rojtartja e varrezës së të panjohurve. Varreza ku unë punoj është e mbushur me varre njerëzish të panjohur, pa familje, pa miq.

Ndaj dhe këto varre kanë nevojë për duart e një gruaje që t'i pastrojë, t'u mbjellë lule, t'i heqë barërat e këqija, të lutet për ta, e jo rrallë herë të derdhë lotë. Kjo grua jam unë.

Jam këtu që prej 32 vitesh. Historia e kësaj varreze nisi krejt thjesht. Në një kanal vaditës u gjet trupi i pajetë i një burri. Fshatari që e gjeti lajmëroi policinë e kështu kufoma e të mjerit u dërgua në morg. Policia nxori njoftime kudo me lajmërimin e vdekjes së një burri, vjeç 77, i veshur kështu e ashtu, me flokë të thinjura, me një shenjë të prere në faqen e majtë e detaje të tjera, në mënyrë që dikush nga familjarët apo ndonjë që e njhte të bëhej i gjallë e njeriu i gjerë të përcillej si duhej në dynjanë tjetër. Mirëpo askush nuk u paraqit në polici, as në spital e morg. Trupi i burrit mbeti për ditë me radhë atje.

Të gjendur mes kësaj të papriture (qyteti ynë nuk kish patur më parë raste të tilla) punonjësit e morgut, policisë, spitalit e bashkisë u bënë bashkë e i dhanë zgjidhje. E varrosën plakun në një tokë të braktisur. Mbi krye i vunë një gur. Asaj toke që banorët e dinin të braktisur më vonë i doli pronari, po këtë histori do ta gjeni në shënimet e mia. Atje kam shkruar për varrezën e të panjohurve dhe gjithçka që ka patur lidhje me të. Kam mbajtur dhe një regjistër të detajuar për varret e njerëzve, mënyrën se si kanë vdekur.

Kështu lindi varreza e të panjohurve. Pas burrit që ngriti siparin, toka aty vijoi të mbushej shpejt me varre. Arsyeya ishte e thjeshtë: vendi po kalonte kohë krize. Njerëzit lëviznin nga vendlindja për të kërkuar punë gjatë e domosdo që kalonin në qytetin tonë. Duket qyteti nuk i mirëpriste dhe kufomat ndiqnin njëra - tjetrën. Kështu ndodhi që një natë dhjetori, kur i ftohti kish arritur kulmin, në qoshen e rrugës “Kandil” një grup prej katër vetash, tri burra e një grua, të gjenin vdekjen nga acari. Pastruesit e natës që gjetën kufomat ngritën qytetin peshë me ulërima. Procedura u përsërit, trupat në morg, lajmërimet kudo, asnjë përgjigje, katër varre të reja me katër të panjohur u shtuan qytetit. Për një periudhë kohe nuk pati më vdekje të panjohurish. Ndërsa varreza e madhe e qytetit po mbushej me shpejtësi. Dukej sikur vdekja kish vendosur të tallej paksa.

Por si u bëra unë pjesë e asaj varreze? Kur u varros trupi i plakut, nuk di të jem përse por tri ditë më vonë unë u zgjova herët, mbusha një bidon me ujë, këputa lule në kopshtin tim dhe u nisa drejt varrit të atij burri të panjohur. Ia laga varrin, i vura lule përsipër, thashë një lutje për të e teksa po ngrihesha të ikja, Naseri, pronari i agjensisë së funeralit, më pa. U përshëndetëm si ngaherë dhe unë vijova rrugën. Por ditën kur varrezës u shtuan katër varre të reja, Naseri erdhi e më takoi. Fillimisht bisedoi me mua e pasi unë dhashë një çekrek pohimi, ai shkoi të diskutonte në bashki. Ishte idea e tij që unë të punësohesha tek varreza e re, ishte një gjest fisnik për të nderuar ata njerëz që preheshin atje.

Më thirrën në bashki, më pyetën a dëshiroja të punoja në mirëmbajtjen e varrezës së të panjohurve. Nuk e di se ç'forcë më nxiti të thoja bindshëm se doja. Dhe ashtu u bë. Fillimisht unë shkoja siç do të shkonte një i afërm. U hidhja ujë, shihja për barëra, mbillja lule. E për këtë më paguanin një rrogë minimale. Por gjithsesi unë e bëja me qejf atë punë. Por kur varreza filloi të rritej, bashkia e pa të nevojshme ta rrethonte e ti vinte një portë. Dhe që një periudhë kur varret u shtuan shpejt e në masë. Një grup sirianësh, dy transgjnorë, një adoleshente që vrau veten, një grua që u gjet e therur në koshin e plehrave,



një fëmijë i mbytur që nuk u mor vesh kurrë se si kishte ardhur deri në qytetin tonë. E shumë nga këto histori pa emër, pa zë, pa kurrëgjë. Askush nuk mundi ti identifikonte viktimat. Njerëz të huaj, askush nuk i njhte, askush s'ia dinte historinë, dhembjet, ëndrrat, brengat, mallin, askush. Ata ishin thjesht dhe vetëm të panjohur. Varroseshin në heshtje, pa zhurmë e bujë, në tokën e braktisur që ishte vetëm për ta. Varroseshin dhe harroheshin nga të gjithë, vetëm nga unë jo. Unë i shihja çdo ditë. Jetoja me ta, flisja, këndoja, qaja e lutesha pranë tyre.

Naseri kur pa se varreza po mbushej me shpejtësi bëri një tjetër lëvizje por kësaj radhe pa më pyetur mua. E rregulloi punën në mënyrë të tillë që unë të kisha një vend ku të qëndroja. Ai më shihte çdo mëngjes me bidona me ujë, lule e dorashka tek merrja rrugën tek varreza. Në krye të javës bashkia ndërtoi një shtëpizë të vogël për mua, të cilën unë e kandisa sipas qejfit tim. Ishte e premtë kur punonjësi i bashkisë më dorëzoi çelësat. Orarin ma caktuan 6 e mëngjesit me 6 të pasdites. Por nëse dëshiroja mund edhe të flija natën atje, për ta nuk përbënte asnjë problem.

E shtuna më gjeti para portës së varrezës. Një dryn i madh priste ta hapja. Hapa vetëm një anë të portës dhe u drejtova nga shtëpiza. E hapja dhe atë. Ishte një shtëpizë druri, e vogël, e këndshme, me një dritare të ngushtë nga e cila dallohej një copëz qielli i përzier me re. Vura përtokë çantën që kisha me vete. Pastaj nisa të nxirra prej andej një qilim me rombe, një kanaçe për të hedhur ujin, një ikonë me Virgjëreshën Mari dhe Krishtin fëmijë. I lashë përdhe dhe dola. U nisa drejt shtëpisë prej nga mora një stol, dy jastekë, një batanije, dy tasa, lugë. Kisha një tryezë të vogël, por do ta çoja në rrugë të tretë. U ndala tek dyqani i Eftit ku bleva disa gozhdë.

Në rrugën e tretë solla tavolinën, dy gota, sapun, çekiç, lopatë, një thikë xhepi, dy panorama. Pasdreka më gjeti duke ngulur gozhdë në dërrasat e shtëpizës. Tri gozhdë për kornizat dhe katër për varëse rrobash. Kur dielli perëndoi unë e kisha përfunduar sistemimin e dhomës. Një pamje e këndshme kënaqte sytë e mi. Dola, e kyça derën, po ashtu dhe portën. Pastaj nisa të zbrisja drejt udhës së shtëpisë.

Kështu filloi rrugëtimi im me të panjohurit e varrezës. Ditë pas dite, javë pas jave e muaj pas muaji, u mësova me heshtjen, me qetësinë e përrjetshme, me këngët e zogjve, me hijet, rënkimet pa zë e erën e vdekjes. U mësova me aromën e dheut të sapo hapur, e dheut të thatë e të ndenjur, e dheut të lagur nga shirat e vjeshtës. U mësova me ëndrrat e frikshme, me ujin e njelmët, me lotët që ktheheshin në kristale, me rrënjët e dala të pemëve shekullore që mbrëmjeve u ngjanin gjarpërinjve, me gjetethet e rëna, me erën që tundte eshtrat, gurët

e varreve pa emër, pa histori, pa jetë.

Netëve kur kthehesha në shtëpinë time e ndjeja veten të huaj. Asgjë s'më ngrohte, as shtrati, as muret, pikturat, pianoja, oborri. Asgjë s'më përkiste. Vetëm lulet ma kënaqnin shpirtin, vetëm ato ishin pjesë e imja pasi ato ua çoja mëngjeseve miqve. E kështu e këputa fillin që më lidhte me botën e të gjallëve. Tashmë unë i përkisja botës tjetër. Dukej se dhe bota më kish harruar, mënjauar. Që kur fillova punën si rojtare e varrezës së të panjohurve, qyteti më veçoi. Fjalë e përshëndetje të pakta, të rralla, kalimthi. Dilja vetëm për nevoja e pastaj ose në shtëpi ose në varreza. Kjo ishte rutina ime. Mesa duket do kisha marrë hije dheu pasi shihja se çdokush më shmangte. Po mua aq më bënte e aq më bën ende.

Prej disa kohësh tashmë, e kam bërë zakon që pasi ha drekën, ulem në stolin e vogël, mbështës një fletore mbi tavolinë dhe shkruaj. Kam nisur të rrëfej që nga momenti kur u hap varri i parë e deri më tani. Faqe të tëra mbushur me histori njerëzish. Kam rrëfyer për mënyrat se si kanë takuar vdekjen këta mëkatarë. Se si i gjetën njerëzit e këtij qyteti, si u sollën, si i harruan. Kam shkruar për rutinën time në varrezën e të panjohurve, për disa ngjarje jo “normale” që kam ndeshur gjatë punës sime të përditshme. E në fund po shkruaj për amanetin tim. Nuk e di se kur do të vijë ora ime, por për siguri po e lë gati letrën me dëshirën time të fundit. Nuk po e citoj të gjithën pasi është e gjatë, por thelbi është ky:

Duke qenë se unë jam lindur e rritur në këtë qytet, kur vdekja të vijë për mua, nuk ka pikë dyshimi që do të varrosem në varrezën e qytetit. Kam familjarë, miq e dashamirë por edhe sikur të gjithë këta ti kthenin shpinën kufomës sime, do mjaftonte besnikëria e Naserit që unë të gjeja vend në varrezën e qytetit. Naseri më ka dashur që në rini por jetët tona rrodhën në drejtime të kundërta. E megjithatë ai e ruan respektin dhe dashurinë për mua me fanatizëm. Pra, do mjaftonte Naseri për të më varrosur siç duhej.

Por është pikërisht kjo gjë që unë nuk dua. E pra, nuk dëshiroj të varrosem në varrezën e qytetit. Dëshira ime është të prehem në varrezën e të panjohurve. Mbi krye një gur pa emër. Kjo është ajo që dua. Të mbetem anonim për këdo që rastis të kalojë para varrit tim, të harrohem nga ata që më deshen, që më njohën. Naseri do ta vuajë këtë vendim por besoj se në fund do të më kuptojë.

Kjo është letra ime e fundit, që padyshim do të përfundojë në duart e Naserit. Deri atëherë unë do vazhdoj të kujdesem për të panjohurit e mi, deri ditën kur dhe unë do të jem një e panjohur, e ndoshta dikush do të kujdeset për dheun, gurin, lulet e barërat e varrit tim...

Lindur në Provincë: Kujtesa si hapësirë dhe transformim gjeoemocional

“Shoqëritë që nuk kujtojnë e kanë të vështirë të ruajnë koherencën e tyre; por edhe shoqëritë që nuk dinë të harrojnë, mbeten peng i traumës.”
How Societies Remember
Paul Connerton britanik, studiues i kujtesës dhe ritualeve

“Prandaj nuk i besoj kujtesës në formë thesi. I besoj kujtesës si shoshë. Asaj kujtese që teksa sit rërë, mban mbi rrjetë vetëm diçkanë që vezullon. Kujtesa mban mend atë që u zhduk dhe nuk e pamë kurrë më.”
Arian Leka
Lindur në Provincë

Çdo vend ka një gjeografi të dukshme dhe një tjetër të padukshme, ajo që formohet nga ndjesitë, humbjet, kujtimet dhe ëndrrat e njerëzve që e kanë banuar. Këto gjëra të lindin në mendje kur lexon librin «Lindur në Provincë» i autorit durrsak Arian Leka. Ky libër me ese zhbiruese mendore dhe kulturore, sa letrare aq edhe sociale është shumë më tepër se një tekst letrar. Ai vjen si një udhëtim poetik mbi një hartë intime të shpirtit në udhëkryq, një udhëzues për të kuptuar sesi provinca nuk është vetëm një skaj gjeografik, por një gjendje ekzistenciale. Siç ka shkruar Italo Calvino: “Çfarë është qyteti nëse jo njerëzit që e banojnë në të dhe kujtimet që ata i japin?”

Në librin Lindur në Provincë, Arian Leka ndërton jo vetëm një rrëfim për një qytet buzë detit, por një arkitekturë ndjesore, ku hapësira dhe koha nuk maten me kilometra apo vite, por me ndjenja dhe kujtime. Provinca, siç e përshkruan autori, nuk është një vend i vogël në hartë, por një vend i thellë në kujtesë, një vend që nuk largohet as kur ti largohesh prej tij.

Një nga figurat më të fuqishme që përdor Leka në këtë libër është deti. Ai nuk është vetëm një sfond natyror, por një personazh që flet, përthith dhe humbet. Në vitet e para të demokracisë, deti për shqiptarët u kthye në një kufi të ikjes, në një rrugë drejt lirisë, por edhe në një varrezë pa varre për shumë prej atyre që u zhdukën në valët e tij. Arian Leka e përjeton këtë jo si gazetar, as si historian, por si poet ai dëgjon gjuhën e detit si një hapësirë gjeometrike emocionale, një strukturë ndjesish që ndërtohet dhe shembet me çdo dallgë.

Kjo mënyrë e të shkruarit, ku hapësira dhe ndjesitë lidhen ngushtë, nga pikëpamja gjeoemocionale, tregon se ndjesitë njerëzore mund të kenë formë, drejtim, thellësi. Teksti i Lekës ndërtohet si një qytet i brendshëm, ku rrugët janë kujtime dhe sheshet janë plagë që nuk mbyllen. Siç thotë Gaston Bachelard, “hapësira e përjetuar është më shumë e ëndërruar se sa e matur.” Provinca e Lekës është e tillë, një vend i ëndërruar, që ka për njësi mase vetëm shpirtin.

Por më thellë akoma, libri është edhe një dëshmi e një transformimi të vazhdueshëm. Ai tregon sesi një qytet ndryshon jo vetëm në pamje, por në mënyrën si përjetohet. Nga një port i lashtë me frymë mesdhetare, ai kthehet në një qytet të braktisur nga vetja, në një provincë që është larguar nga vetë historia e saj. Ky transformizëm linear është i dhimbshëm dhe i papritur, ku sociologu dhe teoricieni modern polak Zygmunt Bauman e përshkruan: “Tranzicioni është bërë gjendja jonë e përhershme. Jemi gjithmonë në kalim, nga një gjendje në një tjetër, pa arritur kurrë në ‘atdheun’ tonë identitar. Emigrimi modern nuk ka më rrugë kthimi. Ai është një udhëtim drejt një bote që nuk premtom më as strehë, as përkatësi dhe identitetet moderne janë të lëngëta, kalimtare, shpesh pa formë.” Provinca e Lekës është po aq fluide sa edhe deti që e rrethon.

Libri “Lindur në Provincë” më shumë se

Kur lexon librin “Lindur në Provincë” të autorit durrsak Arian Leka

NGA PROVINCA E JASHTME NË PROVINCËN E BRENDSHME

Nga Pol Milo



një libër eseistik është një dëshmi poetike për vende që ndeshen me problemet kryesore mes kujtesës dhe harresës. Vendet e tilla, si provinca e Lekës, nuk dinë ç’të bëjnë me kujtesën, sepse ajo ngarkon me dhimbje dhe të kaluar që pengojnë të tashmen, por njëkohësisht nuk dinë çfarë të bëjnë edhe me harresën, e cila duket si një boshllëk i rrezikshëm, një rrezik për humbjen e identitetit. Ky dyzim krijon hapësira të reja të ndjeshmërisë dhe të përjetimit, hapësira që burojnë nga problematikat e gjeoeokzistencës tranzicionale, kësaj gjendje të ndërmjetme, ku jeta dhe vetëkuptimi i individit dhe i komunitetit janë në balancë

delikate midis së kaluarës dhe të panjohurës, midis qëndrimit dhe largimit, midis kujtesës dhe harresës.

Kujtesa, për Lekën, nuk është një magazinë ku mblidhen faktet. Ai shkruan: “Prandaj nuk i besoj kujtesës në formë thesi. I besoj kujtesës si shoshë. Asaj kujtese që teksa sit rërë, mban mbi rrjetë vetëm diçkanë që vezullon. Kujtesa mban mend atë që u zhdruk dhe nuk e pamë kurrë më.” Është një qasje poetike ndaj kujtesës, që zgjedh jo çfarë ndodhi, por çfarë ka lënë gjurmë ndjesore, çfarë na mungon, çfarë vezullon në humbje.

Ndonjëherë ndodh që arkitekturat e shpirtit njerëzor të ndërtruara mbi rrënoja diktaturash, mbi dhimbjen e emigrimit, mbi zhgënjimin e një lirie që shpesh nuk mbërrin, janë shembuj të një fenomenologjie të përbotshme që ripërsëritet.

Por në mes të kësaj arkitekture që tundet si një shtëpi mbi ujë, qëndron fjala; fjala poetike, që si një busullë orientuese të mëson të ecësh në provincën tënde të brendshme pa u mbytur në detin e harresës.

“Ne nuk jemi nga vendi ku lindëm, por nga vendi që na kujtohet kur mbyllim sytë.”
-Octavio Paz

Dyrrah 2025

ARTI NË EPOKËN DIGJITALE

Ese nga Fatlum Mehulli



Në epokën digjitale, arti nuk është i shfaqur vetëm nëpër hapësirat e galerive dhe i ekspozuar vetëm për audiencën/receptivitetin elitare në mënyrë fizike. Falë teknologjisë, në ditët e sotme, arti është bërë pjesë e përditshmërisë njerëzore në një mënyrë që para një kohe nuk ishte imagjinuar. Individi që posedon një telefon të mençur mund të krijojë, shpërndajë dhe shikojë forma të ndryshme të artit brenda një kohe shumë të shkurtër. Ky zhvillim përveç se ka sjellë një transformim të mjeteve të krijimit dhe shpërndarjes, ai gjithashtu ka ndryshuar vetë kuptimin e artit, raportin e tij me audiencën dhe rolin që e luan në kulturën dhe shoqërinë moderne.

Transformimi digjital i artit ka ndikuar ndjeshëm në mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë me të. Në kohët e kaluara, për të pasur kontakt me një vepër artistike duhej gjithsesi prania fizike në një hapësirë të caktuar si në teatër, galeri, kinema apo koncert. Ndërsa tani përmes platformave sociale si Facebook, Instagram, Youtube etj., arti është bërë i vrojtueshëm e dëgjueshëm nga çdokush kudo. Ky ndryshim apo “demokratizim” i artit në njëfarë mënyre e ka zbutur dallimin mes artistëve profesionistë dhe amatere, sepse këta të fundit, sidomos artistët e rinj, kanë mundësi që ta shpërndajnë punën e tyre në mënyrë të njëjtë. Mjafton një video e shkurtër, ilustrim i shpejtë, këngë që përhapet në rrjet dhe mund të fitohet vëmendja e mijëra apo në raste specifike miliona njerëzve.

Po ashtu, në këtë epokë digjitale është krijuar një mjedis/frymë ku arti përveç si akt estetik, është edhe formë e mirë e komunikimit të drejtpërdrejt shoqëror. Aktivizimi artistik është rritur ndjeshëm, pasi nëpërmjet rrjeteve sociale, që konsiderohen si mjete mjaft të fuqishme, shprehet pakënaqësia për të sfiduar normat dhe për të ngritur çështje të rëndësishme siç janë barazia racore, drejtësia sociale, krizat klimatike e kështu me radhë. Një vizatim i thjeshtë, por me kuptim, një video artistike, performancë, mund të përhapen në mënyrë virale dhe kështu të ndikojnë në mënyrën se si një komunitet mendon ose ndjehet për një çështje të caktuar. Në suaza të kësaj, arti në disa raste ka funksion të veçantë, me ç’rast bëhet mjet i fuqishëm për ndërgjegjësim dhe mobilizim.

Në aspektin teknik, ndikimi i teknologjisë në art ka ndryshuar edhe vetë procesin krijues. Inteligjenca artificiale, programet e ndryshme të dizajnit si Photoshop, Illustrator, printimet 3D etj., kanë zgjeruar kufijtë e artit në përgjithësi. Një dizajner grafik (artist digjital) mund të krijojë me qindra-mijëra punime pa pasur nevojë për hapësirë fizike apo materiale tradicionale. Kjo ka bërë që koncepti i artit të mos lidhet vetëm me objektin fizik, por të shtrihet edhe në përvojën digjitale, ndonjëherë edhe jo-materiale. Le ta ndërmendim këtu shembull formën e NFT-ve (non-fungible tokens), ku tregohet se si vlera artistike dhe tregtare mund të jenë krjetësisht virtuale.

Megjithkëtë, transformimi digjital i artit ka sjellë edhe sfida të thella shoqërore e kulturore, sepse mbivlerësimi i punimeve të publikuara natyrisht e dëmton vlerën e artit të mirëfilltë. Këtu do të ndërmendja sociologun e njohur bashkëkohor Zygmunt Bauman, i cili thekson se “sot është shpejtësia marramendëse e qarkullimit, riciklimit, vjetërsimit, flakjes dhe zëvendësimit që sjell përfitim - jo durueshmëria dhe besueshmëria e një prodhimi”.¹ Punime të cilat janë bërë me mjeshtri të madhe, kanë koncept, prapavi filozofike-reflektive e kështu me radhë mund të injorohen me një klikim të vetëm, ndërsa përmbajtjet me theks të shtuar emocional apo ngjashëm marrim me miliona shikime, ndonëse përmbajtja e tyre lë shumë për të dëshiruar. Natyrisht që nga një kënd, ky ritëm rapid i konsumimit të artit që ngjan me

konsumin e lajmeve të përditshme, rrezikon ta dëmtojë esencën e artit si një akt reflektiv, shpirtëror, kritik, revolucionar etj.

Gjithashtu, mënyra se si funksionojnë algoritmet e rrjeteve sociale ndikon ndjeshëm në performancën e një artisti. Ai duhet që të krijojë art me qëllim që t’i përshtatet mentalitetit dhe dëshirës së audiencës së caktuar, duke e shuar kështu intencën artistike për t’u shprehur dhe për t’u revoltuar ndaj çështjeve të ndryshme sociale, politike, kulturore. Kjo e metë e digjitalizimit artistik cenon lirinë e artistit dhe origjinalitetin e tij - madje mosprezenca nëpër rrjete sociale ndikon që puna e tij mos të gëzojë njohje të merituar, pavarësisht cilësisë së lartë të punës. Ky realitet i ri bën që suksesi artistik ndikohet ndjeshëm nga dukshmëria sesa nga talenti i pastër, formimi intelektual.

Nga këndvështrimi i sociologjisë së kulturës, këto zhvillime tregojnë se si arti digjital ndikon drejtpërdrejt në formimin e identitetit, të përkatësisë kulturore dhe dinamikave shoqërore. Arti digjital është bërë si një pasqyrë ku individët e gjejnë ose e ndërtojnë veten e tyre. Ai ndikon në mënyrën se si të rinjtë përfaqësojnë veten, si ndjehen dhe gjithashtu si i sfidojnë kufijtë tradicionalë të kulturës, gjinive, përkatësive etnike apo ideologjike. Një punim digjital, një video në Youtube (këngë etj.) apo meme mund të simbolizojë identitetin kolektiv, ose të shërbejë si mjet për të sfiduar autoritetin e për të prodhuar rezistencë kulturore.

Në anën tjetër, ky transformim/zhvillim i hovshëm i teknologjisë që prek të gjitha fushat, por edhe artin, sjell edhe një efekt të dukshëm të globalizimit kulturor. Përderisa arti përhapet globalisht dhe është i qasshëm nga të gjithë, ai rrezikon të humbasë kontekstin lokal dhe prapavinë tradicionale të një vendi të caktuar. Ta zëmë disa forma tradicionale të artit si kënga popullore, pikturat e trashëguara me motive shqiptare, apo skulpturat e kësaj natyre, mund të mbesin në hije përballë kësaj gjendjeje, përballë trendeve moderne, të cilat mund të tërheqin vizualisht, por jo gjithëherë janë të pasura për nga ana përmbajtësore/kulturore. Kjo krijon sfidë të vazhdueshme në mes të ruajtjes së identitetit kulturor dhe integritetit në globalizimin digjital.

Për fund, mund të theksojmë që arti në epokën digjitale nuk është veç një shprehje e teknologjisë moderne, por edhe një faktor mjaft i rëndësishëm që transformon mënyrën se si njerëzit jetojnë, komunikojnë dhe formohen si individ. Ai reflekton kontradiktat/sfidat dhe mundësitë e kohës bashkëkohore, ngërthen në vete përballjet mes individuale e kolektive, tradicionale e moderne, lokale e globale. Përmes këtij arti, shoqëria moderne tregon se nuk është më pasive ndaj kulturës, por njëkohësisht konsumon dhe prodhon, reflekton dhe sfidon. Arti digjital si asnjëherë më parë është bërë pjesë e pandashme e jetës shoqërore dhe kulturore të çdo individ, duke e bërë atë një mjet të fuqishëm për të kuptuar, formësuar e kritikuar botën në të cilën jetojmë.

Literatura

BAUMAN, Zygmunt, *Moderniteti i lëngët*, Pika pa sipërfaqe, 2017

¹ Zygmunt Bauman, *Moderniteti i lëngët*, Pika pa sipërfaqe, 2017, f. 25.

1- KEMI FARE PAK KOHË ...

E dashur,
kemi fare pak kohë
për t'i bërë gjithë gjërat që duam!

Humbëm në kthesa, udhëkryqe,
stacione pa destinacion,
kohë të çmuar,
apo kaq djallëzisht na ngatërruan?

Na rrëzuan prej shkëmbit: S'ka gjë, kjo
është dhimbja jonë!

Vazhdojmë të jemi libër që shkruhet
ngadalë,
me këmbënguljen e fortë:
të ndryshojmë e lëmë gjithçka pas.

Ndonëse përjashta në telin e rrobave
janë nderur paratë e pista për t'u tharë.

Dëshira më shpie tek një lumë
sepse ti ke ende erë mali,
kërcinj të lagur prej vesës,
gjire si manushaqet e dëborës.

Ke aromë jasemini, shushurimë,
çaste të rrëmbyera,
je sërish vrull.

Kemi fare pak kohë
për t'i bërë gjithë gjërat që duam!

Asaj që nuk do të kthehet më,
ia dhuroj këto vargje.
Nuk më mungon qielli,
nuk më mungon zëri,
nuk më mungon deti,
nuk më mungon fjala,
nuk dëshiroj dëshirën e dëshirës.

Dua diçka tjetër, dua të jem kujtesa tënde.


E dashur,
kemi fare pak kohë
për t'i bërë gjithë gjërat që duam!

2- KJO PLOJË QË DIGJET GJITHË NATËN ...

Gjysma e ditës Don Kishot, gjysma tjetër
Sanço Panço,
Kjo plojë e brendshme që digjet ngadalë,
vetëm natën.
Në mëngjes na duhet doemos, diçka e re,
e freskët,
Të mos çmendemi. Nga e vërteta të mos
vdesi. Shpikim Artin.

Na e kanë vjedhur prej kohësh pyetjen -
shpagimin,
Bluhemi si mokra, errësirës, plojë e fatit
të fshehtë.
Ç'bën njeriu i shkretë? Heq dorë nga
pasioni ëndërr,
Për t'u shndërruar në përllogaritës të
tjetërt?

Rugëve të pista, në lozhat e teatrove,
pakujdesitë spontane,
E kanë mundur vesin e të qeshurës së
pafajshme.
Mosnjohja e kufijve, qëllimshëm
ngatërron shanset e senset,
pak nga pak ndjejmë, po na grabisin, zërin
dhe kujtesën...



Gjysma e ditës Don Kishot, gjysma tjetër
Sanço Panço,
Ky lloj plehu i brendshëm që digjet
ngadalë, vetëm natën.
Në mëngjes na duhet doemos, diçka e re,
e freskët,
Të mos çmendemi. Nga e vërteta të mos
vdesim. Shpikim Artin.

3- KOPSHTARI VETMITAR ...

Me një shat në dorë ai skalis gjithë ditën,
rrënjë pas rrënje.

Nuk flet me askënd,
fjalët janë mashtruese, nuk e mbajnë dot
peshën dhe ekuilibrin e së vërtetës.

Fundja me kë mund të flasë?
Në tokën që shkrifërohet si bukëvale,
ka veç buburecë e kërmij, dhe disa
zvarranikë
që janë zgjuar befas nga i nxehti i
pranverës.

Me ujin ka një marrëdhënie tjetër.

Në syprinën që rrëshqet erëzave, gjetheve,
gjersa dielli perëndon pas kodrave të buta,
sheh sytë e gruas, të pakthyer më,
receta gatimi dhe ushqimin e duarve të tij.

Qentë ia dëgjojnë fjalën,
ai tund kokën mirënjohës sikur do të
thotë:
Do jemi mirë për një farë kohe...

4- TI MË SHKRUAN ...

Ti më shkruan se aty mjafton një rreze
dielli,
që e gjithë syprina të bëhet pasqyrë,
dhe sytë e fëmijëve të vizatojnë
ëndrra mbi akullnajë.

Në vendin ku jetoj unë, pafajësia
është e fshehur thellë nën tokë,
si mineralet e rrallë.

Atje, u mësoni fëmijëve
të lexojnë yjet dhe diellin si të ishin
lundërtarë.

Këtu, nuk e kemi më në dorë mbijetesën
tonë,
dilemat e muzgjeve - shpirtra, si zogj të
vrrarë.

Andej, kilometra perëndimesh,
projeksione drite të pasosur,
bekime shprese që Zoti për ju ka zgjedhur.

Këndeje, qiej të zemëruar. Pengje e
ndëshkime,
që shfrytëzojnë dhe stuhitë për t'u fshehur
...
Ti më shkruan ...

5- GJUNJËVRARË NËPËR GURË

Fëmijë a fëmijëri gjunjëvrrarë nëpër gurë
që s'janë të emigrantëve të rinj
nuk iu ikin dot rrëfenjave, kushedi përse?

Veshur pantallona xhins,

të shqepura në gjunjët, me gjasa mode,
bëhen vetëm sy dhe heshtje.

Dallojnë menjëherë pjerësi
dhe të plasariturat,
edhe pse e dinë se është e rrezikshme.
s'i rezistojnë përgjërimit të mahnitjes.

Ç'gjë e mrekullueshme iu formëson
vetveten?

Kush se kupton këtë heshtje,
s'kupton as fjalët e tyre,
fjalët e pathëna që nuk lëndojnë askënd.

Ata kanë ndjesinë se jetojnë në një vend,
që është vetëm për ta.

Fëmijë a fëmijëri gjunjëvrrarë,
me vraga që mbeten,
poshtë pantallonave tërë jetën ...

6- Ç'TË JETË KY QIPARIS PUSHTONJËS ...?

Qielli ende s'ka vendosur: të shtjerë shira,
breshër a dëborë,
jashtë, qiparis i ankthit ngop rrënjët me
ujëra e baltë të njomë.

Tërheq gërgërimat brisk, fryn, shkul
perdet e dritares a të rrëngut,
si këputja e gjetheve nga degët apo tundja
e ahut të pengut.

Dendësohen hutimet. Thonë plakat e
lumit: çerekdamllatë,
kë takojnë ëndrrat: të gjallët e vdekur a të
vdekurit e gjallë?

S'gënjehet dot nata, kujton gjithçka ke
harruar, apo nuk e di?
Pandehma ndjellakeqe vijnë rrotull, si
korbat në mushkëri.

Ç'të jetë ky qiparis pushtonjës në kanate
të marrëzisë?
Mahisen trishtimet. Fatit i tremben edhe
perënditë...!

7- RAPORTIM NGA GAZA ...

E dashur këtu janë fshirë gjithë emrat,
një gojë e stërmadhe përpin logjikën,
kohën krejt të pakuptueshme ...

Furi e gjakut është kjo,
a humbja e përjetshme e kujtesës?

Të lutem mos eja kurrë në botën e
antinjeriut!

Ne vetëm sa i shkruajmë lajmet,
nuk i bëjmë ato ...

Sa pak njeriu shihet sy ndër sy,
s'ka guxim, s'ka fuqi.

Lejlekët që klithin janë sirenat
Era dhe pluhuri është trafiku.
Fishkëllima e peshqve në thellësi,
e frikshme si ulërima e ujërve natën.

Uria e padurueshme rri në breg
dhe pret.

Deti është shpresë, një lloj thelbi,
dhe thelbi është dashuria
që mungon ...

8- JE E SHENJTË ...

Të gjithë ikën, ti më mbete,
mike e mirë në këtë botë.
Ti më çon në të gjithë vendet,
dhe në qiell dhe në tokë.

Ti je ajër, ti je ujë,
je kuptim në thellësi.
Ti je dritë në errësirë,
tek çdo thelb, ti je Sy.

Qoftë shteg a gërxxh i egër,
zhur i mjerë a mallkim.
Ti vjen gurgullimë e verbër,
butësi si jasemin.

Je damari i rrëkezës,
gjelbërim që çmend natyrën.
E pamundur të klonohesh,
shpirtësi e shpirtësirës.

Të gjithë ikën, ti më mbete,
mike moj e paqortueshme.
Ti më shpure ku s'më linin,
je e shenjtë e vetëmjaftueshme ...

9- FAJ HOMERIK ...

Akil, je kult i kthyer në sindromë,
egoizëm i tmerrshëm etnik.
Mësove njeriun të jetë me më të fortin.
Në muzeumesh, memorie librash, psikikë.

Zemërohesh ti, ngrysen qiejt, bie gjëma,
zgjohesh nga trans zemërimi,
çel drita e shpresës.
Pas të ndjek mallkimi,
mospranim - mëria ndaj tjetrit.

Mos ndoshta Homeri dhe Zotat
prunë Hektorin para vdekjes
për të zhburrëruar Priamin?
Tek ty pronar i kufomës,
dhuratë prej qiellit?

Homeri dhe Zotat me mbretin u tallën,
çuan t'i puthë këmbët vrasesit të birit,
duke zbritur shkallëve të ferrit.

Akil, je kult i kthyer në sindromë,
egoizëm i tmerrshëm etnik.

Troja u dogj sepse deshi Homeri...

10 - PERËNDITË IKËN ...

Nuk dihet pse perënditë u trishtuan
dhe krijuan Njeriun.
U ligështuan keqas përsëri,
dhe shpikën dashurinë.

Mërzia pas kësaj, u tha:
E keqja tani mori fund,
dhe perënditë ikën.

Eshtë më e lehtë të ikësh
apo jo?

Njeriu mbeti fillikat
mbështetur pemës së vetme
në mes të fushës,
tekta vetëtimat fshikullonin tokën.

Ajo që shihnin natën
duke depërtuar muret,
sigurisht nuk ishte ajo
që shfaqej ditën ...

Perënditë ikën...



HERË-HERË NJË SHENJË...

Një shenjë e gjatë, e thellë
në të majtë
përshkon gjoksin tim,
si shtrati i tharë i një lumi,
pa jetë, pa gurgullimë...
Një vijë e shtrembër,
e pasigurt, tanë grremça
në lëkurë.

Dikur, aty, së pari
me bulëza rozë, fryrë nga limfa,
kish lulëzuar pranvera,
pranvera rebele e trupit tim.

Po ty të kam kaq pranë,
më sheh në sy, humb,
thellë më sheh.

Si shteg fshehur mes gjelbërimit,
plot jetë,
shndërrohet shenja e gjatë, e thellë.
Gazmueshëm,
si vizatimet e para të fëmijëve,
herë-herë...

SHEGËT E EGRA

Lulëzuan shegët
në kodrat përreth Lezhës,
krejt papritur,
si zjarre të vegjël digjen, digjen...
Dje nuk i pashë, nuk ishin.
A thua mua më pritën?!

Vjet u vonova, kish shkuar aq kohë.
Më thirri, më çoi lajm me erën
Lezha...
Çarë nga malli
ndër degë më prisnin
shegët e egra...

U VOCËRROVE, NANË...

U vocërrove,
sa shumë u vocërrove, nanë!
Sa një dramcë.
E unë kisha frikë
mos të të merrnin zogjtë
si në përrallën me Hirushen

e humbja rrugë.
Ti sa një dramcë,
përherë në ballkon
prisje të kthehesha unë.
A thue se vija
nga një pyll i frikshëm,
pa shtigje,
i dendur me drurë.

PEIZAZH

Si varg perlash në qiell
pulëbardhat në fluturim.
Oh, vetëtimthi, në çast
vargu këputet,
mbi det shpërndahen vrik,
mes dallgësh humbin.
Dukën e zhduken perlat
Si trëndafilë.

NË KAFENE

U ngritën nga kafeneja.
Ai pagoi.
Ajo nxori pasqyrën,
të kuqin,
leu buzët,
i buzëqeshi vetes mençurisht
në pasqyrë,
u ngrit gjithë ledhe dhe iku.

Ish aq e bukur!
Vallëzonte ajri përreth.
Shigjeta vështimesh
kryqëzoheshin,
u derdhën mbi të
tek largohej ashtu, haplehtë...

Veç grate në tavolinat pranë
me qeshje të shtirur në fytyrë
tinëzisht vështimin hidhnin
mbi burrat e tyre.

GARDALINA

Kur iku gardalina nga kafazi
qau nipi me lot e zë sa kish.

Të nesërmen papritmas u kthye
e gëzueshëm këndonte
në kafaz mbyllë.

Me lot të nxehtë atëherë
nën zë qava unë...

Ç'LULE DO TË MBIJNË?

Nuk e di ç'lule
do të mbijnë në kafkën time,
po unë do të rilind përsëri.
Ndoshta karafilë të qytetit tim,
në kraharor ndoshta luleborë,
e në shtyllën e kurrizit
do të më kacavirret
një lulevilë.
Do të rilind, do të rilind
me mallin
për gjithçka desha në jetë
deri në ditën e fundme.
që do jetë, e ndiej
një ditë plot diell...

TI GRUA, QË SHETISJE BUZË DETIT

Ti grua, që shetisje buzë detit
me fund të kuq
si tulipan i sapoçelur
shumë të deshi dikush dikur.

Tash buzë detrash të huaj
të rrahin erërat,
e me retë trishtuar derdh lotë.
Netëve pa një xixëllimë.
si drejt farit në brigje të huaj,
rrugën kërkon dashuria
e përsëri humb, humb...

Mbas kaq të largëtish vite
ty, grua të bukur me fund të kuq
të kujtoj, me dhimbje të kujtoj
sa shumë të dashuroi dikush dikur!

KU ISHIN MIQTË

Ish një kohë
kur greminën shihja nën këmbët e mija
Nga pas më shtynin
e më hidhnin gurë.
Shihja vendin ku do bija.
Një buzëqeshje, veç një buzëqeshje
më ktheu nga ajo rrugë.

O zot, ku ishin miqtë?!
Atë që më buzëqeshi
atë çast të vështirë
nuk e njihja
nuk e kisha patur mik...

KUR VESON FUSHAVE

kur veson fushave,
ndodh të ndjej vesën të bjerë
dhe në trupin tim të ngrohtë
rrëzëllitëse e bukur, kristal.

Zogj të vegjël guvash çuçurijnë,
breda meje,
nën çarçafët e bardhë.

NË IKJE

Kur unë të iki
mbi komodinë do të mbeten
një libër gjysmë i hapur
dhe syzet plus tre.

Cili varg do të më përcjellë?

Isha 9 a 10 vjeç, aty diku, *saktësia është fort e mbivlerësuar*, nëna ma bleu një **llambadë**. Po i them *llambadë jugosllave*, një dozë e puhizës jugosllave. Në pah dilte më shumë ngjyra e kuqe, por llambada kishte të gjitha ngjyrat në një eksploziv marramendës piktoresk ku çdo nuancë e çdo ngjyre ishte llogaritur të mos e cënonte të drejtën e ekzistimit të ngjyrës tjetër. Starti im në universin e ‘çikës’ mendoj se ka qenë ky. Këtu unë nisa të merrja frymë si çikë, të ecja si çikë, të nervozohesha si çikë, dhe këmbët e bardha dëborë në një moment dikujt edhe i janë dukur si këmbët e një....çike.

Projekti i nënës, krijimi i një fëmiu që mund të ndërrojë gjininë sa herë të dojë, ishte në fillime të mbara. Në shkollë, në agime, para mësueses, isha një djalë me flokë të zeza i cili e donte shumë sidomos diturinë për natyrën. Në shtëpi, kur të tjerët të ishin larguar, nëna mund të më ndihmonte në picpillimin e pasdites. Më takonte mua të kompenzohesha disi, të ndërroja shpesh personalitetet, karakteret, rolet e mia, absurdin, me vështirësinë që e ka të transformohet një fytyrë mbushur buzëkuq në një çehre me mustaqe të forta si korja e bukës.

*

Unë jam një xham i dyfishtë i një shtëpie të harruar në mal. Unë jam mjellma më e thyeshme në delegacionin e mjellmave të fshatit. Unë i trembem ndjenjave të mia, unë jam i dëmtuar prej situatave të jetës, prej diktateve që shkruhen për ta urreyer e dënuar ekzistencën time. Unë jam sharja që thuhet nën zë, si e heshtur. Unë jam 30 vjeç. Me siguri të plotë, betohem se nuk kam pjesë të trupit ku nuk kanë depërtuar ngacmimet e maltretimet e poshtërsirave njerëzore. Unë jam i njomë për brutalitetin, unë jam Bellorusia në shtrat me Rusinë, unë jam aktori i cili kurrseksi nuk del prej roleve komike e zbavitëse anipse ushtron diksionin për të qenë gladiator i radhës, në sezonin e katërt. Unë jam burrë, kështu më ka mësuar bota ta njoh veten. Unë jam burrë, sepse kështu më kanë thirrë burrat. Unë jam burrë, sepse kësioj ka vendosur gjysmërrethi i burrave. Unë jam sasia e duhur e klorit në një pishinë të përshtatshme për secilin lloj lëkure. Unë jam lëng i frutave. Në dy raste që i kujtoj tash, kam zhvilluar dashuri absurde kur këmbët më rrëshqisnin në ballkonet e lagura të atyre hienave seksuale. Unë jam viktimë e idealeve që të devotshmit i pshtyjnë më shpesh se gratë e tyre gjatë aktit. Jam përpjesëtimi që e mban të gjallë problemin matematikor. Nëse flasim për lëndën e kimisë, jam përzierja mes sodës së bukës dhe uthullës. Jo, më falni, do të ishte një shpërthim i tmerrshëm lirik dhe gabim i madh laboratorik. Më mirë ta përziejme etanolin në ujë.

Më duket e thashë më herët, nuk e di me siguri forenzike, jam 30 vjeç. Jam i goditur tri herë me shufër në kokë, stacioni policor e njeh dhe e ka të dokumentuar vetëm herën e parë. Shoh fotografitë e masakrës së Srebrenicës dhe nuk e kuptoj se si ende merret frymë lirshëm mbi këtë tokë. Unë jam i lënduar, unë jam vajtuesi më i ftohtë në funeralin e shoqes time 49 vjeçare. Më është thënë tash e sa kohë që jam burrë, dhe kërkojnë prej meje që mos të lotoj, që t'i përgënjeshtroj emocionet që kanë, sipas tyre, *aromë gruaje*: pikëllimin, empatinë, mallin, përqafimin me dy duar, turpin, fajin. Si burrë, shkenca, mjekësia dhe gjyqësori i qytetit ku jetoj ma japin një siguri gati qindpërqindëshe që nuk kam faj dhe që ekziston një mekanizëm i cili më mbron nga çdo dobësi.

Tregim fitues i vendit të parë në konkursin e poezisë organizuar prej “Historia Imë” në Shqipëri

ARBËR SELMANI

Çika jeme



A tregova që jam 30 vjeç? Sulmet e panikut janë pesë, çdo ditë, një për çdo vakt islam. Ende më marrin për grua, për çikë.

*

Nëse deri tash isha pikturë e ndrydhur për juve, ka mundësi që prej paragrafit më lartë e keni krijuar një kukull që mund të duket pak a shumë si unë. Një kukull me sytë e vrenjtur, që dikujt i duket çikë e mua përherë më katrithet si një mashkull mustaqezeza, me një mjekërr që më lehtë konsiderohet si shpatë prerëse.

Prapë, kjo kukull, nënës time, në vegime të mjegullta, i duket çikë.

*

Çika jeme.

Futur si me zor në oborrin e përkëdhelisë së saj, e kam dëgjuar jo rrallë nënën të më thërrasë kësioj. Përgjatë tri dekadave, unë shpesh kam qenë çika më e bukur në ekspozitën ku kuratore është ajo, nëna, e ku nuk ka vepër tjetër. Kur e tëholloj këtë shprehje në copëza të vogla plasteline, imagjinata më gjuan e më përplas në disa drejtime. Nëna ime, në shkollën e saj jetësore, njeh dy çika biologjike që kanë rrjedhë prej trupit të saj: motrën time të gjallë, dhe motrën time të vdekur (*Çikën tash e tutje po e marrim si çikën e shtëpisë, çikën e familjes, çikën që del prej trupit si çokolatë e shtypur prej kroasantit që e blen në dyqanin më të afërm, si llava kur e lezetshme derdhet prej majës së kraterit të vullkanit*)

Motrën time të gjallë, ndjej unë, nëna nuk e ka përqaftuar asnjëherë në versionin e një çike. Motra ime e gjallë është në karrocë; gjatë javëve të para të ardhjes në këtë botë (*dy pyetje: a vijnë ne në këtë botë, apo bota e kësaj bote, ky planet, vjen e na imponohet neve, në fetusin e patrazuar ku pushojmë?*), diçka nuk shkoi mirë me aparatusin që e mbante në jetë, dhe trupi i saj i vogël u nxeh aq shumë sa, një kapilar diku nuk u puç sa duhet me tjetrin dhe mbi

të u betua një fat i tillë, të ecte më ndryshe se ne të tjerët (*67 milion njerëz në mbarë botën përdorin karrocën për të lëvizur; pjesa tjetër i shfrytëzon këmbët për të grushtuar objekte pa nevojë ose për t'i rrezitur ato në Diell, pa dëshirë për lëvizje*), të kërkonte ndihmë për t' u larë edhe në bregun e detit por edhe brenda banjos së përbashkët. Nëna ngadalë e kuptoi vet se çika shembullore dhe me flatra të vullnetshme, do të mbetej ndonjë tjetër, por jo e saja. Çikës, asaj, do t' ja qetësonte epiqendrën e tërmeteve mendore, do ta linte dikur edhe punën që t' i qëndronte afër fizikut të saj, do t'i bënte asaj pite e peshk. Më shumë se një çikë që shtron tryezën dhe përgatitet për provimin e autoshkollës, nëna e kishte, e ka, në shtëpi, një tjetër grua së cilës i përulet për veshjen e çorapave. Po, ka momente kur ajo e mendon këtë njeri si çikën e saj; nuk kanë kaluar tridhjetë minuta prej kur e dëgjova duke e thirrë – *‘çfarë çike je ti’* - supozoj si një prapamendim i ndonjë gjesti të motrës që e ka nervozuar pak nënën. Gjithçka ndoshta ka qenë shaka. Nuk e kupton shakanë veç Milan Kundera. Nëse e sheh jetën si spektator nga jashtë, nëse arrin nivelin e vetëdijes ku e takon krejt jetën tënde dhe bisedon shumë pak me të, e vëren se është një shakagjie. Një shfaqje humoristike. Kamerë e fshehtë. Një tejkallim në vija të plota rrugore që vijnë duke u pëshënjelluar dita ditës, deri në të fundit ditë. Motra ime u kthye në një çantë dërmuese të rënduar për prindërit e mi. Çika e dytë e dalë prej trupit të nanës time, e para dhe e vetmja e gjallë, do të merrte ngjyra e trajta të ndryshme përgjatë ditëve të saj, ndoshta asnjëherë formën e një çike siç nëna e kish ëndërru gjatë kohës sa po e bartte lartë e poshtë në barkun e saj të fryrë.

*

Një këngë tmerrësisht e dobët në tërë përbërjen e saj, në gjuhën shqipe, pak a shumë lexohet kësioj: *‘...veç pa çika t' mira, Zoti mos na lashtë’....* Pa gajle, Zoti i ka në sirtare çikat, veç po e pret momentin t' i plasojë ato rrapëllueshëm si

raketa që sulmojnë.

Në trojet prej kah unë vij, lindja e një çike festohet shumë pak. Sikur nuk shtohet popullsia e botës me lindjen e një çike. Sikur, një çikë në familje është lumturi e çiktë, është një njollë e zezë. Nuk është shkruar në ndonjë paragraf shtetëror por çikat sikur nuk ndihmojnë në natalitet, në rritje të popullësisë (*si dy e dy që bëjnë katër, problemi më i madh i plotve është fakti se bota po shkon drejt fundit meqë nuk po ka mjaftueshëm pjella: ka më shumë se një grup njerëzish në botë që gjykojnë e goditen me gurë veç pse nuk ndihmojnë në natalitet, kanë zgjedhur ta duan veten më shumë se fluturimin e spermës*).

Nuk është e largmendshme nëse së shpejti do të ndahen çmime arritjeje veç për burrat; aktori më i mirë, aktori më i mirë në rolin dytësor, regjisori më i mirë, mostra më e mirë mashkull në kravatë, këpucët më të zeza mashkullore në tepihun e kuq, këngëtari më i mirë në zhanrin mashkullor, këngëtari më i mirë mashkull, rrobaqepësi më i mirë i qytetit, mister fotogjenia. Çikat do të jenë duke i shtrënguar më pak kecelet e më shumë buzëqeshjet, në sallën e madhe të ndarjes së çmimeve, e cila e ka emrin më të këndshëm që e keni dëgjuar viteve të fundit: Salla ‘Burri’.

Lind një djalë, gjuajnë pushkë. Lind një çikë, rrudhen fytyrat e shtatë katundeve, një kilometër i vuajtjes më nuk i ka 1 mijë metra. Lind një djalë, shtrohet darkë me specat të mbushur e kadaif, hare apokaliptike, monumentale. Lind një çikë, një facoletë e bardhë mbi fytyrë i duhet vënë se ndryshe na e kaplojnë dreqnitë. Lind një djalë, pllaçitet një gotë raki e dardhës. Lind një çikë, ta gjejmë një udhë që lajmi të vonohet pak, mos ta marrë vesh njerëzia qysh në behar. Lind një djalë, dasmë. Lind një çikë, pikëllim. Lind një djalë, copëtojeni kurbanin. Lind një çikë, i plasat timbri i veshit tek vajtojnë skenarin e jetës së saj, paramenduar gabimisht. Lind një djalë, lind një tjetër, lindin djemtë. Linda unë, në vitin një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e Çikë.

A tregova tashmë që jam 30 vjeç? Nëse skleroza më ka puthur përjetësisht, po e përsëris: jam 30 vjeçar. I lindur në një të martë, 8 tetor. Gjinia: çikodjalë. Seksi: burrë. Seksi në Grindr: i dobët. Emri: Arbër. Shprehja që do ta përdorë ndonjëherë nëna për të ma cokatë mendjen: çika jeme.

*

Nuk shoh diçka të jashtëzakonshme nëse ajo më drejtohet me ‘çika jeme’. Dukshëm, poetikshëm, fjalët vijnë mbushur me dashuri, me estetikë, me brishtësi, me një delikatesë që as nëna vet nuk e di se e posedon, me një dhembshuri që ma lejon të mendoj se, mundësia ekziston, që fati im i keq është të vija në jetë si djalë, të rritesha si mashkull, të bëhesha 30 vjeç si një burrë. Nëse rrethi yt të sheh si një portokall, ti tanimë je një portokall lëvizës. Nëse ndërtimi shoqëror të sheh e të formëson si varrmihës, ti varre ke për të gërryer deri në grahamën e fundit. Diskursi publik të lë pa fjalë, por të jep shuplakë të nxehtë. Prindi të jep të tjera, më vonë, edhe nëse je çikë. Shoqëria rreth meje tërë kohës më ka përceptuar si djalë, ndaj stili im i jetës dhe së paku gjinia ime, konvencionalisht, kualifikohen e manifestohen si të burrërishe, burrnake, burrërore.

Në romanin “*Pas dyerve të Parisit*”, Sindi Tona arrin të ndërtojë një histori, që në pamje të parë, duket si një udhëtim romantik, por që shndërrohet shpejt në një rrugëtim emocional drejt vorbullës së dyshimit, identitetit dhe së vërtetës. Nisur që nga titulli, libri sugjeron më shumë sesa një sfond turistik; nënkupton mistere që fshihen pas fasadave elegante të qytetit, por sigurisht, edhe pas fasadave të personazheve.

A mund të duash dikë që nuk e njeh?

Në qendër të romanit është çifti Sia dhe Eideni, të cilët ndërmarrin një udhëtim paramartesor drejt Parisit. Po ky nuk është një udhëtim romantik për të kurorëzuar dashurinë, por për ta testuar atë dhe për të vendosur pikat mbi “i”. E shkruar me një stil të gjallë, ku mbizotëron dialogu, rrëfimi zbërthen marrëdhënien e tyre përmes një loje të hollë ironie, analize dhe tensioni të brendshëm. Sia, protagoniste me një zë të spikatur narrativ, përballet me dyshimet që ia mbërthejnë mendjen dhe zemrën: a është Eideni ai që thotë se është? Po ajo vetë, kush është?

Ky vetëreflektim e bën romanin më shumë se një histori dashurie, por një shkrim për identitetin, performancën sociale, përpjekjen për kontroll dhe për pasigurinë që fshihet pas një jete thuajse të përsosur. Rrjetet sociale, idealet pop-kulturore, mania për detajet e përkryera dhe ndjeshmëria ndaj gjykimit, janë shtresa që Sindi Tona i ndërton me mjeshtëri në personalitetin e Sias. Ajo është një figurë që e ndërton identitetin e saj nëpërmjet estetikës, por që në thelb vuan pasiguri të mëdha, si shumica e shoqërisë.

Një burrë me të kaluar që ka lënë gjurmë

Eideni është një personazh që provokon dyshime të menjëhershme te lexuesi. Ftohtësia e tij, reagimet e përmbajtura, heshtja rreth së shkuarës dhe marrëdhënia e tensionuar me babain autoritar, Tomin, krijojnë një atmosferë plot trysni, që zgjerohet e shpaloset nga faqja në faqe. Parisi nuk është vetëm vendi i takimit me motrën e Sias, por edhe bota ku të fshehtat dhe e kaluara e Eidenit mund të dalin sheshit.

Vëllai binjak i ndjerë, Danieli, dhe ngjarjet misterioze në Parisin e viteve studentore, krijojnë një hije të rëndë mbi gjithë romanin. Pa e shpjeguar kurrë tërësisht, autorja lë mjaftueshëm të nënkuptohet se e kaluara e Eidenit ka qenë e errët, ndoshta edhe e rrezikshme. Në këtë mënyrë, romani ngrihet mbi një qorrsoak psikologjik, që e bën lexuesin të dyshojë vazhdimisht: kush po luan me kë?

Parisi, një labirint i identitetit dhe së shkuarës

Në këtë roman, Parisi nuk është thjesht vendi ku zhvillohen ngjarjet, por një prani e vazhdueshme, gati-gati një personazh më vete. Ai përfaqëson jo vetëm qytetin e ëndrrave dhe dashurisë, por edhe një labirint simbolik ku personazhet humbasin dhe gjejnë veten, ku e kaluara rikthehet si hije, dhe ku asgjë nuk është ashtu siç duket. Udhëtimet në rrugicat e vjetra, baret elegante dhe takimet në apartamente të stilit parisian janë më shumë se skena, por refleksime të gjendjes së brendshme të Sias dhe Eidenit, pasqyra e një marrëdhënieje që dridhet mbi tehun e së vërtetës dhe iluzionit. Ndërsa Sia përpiket të kuptojë se kush është Eideni, nga ana tjetër, lexuesi kupton se qyteti magjepsës shërben si një zonë e minuar ku ndjenja, kujtesa dhe identiteti përplasen dhe maskohen me

Romani “*Pas dyerve të Parisit*”, Sindi Tona, “Living”

Një roman dashurie me tension psikologjik dhe ironi urbane - Ç’fshihet pas veprës “Pas dyerve të Parisit”?

Nga Xhoina Salaj

shoshoqin, pikërisht si dritat dhe hijet që lëvizin mbi Senë.

Tensioni i padukshëm, por gjithmonë i përhershëm

Një nga elementet më tërheqëse të romanit është ndërtimi i një tensioni emocional, i cili nuk ngrihet mbi ngjarje të zhurmshme apo shokuese, por mbi një ndjenjë të përhershme parehatie, një pasiguri e nënkuptuar, që fshihet në heshtje, në vështirime, në përgjigje të munguara. Ngurrimi psikologjik është i ngjizur me jetën e brendshme të personazheve; pikërisht kjo mungesë sigurie i jep romanit ngjyrimet e një trilleri emocional, ku ndjenja e rrezikut nuk është gjithmonë konkrete, ama përherë e pranishme. Lexuesi e ndien që diçka nuk shkon, por nuk e di saktësisht se ç’është, ashtu si vetë protagonistja. Dhe kur e vërteta fillon të dalë në dritë, ajo është e frikshme dhe të rrëqeth mishin, jo sepse rrëfen një akt të kobshëm, por sepse zbulon qartë natyrën mizore të njeriut egoist.

Marrëdhëniet familjare si pasqyrë e zgjedhjeve të heshtura

Një shtyllë tjetër e rëndësishme në roman është edhe marrëdhënia e Sias me motrën e saj, Leas, që ndonëse jo gjithmonë në qendër të veprimit, luan një rol emocional delikat. Lea është një kujtesë e jetës përpara se Eideni të dilte në skenë, një pikë referimi për një version të mundshëm të Sias që nuk e zgjodhi kurrë atë rrugë. Takimi me të në Paris nuk është veç një episod familjar, por një përballje simbolike me atë që ka mbetur pas dhe atë që mund të vijë. Në bisedat dhe heshtjet mes tyre, lexuesi ndien peshën e zgjedhjeve, të brishtësisë dhe të gjërave që nuk thuhet, por që janë të ngulura thellë në jetën e gjithsecilit që ka një motër ose vëlla, krejt e kundërta e vetes. Marrëdhënia e tyre *tërhiqte mos e këput*, krejtësisht ndryshe nga raporti i ftohtë i Eidenit me të vëllanë, shton një shtresë tjetër intimiteti dhe refleksim, duke i shpalosur personazhet në të gjitha anët e prizmit; në versionin që duan të jenë përkrah atij që duan, por edhe në atë që kanë qenë me njerëzit që kanë kaluar thuajse gjithë jetën.

Stili dhe ironia si mjet i rrëfimit bashkëkohor

Një nga arritjet më të veçanta të këtij romani është gjuha. Dialogët janë të shpejtë, të mprehtë, të ndërtuar me humor të zi dhe të hollë, sarkazëm dhe nuanca ironike që përforcojnë karakterin e dy protagonistëve. Tona shkruan me një vëzhgim të hollë të përditshmërisë urbane dhe sjelljeve të brezit të ri, duke e bërë prozën të freskët dhe të afërt me lexuesin modern.

Megjithatë, kjo ironi është e dyanshme: nga njëra anë zbret maskat e hipokrizisë sociale, por nga ana tjetër, fsheh ose shtyn në plan të dytë dhimbjet dhe frikërat e vërteta të personazheve. Në këtë kontrast, lexuesi herë gjendet me buzën në gaz, e herë me zemrën në dorë.

Një roman për maskat, pamjen dhe të vërtetën

“*Pas dyerve të Parisit*” është një roman që ka kurajën të prekë tema si: të shkuarën e errët, marrëdhëniet e ndërlikuara familjare, rolet gjinore, performancën e dashurisë dhe iluzionin e përhershëm të një jete thuajse të përsosur. Tekefundit, çfarë ndodh kur të vërtetat nuk përputhen me imazhet që projektojmë tek të tjerët? Çfarë ndodh kur dashuria nuk është e thjeshtë dhe e qetë, por e çrregullt, e dyshimtë dhe e mbështjellë nën petkun e misterit?

Ky roman e sfidon idenë romantike të martesës, si qëllim për të të plotësuar, dhe sugjeron se ndonjëherë, udhëtimi drejt një të vërtete personale është më i rëndësishëm sesa çdo premtim nën kurorë.

Pak fjalë për autoren

Sindi Tona është një nga zërat më premtues të brezit të ri në letërsinë shqipe. Me një stil të veçantë, delikatesë dhe thellësi në mendim, ajo shkruan me një finesë që rrallëherë haset në fillimet e një shkrimtari. Fjalët e saj nuk tregojnë thjesht histori, por krijojnë atmosferë, ndërtojnë personazhe komplekse dhe prekin zemrat e lexuesve. Dialogët e mprehtë, ironia elegante dhe qasja bashkëkohore ndaj temave universale e bëjnë prozën e saj të freskët, moderne dhe të fuqishme. “*Pas dyerve të Parisit*”, romani i saj i tretë, është dëshmi e kësaj zotësie: një triller emocional që të rrëmben që nga faqja e parë, e të mban pezull deri në të fundit. Sindi Tona është vetëm në fillim të rrugëtimit të saj letrar, por çdo faqe që shkruan është një hap i sigurt drejt formimit të një zëri që premtonte të lërë gjurmë në letërsinë e kohës sonë.


Pasazhe nga libri

- Shpesh, e gjej veten duke menduar se çfarë më tërhoqi më së shumti tek ai dhe gjithmonë vërtitem rreth së njëjtës përgjigje: ai mbart njëfarë palexueshmërie dhe misteri.

- Nuk mund të rrezikoj që Sia të ikë, sepse marr fund. Do të gjendesha sërish në rrjetën e vetmisë, si thuajse njëzet vjet më parë, gjë që nuk do ta përballoja dot. Eideni me të cilin do të martohet është ky i sotmi; të vjetrin nuk ka pse ta njohë. Unë gjithmonë ia dal. Ia kam dalë atëherë, do t’ia dal edhe tani. Nëse Sia mëson diçka, bën mirë ta fshehë, sepse nëse unë ndiej rrezik, do të detyrohem të mbrohem dhe e kam të pamundur të freno.

- Çfarë mbart kaq hermetike ky Parisi, përtej historisë së Danielit? S’mund të jetë vetëm kaq, apo jo?

- Nuk marr përgjigje, por as nuk pres, sepse thuajse gjithmonë më gënjejnë ndjesitë. Asnjëri nga ne nuk guxon ta pranojë se ajo që sapo thashë, nuk është asgjë më shumë se një gënjeshtëri për ta bërë tjetrin të ndihet mirë.



PUTHJE BLETE

Fluturimi yt puthje blete mbrriti lulet.

Lulet janë më të epërme se sa
këputja e gjunjëve tanë
prej shkume.

Fluturimi yt dy-tri pëllëmbë mbi tokë
po tek të përpjetat e reja sa e pashë,
ende pa më nisur dhimba e mokrës
në kokë...bluajta grurë, mielli doli
pikturë, muzikë, metafora zvarg.

Zvarg, zgavër,
humbëti humba - humba
k'putja e gjunjve prej shkume mua
më kërcënon sot me farmaci shtrat

O,
më puthtë një bletë e paqtë
të shëndoshem plot thumba...

SITË METAFORE

Shiu priste shiun me ardh'
me rrëshekë, s'ndjehej mirë,
Veten mirë ndihu kur iu qullën
supe e këllqe, flutura zemrekë
dhe sytë i kullonin veç adhurim.

Njeriu, është prej shiu, prej mocre
me bubullima të thella rrëshekësh,
Mbrëmja e tij në rrugë me sita
në duar pret yjet margaritarë
bote të mos mbyten më
në hone të verbër...

Shiu ndihej veç i dëlirë
plot sy bubullimash
për njomësthinë ...

NDRY, Ç'KYÇ

Qullemi ende pa rënë shi,
cikloni kund nuk duket
thahemi së ftohtit,

ëndërrojmë mot të rrëmbyer
me cikma në gishtrinj
tatu lëndimi
ndonjëherë
gjoksit.

Po i iki rrëmbimthi këtij Endërrimi
bashkëmoshatar vranët gjithëgaz,
një shi tjetër shtrydh
rrobat e dimrit
tjetër erë hekuros jaka
shprishur belash.

Ende pa rënë shi,
ende pa ardh' cikloni
dashurohem e zihem me metaforat,
fluturak po aq ujërave plot shtjella
jetës plot stih... asnjëherë
mbuluar krekosje
borërash.


Rrëmbimthi po i iki
këtij ëndërrimi

gazvranët, ndry, ç'kyç dimrit.

FRIKË FLUTURE

Jeta lehton buzëve vesë fluture...
Shpejt nuk don me ik
s'don me u përtha,
Ne fatin tonë
lehtojmë tej
mugujve

Jetës që ende gjallë na mba...



RUZHDI GOLE
Dola t'i flas detit në vesh ...

VIT - VIT

Vranësia shtrihet mbi gjeth,

gjethi tjetër
njomëzak gjallnie
ninëzat çelnon rrezmë...

Veç një gjeth ... vyshk ... tej krysh.

QESHJE E HIDHUR

Dola të shoh Detin
frymë pashterr'

të gjallin e përjetshëm,

Ai përhera
ia fal tjetrit
pa u ndjerë
gjithçka të vetën.

Dola t'i flas detit në vesh ...

Ai pa i folur
ma ndihu
brengën
brengën e valës
që na ndan
pa na lënë
asnjëherë
veç.

Detit
vetëm vdekja
s'i qesh.

METAFORË E GREMISUR

Bora zbret shpejt majamajat
na afrohet plot ojna të qarta
shpesh të fshehta, përhera
edhe më të rrezikshme,

gishtrinj të suferinave
puqen ngrijnë ndahen
nuk u binden më
metaforave
të terrura

gremina mund
të na gremis
lamtumirave.

Sonte s'ka vargje,
shpejtojmë këmbët
të shpëtojmë kryet tona
të mesnatës sa më lehtë,

gjurmë ujqërish na duken
gjurmët e njeri - tjetrit

nga rrëshqitjet
jehonat

kur bora
e gënjeshtërt
fshehtas vrapon
të na mbulojë të gjithëve
na rrëmbejë me gjithë mend,

k'saj mesnate rrëmbyer askënd
me fenerë të drobitur
nëpër këmbë...

Sonte s'ka vargje...
veç gjurmë ujqërish,

të jenë gjurmët tona
lamtumirë
askundi?

HOP ROMANTIK

Mes jush dimri rri vetëm zgjuar
tek ne ndonjëherë dremit
gërhet ndopak,

shpejt zjarrmitë tona
shkërmoqin hejet
nga duart

ngricat tek ju
me kollë
të thatë.

Atje dimri ngrohtë rri mes jush
shumë gjatë rri, s'don me ik',
këtu psherëtin hope flu
gëzon shëndet
romantik.

HARLISJE E GISHTAVE

Molla ndrit mes ojnash
përskuqur në vetull,
era dhe shiu
begatojnë
zonjash

që duhen
për mote të kthjellët
shumë për mote të shkrehur.

Shkuan pjergullat
plot, tash shkundur,

harlisja e gishtave vonon
për vozitje thellë trupit tonë
për flutura poetike ndër muguj.

QERSHIZË E PAHITUR

Pahitja vetvetiu puqi buzët,
pranverë do ta ndijmë
ne dimrit përngahera
vithisje gurgullimash
krisje, thupër.

Plot cifla duken zhduken n'ajër
Jeta puqet, ndahet m'dysh
rruga me të tjerët
pjestohet shpejt
ngadalshëm
pa u marr
m'sysh.

Qershiza vajzërore
vagullt shkund
prej vehtes
përsiatjet
e natës,

gurgullima e saj lozonjare
në tezgjahun më të ri
të hamendjes
thurrshthurr
dritëflakën.

Puhitja puqi gjetiu buzët
dimërim do ta ndejmë
pranverën e shkurtër ?

NGUSHËLLIMI VONË

Si ta ngushëlloj bubullimën krahëprerë
shiun lakadredhas cikmë në çdo cak,
si të ngushëlloj mullirin e ndjerë
peshkun hovjesh çarë në bark ?

Si ta ngushëlloj bletën pa koshere,
zjarrin, që vet don të mbytet terr,
si ta ngushëlloj terrin terresh
plot ndere, vesën me xixat
pikë dhe vrer. ?

NGJITJE E VOGËL

S'kam ngjitur
asnjë majë
në majë,

i kam ngjitur majat
thuaje të gjitha,
s'kam kundruar
me vemendje
asnjë nga
kalatë,
të gjitha i kam këqyrur

kur kotheren e ngricës
e ka përtypur rrezja
më përpara
se Njeriu
e bisha.

MEDALION PE(RË)NDIMI

Ne
a e pyesim
ndonjëherë Motin :
Në livadhet tona kur do kullosim ?...

Pyes kryqëzatat e reja nga hovjet :
çdo të bëjmë me medalionet,
çdo të bëjmë me bishtalecat
e prera të vreshtit nginjur et' ?
Perëndimi shpërndan
zishëm ftesat
nderohet
me def.


Ç'do të bëjmë me medalionet ?
Qefini i tjetrit është pronë
a vjedhje
prone?

I tregova Llojdit për një udhëtim tjetër, jo si ky me tren, po në këmbë, në moshën pesëvjeçare. Kisha dalë nga kufijtë që më kishin vënë nëna dhe babai, sepse unë prej kohësh isha shndërruar në një djalë të prapë. E për ç’shkak? Ngaqë nuk e haja vezën të gjallë. Dy kokrra vezë të pulës pikalore të nënë Saidesë. Dy vezë të bardha që mua më ngjallnin një ndjenjë neverie të thellë dhe ikja, vrapoja, ndërsa nëna më ndiqte nga pas, thërriste, ulërinte, ngrinte rrugicën në këmbë, sepse mua më numëroheshin brinjët, kisha zënë krimba, vuaja nga parazitët, kështu që më shtinte nëna në govatë e më lante tre herë në ditë, më qethte zero, më lyente kokën me vajguri dhe unë thërrisja e përpëlitesha në krahët e saj, sepse më digjte e më përvëlonte, aq sa nganjëherë më binte të fikët. Pra duhej të haja dy kokrra vezë të freskëta çdo mëngjes, ç’ti haja, t’i gëlltisja, më saktë, ndërsa nëna më llastonte, më thoshte fjalët më të ëmbla në botë dhe, për çudi, qante. S’duhen harruar çastet me nënën, qofshin ato edhe të këqija. Ishte më e bukura grua që kisha parë dhe për këtë ndihesha krenar, por e fshihja se më tmerronte një lloj frike e çuditshme se mos dëgjoja ndonjë ditë fjalën kurvë për të. Babai e donte pa masë, por edhe për të unë kisha frikë se mos i dilnin brirë. Kjo, kuptohet, që nuk ishte mendimi im, po ai nxitej nga bisedat e më të mëdhenjve të cilët më impononin shijet e tyre. Dhe unë përgjoja fjalët dhe... jo, jo, asgjë për nënën time gjer në moshën shtatë vjeç kur unë rashë në dashuri me shoqen e saj, Bajamen, një ezmere me sy të mëdhenj ngjyrë blu, me gjinj dhe bythë të mëdha. Unë arrija deri te puthja, ajo më dukej suksesi më i madh, s’dija gjë tjetër. Po Bajamja ishte thëngjill i mbuluar, ajo donte babanë. I gjeta të dy në shtrat dhe më erdhi shumë keq për nënën. E vuajta dy muaj. Të tretin, nga mërzia dhe një zemërim që ende s’më kishte lënë, i kalova kufijtë e rrugicës dhe dola në qendër të qytetit. Atje në një vitrinë pashë një makinë të madhe për fëmijë: Lamborghini. U shtanga. Ishte diçka që duhej të më përkiste, por s’e kisha unë në dorë. I thashë babait, ai më kapi për dore dhe erdhi për të parë makinën. Dyqani ishte mbyllur. Vijmë nesër, më tha. Mirë, vijmë nesër, i thashë. Por pasdite e pashë në shtrat me Bajamen dhe nuk m’u bë t’i kujtoja ç’më kish premtuar. Babai ra poshtë, siç bie nganjëherë shkumësi i mësuese Lilit, që na jep aritmetikën dhe unë ngrihem menjëherë, e marr nga pllakat e dyshemesë dhe ia jap. Nëna u ngrit lart, gjer te ikona e Shën Mërisë dhe kupa me vaj e fitil që ajo e ndez çdo natë kur lutet. Jo, s’kish si nëna ime. Por unë tani po e vlerësoj, pikërisht tani ngaqë s’gjej më si ajo dashuri, se atëherë vetëm prisja prej saj llastimet e ëmbla dhe vajgurin përvëlues. Po ajo makinë më mbeti në mend dhe nuk m’u shqit kurrë, as sot që ata të dy s’janë më dhe unë i kujtoj herë pas here, kur s’më ecin punët dhe kërkoj mbështetje. Por tani kishte ardhur koha e të gjithë kujtimeve me ta, sidomos me nënën. E gjora, sa më donte! Nuk lindi më prej veshkave. Unë fillikat, shoqëruesi i saj i vetëm, pothuajse. Nënë, si je njohur me babanë? Së pari në tango, te shtëpia e oficerëve, në lulishten e saj ku ishte një pistë. Ai në atë kohë ishte shoqërues i një gjenerali, po binte shumë në sy, i ecnin punët me femrat. Unë kisha frikë nga këta meshkuj. Po s’më linte kureshtja dhe një nxitje për ta njohur. Ai erdhi drejt meje kur u dëgjua thirrja: Tani fuqinë e kane damat! Unë u ngrita, pa u mendua fare dhe i zgjata duart. Në pistë u shuan dritat. Po ai mbante distancë. Nuk më bëri asgjë. Se aty rreth nesh putheshin e ndukeshin, po ai vetëm më shtrëngonte lehtë dhe asnjëherë nuk i uli duart poshtë. E dashurova menjëherë. Rashë koke e këmbë në dashuri me atë burrë që dinte të mbante distancë. Dhe lashë kokrrën e namit një ditë. Sapo kisha qepur një fustan të ri, që më rrinte shumë mirë, i kisha bërë flokët permanent, ato më derdheshin valëvalë e krela-krela, mbi gjoks e mbi krahë, të verdha dyllë. E pashë, rrinte para presidencës, rojë, i karfosur me uniformë. Vrapova, dëgjon ti, apo të zuri gjumi, iu hodha në krahë dhe e putha, ai nuk lëvizti, rrinte si dru, veçse mua nuk më shpëtoi një nënqeshje e hollë dhe ai syri i tij lojçak aq premtues. Ja, kështu, pastaj ai erdhi vetë në rrugicë dhe më priti kur dola nga shtëpia, bëri sikur s’më pa, sikur s’kishte ardhur për mua dhe u zhduk. Babai yt i dinte marifetet. Pas dy ditësh erdhi me gjithë gjeneralin, një burrë shumë simpatik me mustaqe që dukej sikur kishte lindur duke buzëqeshur. Ai vetëm buzëqeshte, aq sa m’u vel e isha gati t’i thoja, tani trishtohu se s’të ka lezet. Isha budallaqë. Këpusja fjalë pa vend, por yt atë më thoshte se ato ishin mjalti im. Dhe ai, gjenerali s’na u nda, vinte në shtëpi pa lindur ti, flirtonte me mua, kur babai s’ndodhej aty, por nuk e tepronte. Dukej që i pëlqeja. Që ta mbaja larg, kërkoja një makinë qepëse Singer, të vjetër, dhe fillova të qepja për rrugicën. Tani më rrethonin gratë dhe vajzat. Unë modelet i sajoja vetë, por kur më duhej makina shkoja te Greta, vjenezja, gruaja e drejtorit



të hotel Dajtit. Makinën ma gjeti gjenerali, por u pendua shpejt se, sa herë që vinte, unë isha e zënë me punë. Dhe në karrige apo në divane llomotisnin gratë, këmbë përmbi këmbë, piqnin kafe mbi mangall, me qebap, e bluanin në mullirin e kafesë që ju nxinte duart dhe prisnin të bëhej shkuma e të hidhnin fall. Ai rrinte një grimë në këmbë, i përshëndeste dhe largohej si i turpëruar. Ç’djalë që ishte, po i ziu vuannte për mua. Dhe atij, tyt eti, as që i shkonte mendja. Nëna e kishte kënaqësi të madhe kur më kapte dorën dhe më merrte me vete. Ku nuk shkonim, dhe pyetja e parë ishte: Ke qejf të hamë një ëmbëlsirë te Xingoni? Ose: ka dalë një film i ri, do ta shikojmë? Gjithmonë ajo kishte kujdes që të më kënaqte sa më shumë. Me ato pak para që merrte nga qepjet, se ajo shpesh nuk merrte para, ngaqë rrugica ishte shumë e varfër, s’dinte ç’të blinte më parë. Por ajo makinë, ai Lamborghini që pashë te dyqani në qendër, nuk u ble kurrë. Ishte shumë i shtrenjtë dhe një ditë nuk e pashë më. I vetmi peng nga nëna, i vetmi, që m’u shndërrua dalëngadalë në fiksion.

Babai yt ishte shumë i pëlqyer, kjo na prishte punë. Nuk më la të zija punë shteti, jo, thoshte, puna të vyshkë, dua të shoh si në takimin e parë. Po nuk zgjasin shumë këto, bir, jeta nuk është aq e bukur sa na duket. Nëna e kishte një brengë, ose ashtu më dukej mua. Nganjëherë e gjeja në shtrat, nuk ngrihej gjer në mesditë. Nuk e mora vresh ç’kishte. Asgjë, bir, vetëm një dhembje koke. Pesëmbëdhjete vjeç rashë në dashuri me mësuesen e rusishtes. Ia kisha mësuar shtëpinë, ngaqë e kisha ndjekur disa herë, për t’i parë format, lëvizjet, hollësi të ndryshme që më preknin. E doja sikur më përkiste, por që ende nuk po bëhej imja. Si një të afërm që s’po dukej, s’po trokiste në shtëpi siç bënin tezet apo hallat e mia, gratë apo plakat e rrugicës. Gjersa një muzg e pashë duke nderur në tel tek njëra nga dritaret, të brendshmet e saj. I numërova, ishin mbi njëzet. Aty ndodhi një ndryshim tek unë, një



ndryshim i turpshëm, sepse doja të bëja seks me të. Nuk isha në vete, pothuajse e kisha humbur me javë të tëra, mundohesha të gjeja një shkak për t’iu larguar, por ishte e pamundur. Nëna punonte gjer vonë dhe unë dëgjoja biseda grash, të qeshura grash dhe gjithmonë para syve kisha Monikën, mesuesen e rusishtes. Ajo kishte dy fëmijë: një djalë dhe një vajzë, njëri më gjytyrym se tjetri, nuk ia vlenin as t’iu hidhje sytë. Nuk gjeja në shkollë një njeri normal, të gjithë më dukeshin qyrrsa, nga ata që vuajnë nga rrufa dhe në verë. Si do t’ia bëja? Nëna nuk paraqitej në shkollë kur ishte dita e takimit me prindërit, se unë isha shumë mirë me mësim, sidomos në matematikë. Ajo thataqja e matematikës, që teshtinte sa herë shkruante me shkumës në dërrasë të zezë, lehtësohej kur unë mungoja në shkollë. Bënte shumë gafa dhe unë ia korrigjoja me zë të lartë që nga banka, pa u ngritur në këmbë. Isha budalla, gjithmonë e teproja dhe s’hiqja dorë nga një palë brekë të Monikës, që s’po i siguroja dot. Po të më shohë poshtë dritares, çdo të më thotë? Le të më shohë. Prisja orën kur do t’i hiqte nga teli, në të rënë të muzgut, që të mos i zinte vesa. Më pa, u përkul dhe pëshpëriti: Po ti, çdo këtu? Pres vjeshtën të bien gjethet, iu përgjigja dhe ajo mbylli me krismë dritaren. As vetë nuk e kuptova se si më erdhën ato fjalë pa kuptim. Të nesërmen më thirrën në drejtori. Në fillim mendova të mos shkoja, po nuk doja të mundoja nënën. Ajo do të linte punën dhe do të vinte me vrap. Ç’ka bërë, përsëri e ka katranosur? Drejtori, një ish boksier që mbante gjithmonë kostume; të zi në dimër, bezhë në pranverë, lino me pak rrudha në verë, zhizhigonte në vjeshtë, i kishte nja tridhjetë kravata, që i ndërronte përditë. Vinte erë livando dhe e kishte dorën të rëndë. Sa më pa që hyra brenda, më përfshiu nga krahët, më uli poshtë, ma ngjeshi kokën midis kofshëve, ma shtypi, aq sa unë ia ndjeva bolet e mëdha, dhe më ra me pëllëmbë në vithe. Qelbësirë! E mbushe kupën. Do të përjashtoj nga shkolla. Vagabond. Më thuaj, ç’i ke thënë Monikës? Dhe ma shtrëngoi kokën me forcë. Asgjë s’i kam thënë... O do më tregosh të vërtetën... o do të nxjerr trutë këtu... Më pëlqen, i thashë. Çfarë? Përsërite! E kam qejf! More idiot, po ajo është nëna jote. Jo, ti s’je për shkollë! Që sot je i përjashtuar! Ik, m’u hiq nga sytë, se përndryshe do të lë të vdekur. Kur hapi kofshët dhe më la që të ngrihesha në këmbë, ndjeva se po më rridhte gjak nga hunda. Më dha dhe një flakërimë në fytyrë gjithë pezëm. Unë hyra në shtëpi, i thashë diçka nënës, ajo e la makinën qepëse dhe fluturoi për në shkollë. U kthye duke qeshur. Budallai, tha, gati sa nuk më propozoi. Pastaj u mor me mua, qau. I ëmbli im, më tha, ç’të ka hipur në kokë? Nuk e ke bërë asnjëherë? E, më thuaj, s’është turp. Jo. S’të besoj, goxha djalë dhe s’e ka ngjyer? Ç’të ngjyeja mama. Karafil, e nise, çoje deri në fund. Kush grua nuk e do? Nuk e prisja që mamaja të fliste me këtë gjuhë. U trondita. Ç’thua, je në vete? Fola me gjuhën e kurvës, se ti kurvën do, jo dashurinë e vërtetë. Dashuro së pari, pastaj ajo punë e plaçkës vjen vetiu. Të ka zënë meraku për gra në moshë? E do vërtet Monikën? E kam qejf! Mos hiq dorë! Pastaj më shtroi në dru. Më binte ku të mundte, shkulte flokët e saj, thërriste, aq fort thërriste sa dëgjuan fqinjet dhe e para që bëri këmbë ishte nënë Saideja, që na piqte bukët se kishte furrë balte në oborr. Ç’bën, moj, nuk e shikon, atij po i rrjedh gjak. Dua ta vdes! Ç’ka ngjarë, më thuaj. I është tekur për atë mësuesen e rusishtes, Monikën dhe pa pikë turpi më thotë se ka dëshirë ta bëjë me të. Kujt i ka ngjarë? Qyqja! ia bëri nënë Saideja. Po shkoj te Rukija që t’i prishi syrin e keq. Dhe, ndërsa po fliste, të dyja bukët e mbështjella me pecetë të bardhë, i ranë nga duart. Më mbeti në mendje ajo shprehja e nënës: Kush grua nuk e do? Ishte e vërtetë. Nën dritaren e saj gjeta një palë brekë sateni me dantelle. Kishin rënë nga teli ku nderte rrobat, apo i kishte hedhur vetë? Drejtori bënte sikur nuk më shikonte, mësuesja e matematikës u zhgënjye kur më pa në shkollë, Monika nuk më ktheu përgjigje kur i thashë: Spiune! Kisha mësuar përmendsh poemën: Vjeshta, të Pushkinit dhe ajo nuk m’i ndante sytë kur e recitova rusisht në ballë të klasës. Doja ta habisja, po, po, doja që ajo të ndiente për mua, ta dashuroja, pastaj... Po asnjë rast s’po vinte. Asnjë. Guximin e kisha, po isha pa përvojë. Me nënën kisha një javë që s’flisja. Haja nga nënë Saideja, ç’të kishte, edhe byrek me fasule. Më dëgjon, Llojd? Si s’të dëgjoj, më vjen keq për nënën tënde, të ka besuar një të fshehtë, që ti e ke përdorur dhe je prishur. Po, u prisha, i thashë. Shiko, peshqit! Ishim nën oqean. Lloj-lloj peshqish afronin gojën dhe i binin me bisht xhamave të vagonit. Nëpër një dritë të çuditshme të natës boreale ata lëvrinin me shkathtësi dhe dukeshin në të gjitha dritaret. Nuk kisha parë ndonjëherë diçka të tillë, tha Llojd me shumë naivitet. Ku mund të jemi vallë? Nën Grenlandë, po i afrohem i Irlandës.

Në një kohë kur arti rrezikon të zhjyhet në konsum dhe pamje virtuale, ekspozita e piktorit Gani Bytyçi që u hap më 20 qershor në Gjilan, paraqet një përballje drithëruese me shpirtin njerëzor dhe kujtesën kolektive. Në galeritë e artit rrallëherë ndodh që piktura të mos kërkojë vetëm një shikim estetik, por edhe një akt përjetimi të thellë emocional dhe reflektimi historik. Ekspozita e fundit e piktorit Gani Bytyçi nuk është vetëm një retrospektivë artistike. Ajo është një kujtesë e përflakur, një rrëfim i vizatuar me dritë dhe dhimbje, ku mediumi i ngjyrës shndërrohet në një tekst i heshtur që flet me zërin e të përvuajturve.

Kjo ekspozitë, e kuruar me mjeshtëri dhe ndjeshmëri, është një maratonë artstike që vrapin e ka bërë me ndjesinë rrëqethëse të një artisti që i ka kushtuar dekada të tëra krijimtarisë, jo për zbulim, por për dëshmi: për të dëshmuar rrugëtimin tonë historik, dramatik, dhe shpesh tragjik.

Në katër ciklet ideore – “Rrugëtimi fatal”, “Thyerje”, “Portrete” dhe “Peizazhe” – Bytyçi na udhëheq përmes një itinerari shpirtëror dhe historik, ku piktura nuk është vetëm medium vizuel, por shndërrohet në gjuhë dhe rrëfim kolektiv. Në tablotë të mbushura me kontraste dritash e ngjyrash nuk ka spektakël, ka dhimbje. Nuk ka ornament, ka thellësi. Çdo ngjyrë, çdo formë, çdo rrudhë mbi portret, bart një peshë: të kujtesës, të humbjes, të kërkimit për dritë.

Qasja estetike e Bytyçit nuk mund të kuptohet jashtë përvojës së tij jetësore dhe trajektores kolektive shqiptare. Me një bagazh të thellë letrar dhe filozofik, me një përvojë të gjatë në kritikën e artit dhe letërsisë, Bytyçi e ndërton diskursin vizual mbi tri boshtet themelore: trauma kolektive, njeriu si figurë e thyer dhe kërkimi për dritë si metaforë shpëtimi.

Portretet e tij janë më shumë se pamje, ato janë gjendje. Fytyrat e shfaqura mbi pëlhurë janë të plagosura, të mbyllura pas grilave, në ikje apo në reflektim të tmerrit. Ato nuk kërkojnë keqardhje, por mirëkuptim. Ato janë pasqyra të historive tona, të ikjeve tona, të heshtjeve tona të dhimbshme. Ashtu siç ka vërejtur kritika franceze, në çdo pikturë të Bytyçit mund të shihet një “pikturë e dytë”, një narrativë e fshehur, që zbulohet vetëm nga syri i

EKSPOZITA E GANI BYTYÇIT – NJË KUJTESË E PËRFLAKUR NË NGJYRË DHE SHPIRT

Nga Emin Azemi

Në katër ciklet ideore – “Rrugëtimi fatal”, “Thyerje”, “Portrete” dhe “Peizazhe” – Bytyçi na udhëheq përmes një itinerari shpirtëror dhe historik, ku piktura nuk është vetëm medium vizuel, por shndërrohet në gjuhë dhe rrëfim kolektiv. Në tablotë të mbushura me kontraste dritash e ngjyrash nuk ka spektakël, ka dhimbje. Nuk ka ornament, ka thellësi. Çdo ngjyrë, çdo formë, çdo rrudhë mbi portret, bart një peshë: të kujtesës, të humbjes, të kërkimit për dritë.

ndjeshëm dhe shpirti i përgatitur për të dëgjuar.

Në aspektin semiotik, veprat e tij përmbajnë një strukturë narrative komplekse, ku simboli është më shumë se mjet shprehës – ai është një akt memorie. Ciklet si “Rrugëtimi fatal”, “Thyerje” dhe “Portrete” përfaqësojnë tri nivele të ndërgjegjes historike: rrugëtimin si ekzil, thyerjen si fragmentim të identitetit dhe portretin si dëshmi të traumës. Shikuesi, në këtë rast, nuk është spektator i pasivizuar, por bëhet lexues i një drame që mbart dimensionin antropologjik të mbijetesës.

Teknika e tij – vaj në letër ose në pëlhurë – i jep një dritë të veçantë veprave, duke krijuar kontraste të forta mes errësirës dhe dritës, mes dëshpërimit dhe shpresës, mes figurës dhe abstraktes. Në këto tensione, Bytyçi e ndërton individualitetin e vet artistik, duke e ruajtur ekspresivitetin dhe përkushtimin ndaj temave universale e kombëtare, por me theks mbi mikrokosmosin e nënqiellit të tij, të cilin ai e njeh dhe e ndjen deri në placë.

Kompozicionet janë të ndërtuara me një tension të brendshëm midis figurës dhe abstraktes, duke përfaqësuar jo vetëm përvojën pamore, por edhe shpërbërjen e saj si akt kritik ndaj realitetit. Ngjyrat e tij nuk janë vetëm zgjidhje teknike, por bartin një funksion psiko-emocional. Ngjyra e errët nuk është errësirë fizike, por psikë kolektive e trazuar. Portretet pa sy, fytyrat pas grilave, kafkat e shpërndara, janë figura arketipale që i përkasin kujtesës historike dhe nuk janë të lokalizuara vetëm në hapësirë

GALERIA E ARTEVE - GJILAN
20 qershor 2025, ora 19:30

Gani Bytyçi Anatomia e dhimbjes



Kurator: Demush Avdimetaj

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport

shqiptare, por flasin me gjuhën e universales.

Ajo çka e veçon këtë ekspozitë është përmasa saj humane. Nuk kemi të bëjmë vetëm me një ekspozitë pikturë, por me një testament emocional dhe shpirtëror. Është një qasje që shkon përtej estetikës, një përpjekje për të kuptuar njeriun në betejën e tij me dhunën, me harresën, me absurditetin dhe me të pamundshmen. Për këtë arsye, pikturat e Bytyçit më shumë përjetojnë sesa shikohen.

Ekspozita në Gjilan paraqet një sintezë të rrallë, një përmbledhje të një rrugëtimi artistik që shënon jo vetëm maturinë krijuese të autorit, por edhe

gatishmërinë e tij për të mbetur i lidhur me temat që e dhembnin dhe e lartësojnë njëkohësisht. Arti i tij është rrëfim, akuzë, lutje dhe dritare, një përpjekje e përhershme për të mos e lejuar harresën të mbizotërojë mbi kujtesën.

Në këtë kontekst, arti i Bytyçit mund të lexohet përmes teorisë së “kujtesës kulturore” të Jan Assmann-it: piktura si mjet për ruajtjen dhe komunikimin e përvojave traumatike, si një arkiv vizual ku ruhet e shkuara që institucionet shpeshherë duan ta harrojnë. Çdo tablo është një akt rezistence, një kundërshti ndaj harresës institucionale dhe një përpjekje për të dokumentuar historinë përmes sensibilitetit artistik.


Në planin emocional, veprat e Bytyçit prekin palcën e njeriut. Ato nuk flasin me ton të lartë, por me psherëtimë të gjatë. Shikimi i tyre është një akt i dhimbshëm, por njëkohësisht i nevojshëm për të kuptuar se arti nuk është vetëm stoli e kohës së lirë – ai është një mjet i thellë ndërgjegjësimit dhe ndërtimi të kujtesës së drejtë.

Në ciklin e fundit, “Peizazhe”, autori krijon një kulm të qetësisë, një hapësirë reflektimi pas përplasjes së fortë emocionale që ka shkaktuar më parë. Por edhe këtu natyra nuk është e pafajshme. Ajo është vendi i heshtjes së pasluftës, i zërave që mungojnë dhe njerëzve të dashur që i presim, i dramës që ndodhi dhe që tani përpiqet të mbijetojë përmes kujtimit.

Ekspozita e Gani Bytyçit, me rreth 60 vepra, nuk është vetëm një paraqitje estetike, por një dokument vizual që qëndron në kufirin ndërmjet artit, historisë dhe filozofisë së ekzistencës. Për rrjedhojë ai është kronisti i heshtur i shpirtit të plagosur kolektiv. Në këtë kontekst, Bytyçi nuk është vetëm piktor – ai është një etnolog i ndjenjës, një arkeolog i fatit njerëzor, një poet vizual i asaj që nuk thuhet dot me fjalë.

Në fund, ai qëndron përballë nesh jo si një mjeshtër që kërkon lavdi, por si një dëshmitar që i ka dhënë shpirt telajos dhe ngjyrës, për të na kujtuar se arti i vërtetë nuk lind nga lehtësia, por nga plagët që kanë nevojë të shndërrohen në kuptim. Arti i Gani Bytyçit edhe përmes kësaj ekspozite është një tingëllimë që vjen e heshtur në mendjen tonë, por në simfoninë e gjerë të ngjyrave, hijeve e vijave ajo bëhet gjithnjë e më e fuqishme, ashtu siç është i fuqishëm ndikimi psiko-emocional i këtyre pikturave.

Shkup, qershor 2025



Umberto Eko është mjaft i njohur edhe për lexuesin shqiptar falë shumë veprave të ardhura në shqip. Për të përmendur vetëm disa më të famshmet: *-Emri i trëndafil*it *-Varreza e Pragës* *-Numri zero* *-Flaka misterioze e mbretëreshës Loana* *-Lavjerrësi i Fukoit* *-Tri rrëfenja* *-Të thuash gati të njëjtën gjë* *-Si shkruhet një punim diplom* *-Si të udhëtosh me një salmon* *-Pape Satàn Aleppo* *-Mbinjeriu i masës* *-Mos kujtoni se do të shpëtoni nga librat!* etj.

Kësaj biblioteke madhështore, që përbën një univers tepër të çmuar letrar, filologjik, filozofik, semiologjik, eseistik etj. i shtohet edhe ky libër me këtë titull interesant, i cili, megjithëse jo shumë i vëllimshëm, është tejet i ngjeshur, plot variacione befasuese e kolorit, plot lojëra të zgjuara stilesh e regjistrash komunikimi, që kanë lindur nga shikimet retrospektive të jetës dhe veprës së vet, por edhe nga pasuria e madhe e informacionit dhe erudicioni olimpik i tij e mbase më personal se çdo vepër e tij e mëparshme.

Rrëfimet e një romancieri të ri përmbledh Leksionet Richard Ellmann mbi Letërsinë Moderne të Umberto Ekos, të cilat ai i mbajti në vitin 2008 në universitetin e Harvardit. Frytet e punës “detektive” semiotike të Ekos paraqiten këtu aq qartë sa kthehen në zbulimet më magjepsëse të *Rrëfimeve...* Që në paragrafin e parë, ai pohon se është në të vërtetë një romancier i ri, megjithëse kur i mbajti leksionet, po *ecte drejt të tetëdhjetave* por: *... e quaj veten një romancier shumë të ri dhe, shpresoj, premtues, që deri tani ka botuar vetëm pesë romane dhe shumë të tjerë do t'i botojë në pesëdhjetë vitet e ardhshme...*

Fakti se pavarësisht gjithë famës dhe nderimeve, ai ndihet si amator, i mbush të gjitha faqet e librit me një gjallëri dhe joshje të pafund: Ekoja është thjesht një lexues tjetër, që përpiqet të kuptojë...

Ai përdor veprën e vet si gur themeli në këto leksione, duke bërë një lidhje midis mënyrës si shkruan dhe temave të *Rrëfimeve*, duke përdorur vazhdimisht shembuj nga vetja (si për përmbajtjet ashtu edhe për procesin krijues). Ai vëren se është *studiues në profesion, dhe [...] romancier vetëm si amator*, por në këto leksione përqendrohet në shkrimin e tij krijues (megjithëse formimi i tij akademik padyshim që ndërftutet vazhdimisht).

Nëse do të detyroheshim ta klasifikonim këtë libër me rregullat tradicionale taksonomike, do të viheshim në një lloj vështirësie që buron nga disa faktorë; së pari nga rrethanat e ngjizjes së tij – siç e përmendëm - ky libër është plazmuar nga fondi i leksioneve të këtij profesori akademik me aureolë dhe staturë ndërkombëtare, mbajtur para studentëve amerikanë në vitin 2008; së dyti, për shkak të karakterit sinkretik të kësaj vepre, që konsiston në larminë e diskurseve dhe në udhëtimet e autorit në hapësirë e në kohë; që nga antikiteti, deri në kohët moderne; që nga Homeri deri te Xhojsi. Kësaj zhvendosjeje në hapësirë e kohë i përgjigjet një strukturë kompozicionale e përshtatshme, brenda së cilës autori ka vendosur katër kapituj, që në thelb janë katër dritare të mëdha ose katër sy të mëdhenj - katër observatorë kozmikë nga ku studentët, krijuesit e ardhshëm, mësuesit dhe pedagogët e sotëm, njerëzit e medias, të shkencave humane, filologët dhe të gjithë lexuesit mund të vrojtjnë dukuritë e qiellit të letërsisë, sekretet e krijimtarisë letrare apo nivelin e shkrimtarit, të lexuesit - të dallojnë lexuesin empirik nga lexuesi ideal; shkrimtarin empirik nga shkrimtarin ideal, kiçin nga arti, faktin nga trillimi, personazhet si vepra semiotike etj. Të gjitha këto e të tjera Eko i sevir në forma tepër të rafinuara.

Ai jep në këtë vepër këshilla madhore, udhëzime dhe mësim nga më të çmuarat, me një bujari të rrallë; me një kosto kaq të ulët, sa një lexuesi të përkorë i kursen orë dhe ditë të tëra leximesh e kërkimesh të gjata, zhytur në libra e labirinte të ftohta bibliotekash.

Së këtejmi, del një tipar i veçantë i këtij personaliteti - profili profetik i mësuesit:

Një vepër e re e Umberto Eco-s në shqip

RRËFIMET E NJË ROMANCIERI TË RI

Nga Zija Vukaj – përkthyes

sado të shtrenjtë e madhështor e ka stofin e akademikut, sado hijerëndë atmosferën e profesorit, sado solemn emrin dhe rrezatimin - po aq të thjeshtë profilin dhe misionin e vet prej mësuesi. Prej atij që me magjinë e vet i bën të thjeshta gjërat më të ndërlikuara. Misioni për të ndriçuar të tjerët e ka udhëhequr drejt gjetjes së formave nga më të larmishmet. Umberto Eko ka ndërtuar ndër të tjera në këtë vepër një galeri tepër të larmishme personazhesh: Të trilluar dhe realë ose OFE (objekte fizikisht ekzistues). Paradoksalisht, ai vendos epërsinë e të trilluarve ndaj realëve. Luan me aspektin e pakontestueshëm të Ana Kareninës dhe me aspektin e kontestueshëm të Hitlerit; të Hamletit me Jezu Krishtin; të Çërcillit, Obamës, Dalai Lamës me Leopold Blumin, Me Koperfildin, Ema Bovarinë etj. Arsenali stilematik i autorit për t'u impostuar në një kumtim me nota të paqëta humorizmi, është në funksion të çtensionimit nga rreptësia e diskurseve shkencore dhe thellësia e temave që gjakon të përcjellë dhe kështu zbret ngadalë e pa kuptuar në gjërat e thjeshta, që mund t'i prekë gjithkush, por që kanë magjinë e shpjegimeve efikase. Duke e përdorur që në fillim antifrazën si mjetin bazë të komunikimit, si një shkelje syri çapkëne, Eko shkruan: *Kur më pyesin në një intervistë “Si i shkruan romanet e tu?”, menjëherë përgjigjem “Nga e majta në të djathtë”. E kuptoj se nuk është një përgjigje e kënaqshme e mund të prodhojë njëfarë keqkuptimi, po të jepej në një vend arab apo në Izrael. Tani kam mundësi të jap një përgjigje më të hollësishme.*

Në një nga kapitujt e fillimit “Të ndërtosh

një botë” autori shprehet në lidhje me sfidat e krijimit në prozë dhe poezi dhe shkruan: *Rrëfimi qeveriset nga rregulla latine “rem tene, verba sequentur” (“zotëro temën dhe fjalët vijnë vetë”), ndërsa për poezinë parimi duhet ndryshuar në “verba tene, res sequentur” “zotëro fjalën, tema vjen vetë”.*

Më tej ai i përqendron rrëfimet mbi disa nga veprat e tij. Por tashmë ne e dimë se “rrëfimet” janë mësim, janë udhëzime, janë këshilla të çmueshme që kanë ardhur nga thellësia e përvojës personale të një mjeshtri me famë botërore. Konkretisht fillon me romanin “Emri i trëndafilit”: *Para së gjithash “frymëzimi” është një fjalë e shëmtuar që e përdorin shkrimtarët e këqij për t'u dukur artistikisht të respektuar. Siç thotë fjala e urtë angleze “genius is ten percent inspiration and ninety percent perspiration”, gjeniu është dhjetë për qind frymëzim dhe nëntëdhjetë për qind djersë. Tregojnë se poeti francez Lamartin kishte përshkruar shumë herë rrethanat në të cilat kishte shkruar një nga poezitë më të mira të tij; ngulte këmbë se kishte lindur si shkreptimë një natë që po kalonte në një pyll. Pas vdekjes, i kanë gjetur në studio shumë variante të asaj poezie, shkruar e rishkruar ndër vite*

Spikat në këtë paragraf natyra origjinale e Ekos, guximi për të pohuar diçka që duket absurde dhe kundër rrymës, por që është kaq e vërtetë, sa çuditemi si nuk e paskemi vënë re më parë. Ose: *Kur shkruaja Lavjerrësin e Fukoit kaloja pasdite të tëra, deri në orën e mbylljes, duke ecur nëpër korridoret dhe sallonet e Konservatorit të Arteve dhe Zejeve, ku zhvillohen shumë ngjarje.*

Siç dihet *Lavjerrësi i Fukoit* është një

vepër tepër komplekse shumështrësore; një ngrehinë artistike e vendosur mbi platformën e shkencave të sakta, por edhe ekzoterike, mistike etj., pa folur për estetikën e saj që ngrihet mbi artin sublim të fjalës dhe mbi kompleksitetin ontologjik të qenies njerëzore. Si e tillë, ajo mund të kompozohet vetëm nga një mendje e thellë dhe një talent i rrallë, mbajtur në zap nga një vullnet i hekurt për të pasur çdo informacion nën pushtetin e vet. Ndërsa nga rrëfimet për romanin tjetër të tij, kemi: *Kur projektaja “Ishulli i një dite më parë”, natyrisht kam shkruar në detet e Jugut e pikërisht në vendet për të cilat flet romani, për të parë ngjyrat e ujit e të qiellit në orë të ndryshme të ditës dhe ngjyrimet e peshqve e të koraleve. Por kam kaluar edhe dy a tri vjet duke studiuar vizatimet dhe modelimet e anijeve të asaj epoke, për të ditur se sa e madhe mund të ishte një kabinë apo sa e gjatë një dhomë gjumi; e si dikush mund të lëvizte nga njëri vend në tjetrin.*

Dhe kjo është e mjaftueshme për të kuptuar se çdo të thotë të ndërtosh një botë ku procesi i krijimit të një romani të mund të realizohet në normalitetin më optimal të kompozimit të një ngrehine të denjë artistike. Këto dhe të tjera “rrëfime” janë ndriçime të rralla që vijnë prej entitetesh artistike të pazakonta. Duke kaluar te kapitulli “Kodifikimi i dyfishtë” double coding autori rrëfhet: “Nuk i përkas asaj çetës të shkrimtarëve të këqij që thonë se shkruajnë vetëm për vete. I vetmi tekst që shkruhet për vete është lista e shpenzimeve, për t'i kujtuar vetes çfarë të blejë e pastaj hidhet. Gjithçka tjetër, përfshirë edhe listën e rrobolarësës, shkruhet për ndokënd. Nuk janë monologë; janë dialogë. Mjaft interesante është pjesa e librit mbi personazhet imagjinare. Spikat aty simpatia e tij për Don Kishotin dhe gjithë fati apo bekimi i një personazhi për të qenë imagjinar. Të qash për Ana Kareninën mbetet shprehje domethënëse e realitetit dhe fatit të personazheve imagjinare. Dyma komenton kështu në kujtimet e tij: *Është privilegji i romancierëve të krijojnë personazhe që vrasin ata historikët; e që në përgjithësi historikët kufizohen të kujtohen si fantazma, ndërsa romancierët krijojnë personazhe prej mishi dhe kockash.* Këtu Eko shtron një pyetje të madhe: *Por a jemi të sigurt që personazhet e fantazisë nuk kanë ndonjë lloj ekzistence?* Përtej shumë tablove, kapitujve dhe situatave me tonalitete nga më të ndryshmet me trille nga më befasueset një tablo që ndryshon gjithë menynë e kësaj vepre është kapitulli i madh “Listat e mia”. Listat janë personazhe, dukuri, lojëra popullore, gurë të çmuar armë etj. Ai flet për lista praktike dhe poetike, për retorikën e enumeracionit, duke cituar pjesë të zgjedhura nga “Iliada” e Homeri kënga II ku përshkruhet shqyti i Akilit, apo nga Maria Wysława Anna Szymborska apo nga numërimi i bëmave të “Don Zhuanit” të Mozartit nga Leporeli. Edhe kur duket sikur e tepron, si te kapitulli “Listat e mia”, Ekoja e bën gjithmonë me humor e nganjëherë edhe me një dozë ironie e autoironie.

Kjo vepër e Umberto Ekos do të jetë një alternativë mjaft e mirë leximi dhe konsultimi për lexues të interesave dhe niveleve nga më të ndryshme, por mbi të gjitha, për letrarët e sotëm e të ardhshëm, për profesorët dhe mësimdhënësit e çdo niveli, për studiuesit, njerëzit e mediave, gazetarët dhe çdo individ që i intereson letërsia e vërtetë.

Dhe për ta përfunduar: Te libri *Të thuash gati të njëjtën gjë*, Ekoja reflekton thellësisht për mjeshtërinë e përkthyesit. Ai dinte mirë si “t'i vinte në provë” përkthyesit e tij. “Teksti që përkthehet shumë lehtësisht, është një tekst i vdekur”, shkruante.


Nuk mund të them se ky libër nuk më ka munduar. Mundime të bukura, intelektuale, ama. I ndodhur mes sfidave të përmbajtjes së pasur dhe ndërdisiplinore, stilit ironik dhe të larmishëm, pikave të pafund të referimit, kulturore dhe letrare, lojërave gjuhësore dhe ndoshta mbi të gjitha, muzikalitetit të fjalisë, ritmit dhe harmonisë, shpresoj t'ia kem dalë këtij udhëtimi të mrekullueshëm për letërsinë dhe mekanizmat e ligjërimeve të saj.



Që në vogëli, ndoshta pesë a gjashtë vjeç, e dija se kur të rritesha duhej të bëhesha shkrimtar. Midis moshës shtatëmbëdhjetë dhe njëzet e katër vjeçare u rreka të heq dorë nga kjo ide, por e bëra me vetëdijen se po dilja kundër natyrës time të vërtetë dhe se shpejt a vonë do të më duhej të ulesha e të shkruaja libra.

Isha i mesmi i tre fëmijëve, por secili prej vëllezërve kishin ndryshim moshe prej pesë vjetësh dhe para se mbushja tetë vjeç rrallë e shihja tim at. Për këtë dhe arsye të tjera, isha deri diku i vetmuar dhe shpejt m'u bënë zakon disa mënyra sjelljeje të pakëndshme të cilat më bënë të papëlqyer gjatë viteve shkollore. Kisha zakonet e fëmijës së vetmuar për të trilluar histori, atë të kuvendimit me njerëz të përfytyruar dhe mendoj se që nga fillimi, ambiciet e mia letrare përziheshin me ndjenjën e të qenit i izoluar dhe i nënvlerësuar. E dija që fjalët i përdorja me shumë lehtësi, ashtu si dhe një lloj force për t'u përballur me situata të pakëndshme dhe pata ndjesinë se kjo krijonte njëfarë bote vetjake ku mund të përballesha me sprovat e jetës së përditshme. Megjithatë, volumi i shkrimeve serioze, p.sh. me qëllimin për të qenë serioze, të cilat i shkrova gjatë gjithë fëmijërisë dhe djalërisë nuk kapën as gjashtë faqe. Poezinë e parë e krijova kur isha katër vjeç dhe ia diktova me zë të lartë sime mëje që ta shkruante. S'më kujtohet asgjë prej saj përveçse ishte për një tigër dhe ky tigri ishte "dhëmbë - karrige", frazë goxha e mirë, por ma merr mendja se ishte plagjiaturë e poezisë "Tigër, tigër" të Blejikut¹. Në moshën njëmbëdhjetë vjeçare, kur shpërtheu lufta e 1914-1918-ës, shkrova një poezi patriotike e cila u botua në gazetën lokale, ashtu si dhe një tjetër dy vjet më vonë, për vdekjen e Kiçenërit.² Kur isha pak më i madh, herë pas here, shkrova poezi të dobëta "për natyrën" në stilin Xhorxhian dhe zakonisht të papërfunduara. Po kështu, gati dy herë, u përpoqa të shkruaj një tregim, i cili doli të ishte një dështim i tmerrshëm. Kjo ishte vepra e menduar si serioze që hodha në letër gjatë gjithë atyre viteve.

Megjithatë, gjatë kësaj kohe, në njëfarë kuptimi, u përfshiva në veprimtari letrare. Së pari, ishin shkrimet e porositura të cilat i përgatisja menjëherë, lehtësisht dhe pa ndonjë kënaqësi. Përveç gjërave në shkollë, shkruajta *vers d'occasion*³, poezi gjysmë-komike të cilat i përfundoja me një shpejtësi që tani do ta quaja të habitshme, në moshën katërmëdhjetë vjeçare shkrova një komedi të tërë me rimë, duke imituar Aristofanin, për afro një javë, dhe dhe dhashë ndihmën time në redaktimin e revistave së shkollës, edhe pasi shtypeshin, edhe në dorëshkrim. Këto revista ishin gjërat më për të ardhur keq dhe më burlesket që mund të përfytyrohen dhe u kushtoja shumë më pak vëmendje atëherë se sa do t'i kushtoja sot gazetarisë më të pavlerë. Por krahas gjithë kësaj, për pesëmbëdhjetë vjet apo më shumë, po praktikoj një ushtrim letrar të një natyre



GEORGE ORWELL

Pse shkruaj

Përktheu nga anglishtja Granit Zela

krejt tjetër: ishte krijimi i një "historie" të vazhdueshme për veten, një lloj ditari që ekzistonte vetëm në mendjen time. Mendoj se ky është zakoni i të gjithë fëmijëve dhe adoleshentëve. Kur isha shumë i vogël, shpesh imagjinoja sikur isha, le të themi, Robin Hudi dhe e përfytyroja veten si hero të aventurave ngazëllyese por shumë shpejt "historia" prej narcizi reshti së qeni kaq haptas e tillë dhe u shndërrua gjithnjë e më shumë në një përshkrim të thjeshtë të asaj që po bëja dhe gjërave që shihja.

Për shumë minuta bluaia me vete gjëra të tilla që më dyndeshin në mendje: "Ai shtyu derën dhe hyri në dhomë. Një rreze e verdhë drite, që përshkonte perdet prej pambuku, binte pjerrtas mbi tavolinë, ku një kuti shkrepeje, gjysmë e hapur, dergjej pranë shishes së bojës. Me dorën e djathtë në xhep, vajti drejt dritares. Poshtë, në rrugë, një mace e zezë po ndiqte një gjethë të vyshkur", etj., etj. Ky zakon vazhdoi deri afro të njëzet e pestave, gjatë viteve të shkrimeve të mia joletrare. Megjithëse duhej të kërkoja sërish e sërish të gjeja fjalët e duhura, më dukej sikur e bëja këtë përpjekje përshkruese thuajse kundër vullnetit tim, sikur të isha nën trysninë e një detyrimi që më diktohej nga jashtë. Ajo "histori", besoj, duhet të ketë pasqyruar trillet e shkrimtarëve të ndryshëm që më kishin pëlqyer në moshë të ndryshme, por me aq sa më kujtohet, gjithmonë kishte të njëjtën cilësi të përpiktë përshkruese. Kur isha afro të gjashtëmbëdhjetave, papritur zbulova ngazëllimin që të ngjallnin fjalët e thjeshta, p.sh. tingujt dhe shoqërizimet

e fjalëve. Vargjet nga "Parajsa e Humbur" e Miltonit: "Kështu ah me vështirësi e mund të madh/ Çau para me zor dhe ah sa mund", të cilët tani nuk më duken dhe aq të mrekullueshëm, më rrëqethnin deri në asht dhe shqiptimi i "ah" për "ai" ishte një kënaqësi më tepër. Sa për nevojën për të përshkruar gjërat, tashmë dija gati gjithçka se si bëhej. Kësisoj, ishte e qartë çfarë lloj librash doja të shkruaja, për aq sa mund të thuhet se doja të shkruaja libra në atë kohë. Doja të shkruaja romane të mëdhenj natyralistë me fund të palumtur, plot me përshkrime të hollësishme dhe buzëqeshje mahnitëse, plot me përshkrime të hollësishme dhe krahasime kumbuese, dhe gjithashtu plot fragmente me lajle-lule në të cilat fjalët përdorehin pjesërisht për hir të tingëllimit të tyre. Dhe në fakt, romani im i parë i plotë, "Ditë birmaneze", të cilin e shkrova në të tridhjetat, por që e kisha planifikuar në mendje shumë kohë më parë, është ky lloj libri.

Po e jap këtë informacion paraprak sepse s'mendoj se motivet e një shkrimtari mund të vlerësohen pa ditur diçka rreth zhvillimeve e tij të hershëm. Lënda e shkrimit përcaktohet nga epoka në të cilën jeton, kjo është e vërtetë të paktën për periudha të trazuara, revolucionare, si kjo e jona, por para se të fillojë të shkruajë, ai duhet të ketë përvetësuar një qëndrim emocional nga i cili s'mund të shkëputet kurrë plotësisht. Është detyra e tij, pa dyshim, të disiplinojë temperamentin dhe të shmangë mundësinë e të ngecurit në ndonjë fazë papjekurie apo në ndonjë

gjendje shpirtërore të mbrapshtë: por, nëse arrin të shkëputet nga ndikimet e hershme, ka gjasë ta ketë vrarë shtysën e të shkruarit.

Po të lëmë mënjane nevojën për të siguruar jetesën, mendoj se janë katër motive të rëndësishme përse shkruhet, të paktën, pse shkruhet prozë. Ekzistojnë në nivele të ndryshme të çdo shkrimtar dhe te secili, raporti ndryshon herë pas here, sipas atmosferës në të cilën jeton shkrimtari. Ato janë:

1. Egoizmi i mirëfilltë.

Dëshira për t'u dukur i zgjuar, të flasin të gjithë për ty, të të mbajnë mend pas vdekjes, t'u tregosh sa vlen të rriturve që të kanë përçmuar në fëmijëri, etj., etj. Është hipokrizi të mëtos se ky nuk është motiv, dhe madje motiv i fuqishëm. Shkrimtarët e kanë këtë karakteristikë ashtu si shkencëtarët, artistët, politikanët, avokatët, ushtarët, biznesmenët e suksesshëm, me pak fjalë, me të gjithë elitën e njerëzimit. Masa e madhe e qenieve njerëzore nuk janë vërtetë egoiste. Pasi të tridhjetave, ata i braktisin ambiciet individuale, në shumë raste, në të vërtetë, braktisin madje dhe ndjenjën e të qenit individë, dhe jetojnë më shumë për të tjerët ose thjesht i mbyt puna angari. Por është gjithashtu, edhe pakica e njerëzve me dhunti dhe vullnet që janë të vendosur të jetojnë jetët e tyre deri në fund dhe shkrimtarët i përkasin kësaj kategorie. Shkrimtarët seriozë, më duhet ta them, janë në tërësi më mendjemëdhenj dhe të përqendruar te vetja se sa gazetarët, megjithëse më pak të interesuar për paratë.

2. Entuziazmi estetik.

Perceptimi i bukurisë në botën e jashtme ose, nga ana tjetër, te fjalët dhe te përdorimi i duhur i tyre. Kënaqësia që merr nga një tingull apo një tjetër, në qëndrueshmërinë e prozës së mirë ose ritmit të një historie të mirë. Dëshira për të ndarë një përvojë e cila mendon se ka vlerë dhe se s'duhet humbur. Motiv i estetik është shumë i dobët te shumë shkrimtarë, por madje dhe një pamfletist ose hartues tekstesh shkollore ka fjalë apo shprehje të parapëlqyera për arsye të padobishme; ose mund të jetë tepër i dhënë pas tipografisë, gjerësisë së anëve të faqes, etj. Përveç nivelit të një udhërrëfyesi, asnjë libër nuk është plotësisht i lirë nga gjykimi estetik.

3. Shtysa historike. Dëshira për t'i parë gjërat siç janë, të zbulojë fakte të vërteta dhe t'i ruajë për brezat e ardhshëm.

4. Qëllimi politik, e përdorim fjalën "politik" në kuptimin më të gjerë të mundshëm. Dëshira për të shtyrë botën në një drejtim të caktuar, për të ndryshuar idenë e njerëzve të tjerë për llojin e shoqërisë për të cilën ata duhet të aspirojnë të kenë. Ta themi edhe një herë tjetër, asnjë libër nuk është mirëfilli i çliruar nga ndikimi politik. Mendimi se arti nuk duhet kurrësi të ketë të bëjë me politikën, është në vetvete një qëndrim politik.

Mund të shihet se si këto shtysa të ndryshme duhet të luftojnë me njëra-tjetrën dhe se si luhaten nga një individ te tjetri dhe nga një kohë në një tjetër. Sipas natyrës, duke e kuptuar "natyrën" si gjendjen në të cilën ndodhesh sapo arrin moshën madhore, unë jam një individ tek i cili tre motivet e para peshojnë më shumë se e katërta. Në një epokë paqësore, mund të kisha shkruar libra me stil më të stërholluar ose thjesht libra përshkruese dhe mund të isha gati i pavetëdijshëm për bindjet e mia politike. Në këtë epokë që jemi, kam qenë i

1 William Blake (1757 -1827) poet anglez i rëndësishëm i poezisë dhe artist pamor të epokës romantike. (Shënim i përkthyesit).

2 Horatio Herbert Kitchener, (1850 -1916) oficer i lartë i ushtrisë britanike dhe administrator kolonial. Në 1914, në fillimin e Luftës së Parë Botërore, u bë Sekretar i Shtetit për Luftën, Ministër Kabineti. Më 5 qershor 1916, Kitchener po shkonte për në Rusi për të marrë pjesë në negociatat me Carin Nikolla II, anija me të cilën udhëtonte goditi një minë gjermane 2.4 km në perëndim të Orkney-t, Skoci dhe u fundos. Kitchener ishte ndër 737 pasagjerët që vdiqën. (Shënim i përkthyesit).

3 Vjersha zbavitëse që shkruhen për një rast të veçantë. (Shënim i përkthyesit).

detyruar të bëhem një lloj pamfletisti. Në fillim, kalova pesë vjet me një profesion të papërshtatshëm (Në policinë indiane perandorake, në Birmani), pastaj provova dhe varfërinë dhe ndjesinë e dështimit. Kjo gjë e shtoi urrejtjen time të natyrshme ndaj autoritetit dhe më bëri, për herë të pare, plotësisht të vetëdijshëm për ekzistencën e klasave punëtore; puna në Birmani më kishte bërë të kuptoja deri diku natyrën e imperializmit por këto përvoja nuk qenë të mjaftueshme për të më dhënë një orientim të saktë politik. Pastaj erdhi Hitleri, u bë lufta civile spanjolle, etj. Aty nga fundi i 1935-ës, ende nuk kisha arritur të merrja një vendim të përfundimtar. Më kujtohet një poemë e vogël që shkrova në atë datë, për të shprehur mëdyshjen time:

Famullitar i lumtur mund të kem qenë
Këtu e dyqind vjet
Predikvoja dënimin e përjetshëm
Shihja arrat e mia të merrnin përpjetë
Por ajme linda në një kohë të ligw,
E humba parajsën e bekuar,
Mustaqet më janë bërë bigë
Kurse klerikët me brisk janë rruar.

Dhe më vonë sidoqoftë ishte kohë e mbarë,
Kënaqeshim me shumë pak,
Mendimet e trazuara binin fashë kur flinim
Në gjirin e pemëve.

Të paditur qemë andaj kishim guxim
Të ndienim gëzimin që sot s’e ndiejmë;
Trishtili i gjelbër në degën e mollës
Mund t’i bënte armiqhtë e mi të dridhen.

Por barku i vajzave dhe kajsitë,
Buburreci në një përrua me hije,
Kuaft, rosat që fluturojnë në agim,
Të gjitha një ëndërr janë.


E ndaluar është përsëri t’ëndërrosh;
Gëzimet i gjymtojmë ose i fshehim;
Kuaft janë bërë prej çeliku
I ngasin burrat shtatshkurtër e të shëndoshë.

Jam krimbi që s’u kthye kurrë,
Eunuku pa harem;
Mes priftit dhe komisarit
Unë eci si Eugene Aram⁴;

Dhe komisari po më parashikon fatin
Ndërsa në radio dëgjohe muzikë,
Por prifti ka premtuar një makinë,
Sepse bastevënësi paguan gjithmonë.

Kam ëndërruar të jetoj në salla të mermerta,
Kur u zgjova pashë se ishte bash ashtu;
S’duhej të kisha lindur në një epokë të tillë;
A ishte Smithi? A ishte Xhounsî? A ishte ti?

Lufta spanjolle dhe ngjarje të tjera në vitet 1936-7 i ndryshuan ekuilibrat dhe pas kësaj, e dija në cilën anë do të qëndroja. Çdo rresht i veprës time serioze që nga viti 1936, është shkruar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kundër totalitarizmit dhe për socializmin demokratik, siç e kuptoj unë. Më duket absurde, që në një kohë si kjo e jona, të mendosh se mund të shmangesh të shkruarit për këto tema. Të gjithë shkruajnë për to në një mënyrë a në një tjetër. Është thjesht çështja se



në cilën anë do të jesh dhe çfarë qasjeje ndjek. Dhe sa më shumë i vetëdijshëm te jesh për anën tënde politike, aq më shumë mundësi ke të veprosh politikisht pa sakrifikuar integritetin estetik dhe intelektual.

Ajo që kam dashur më shumë të bëj gjatë dhjetë vjetëve të fundit ishte ta shndërroja në art të shkruarit politik. Pikënisje për mua është gjithmonë një ndjenjë besnikërie, ndjenja se ka padrejtësi. Kur ulem të shkruaj një libër, nuk i them vetes: “Do të krijoj vepër arti”. E shkruaj sepse janë disa mashtrime që dua t’i nxjerr në pah, sepse dua të tërheq vëmendjen te disa fakte dhe shqetësimi im fillestar është të dëgjohe. S’do të mundja ta bëja punën e shkrimit të një


libri, qoftë edhe të një artikulli të gjatë reviste, po të mos ishte edhe përvojë estetike. Kushdo që shfaq interes për të shqyrtuar veprën time, do të mund të vërë re se edhe kur është propagandë e mirëfilltë, përmban shumë nga ajo që një politikan me kohë të plotë do ta quante të parëndësishme. S’jam në gjendje dhe s’dua ta braktis plotësisht botëkuptimin që kam krijuar në fëmijëri. Për aq kohë sa të jem gjallë dhe me shëndet do të vazhdoj të kem një ndjesi të fortë për stilin e prozës, të dua sipërfaqen e tokës, dhe të marr kënaqësi nga sendet e plota dhe nga grimcat e dijeve të panevojshme. Nuk ia vlen ta shtyp këtë anë të vetvetes. Detyra ime është të gjej të përbashkëtën mes pëlqimeve dhe mospëlqimeve të

mia të rrënjësura me veprime në thelb publike, jo individuale që kjo epokë na dikton të gjithëve.

Nuk është e lehtë. Kjo ngre problemet e formimit dhe të gjuhës, dhe ngre në një mënyrë të re problemin e vërtetësisë. Më lejoni të jap vetëm një shembull nga më të vrazhdët për vështirësitë që dalin. Libri im për luftën civile spanjolle, “Homazh Katalonjës”, sigurisht, është libër haptas politik, por në tërësi është shkruar me njëfarë vëmendje dhe kujdesi për formën. Jam përpjekur shumë që të rrëfej gjithë të vërtetën pa cënuar instinktet e mia letrare. Por, ndër të tjera, përmban dhe një kapitull të gjatë, plot me citime gazetash dhe gjëra të tilla, të cilat mbrojnë Trockistët që ishin akuzuar për komplot me Frankon. Është e qartë se, një kapitull i tillë, që pas një ose dy vitesh s’do të ishte me interes për një lexues të zakonshëm, e rrënon librin. Një kritik të cilin e respektoj, më dha një porosi. “Pse i ke përfshirë të gjitha këto?” më tha. “Ke shndërruar atë që mund të ishte një libër i mirë në gazetari”. Ajo që më tha ishte e vërtetë, por s’mund të veproja ndryshe. Rastësisht mora vesh, atë që pak njerëz në Angli lejohej ta dinin, se po ngriheshin akuza të rreme ndaj njerëzve të pafajshëm. Po të mos isha zemëruar për këtë, s’do ta kisha shkruar kurrë librin. Në një formë a tjetër, ky problem shfaqet përsëri.

Problemi i gjuhës është më i mprehtë dhe do të merrte shumë për ta diskutuar. Do të them vetëm se në vitet e mëvonshme jam përpjekur të shkruaj me stil më pak piktoresk dhe me më shumë saktësi. Sidoqoftë, kam kuptuar se në kohën kur ke përsosur një stil të shkruarit, gjithmonë e ke tejkaluar. “Ferma e kafshëve” ishte libri i parë në të cilin u përpoqa, me vetëdije të plotë për atë çfarë po bëja, të shkrija qëllimin politik dhe qëllimin artistik në një të tërë të vetme. Nuk kam shkruar asnjë roman për shtatë vjet, por shpresoj ta shkruaj një të tillë shumë shpejt. Ka gjasë të jetë dështim, çdo libër është një dështim, por e di me njëfarë qartësie se ç’lloj libri kam dëshirë të shkruaj.

Kur i kthehem faqes së fundit ose dy të fundit, shoh se kam bërë të duket sikur motivet e mia se pse shkruaj janë plotësisht të diktuar nga ndjenja e qytetarisë. S’dua të mbetet kjo si përshtypje përfundimtare. Të gjithë shkrimtarët janë mendjemëdhenj, egoistë, dembelë dhe mu në zemër të motiveve të tyre fshihet një mister. Të shkruash libër është një betejë e tmerrshme, rraskapitëse, si lëngata e gjatë e një sëmundjeje që të shkakton dhimbje. Askush nuk do t’i hynte një pune të tillë nëse nuk do të yshtej nga ndonjë demon të cilit s’mund t’i bënte ballë dhe as ta kuptonte. Megjithatë e di që demoni është thjesht i njëjti instinkt që e bën një fëmijë të piskatë që të tërheq vëmendjen. Dhe prapëseprapë është e vërtetë që nuk mund të shkruash asgjë të lexueshme nëse s’përpiqesh pareshtur për të zhdukur personalitetin tënd. Proza e mirë është si xhami i një dritareje. S’mund ta them me siguri cili nga motivet e mia është më i forti, por e di se cili prej tyre meriton të ndiqet. Dhe, kur i rikthehem veprës time, shoh se pikërisht aty ku në mënyrë të pashmangshme më mungonte qëllimi politik, kam shkruar libra të pajetë, dhe jam tradhtuar nga fragmente me lajle-lule, fjali pa kuptim, mbiemra zbukurues dhe përgjithësisht, gjepura.



⁴ Eugene Aram (1704 – 16 gusht 1759) filolog anglez, i famshëm si vrasësi i njohur nga Thomas Hood në baladën “Ëndrra e Eugene Aram-it”, dhe nga Edward Bulwer-Lytton në romanin e vitit 1832 “Eugene Aram”. (Shënim i përkthyesit).



Karikatura nga Arben Mexsi